

S'KA TATIM PA INFORMIM

Lufta e FOL-it për transparencë të prokurimit publik në Kosovë





MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS OF DENMARK
DANIDA | INTERNATIONAL
DEVELOPMENT COOPERATION



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

JO TATIM PA INFORMIM

Beteja e FOL-it për prokurim publik të hapur në Kosovë

Ky botim është realizuar me përkrahjen e projektit Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP), i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA), e i menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Lëvizjes FOL dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SCO-K-së, DANIDA-s apo KCSF-së.

“Nuk ka krim, nuk ka shmangie, nuk ka dredhi, nuk ka mashtrim, nuk ka të metë që nuk jeton në fshehtësi¹.

– **Joseph Pulitzer**

¹ Përkthyer dhe përshtatur nga FOL

Lista e shkurtesave

OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
OCP	Partneriteti për Kontrata të Hapura
BE	Bashkimi Evropian
KE	Komisioni Evropian
KRPP	Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik
TI Sllovakia	Transparenca Ndërkombëtare në Sllovaki (<i>Transparency International Slovakia</i>)
CoST	Iniciativa për Transparencë në Sektorin e Ndërtimit
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
OShP	Organi Shqyrtues i Prokurimit
AQP	Agjencia Qendrore e Prokurimit
KM	Kod i mirësjelljes
ARBK	Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë

1.0 Të gjeturat kryesore

1. Korniza e tashme ligjore ofron transparencë të kufizuar për shpenzimet publike
 - a) Ligji për qasje në dokumente publike ofron transparencë bazuar në rregullin “nëse nuk pyet, nuk është i hapur”
 - b) Ligji për shoqëri tregtare ofron transparencë të kufizuar lidhur me pronarët e bizneseve, menaxhmentin dhe përfituesit (beneficiaries)
 - c) Ligji për prokurim publik kufizon qasjen në dokumente publike
2. Kosova ka Kod të Mirësjelljes në prokurimin publik që synon forcimin e integritetit të zyrtarëve të prokurimit publik; ai është i shkruar mirë, por mungojnë mekanizmat e zbatimit të tij
3. Një sistem tejet i decentralizuar i prokurimit çon në më tepër korrupsion. Kosova ka afër 170 autoritete kontraktuese.
4. Vetëm drejtuesit e prokurimit publik deklarojnë pasurinë e tyre. Pjesa tjetër e stafit, gjithashtu përballet me rrezikun e korrupsionit, por nuk janë të detyruar ta deklarojnë pasurinë
5. Pozita e gjithë zyrtarëve të cilët punojnë në prokurimin publik është e cënueshme nga korrupsioni
6. Kosova nuk ka një Regjistër të Partnerëve të sektorit publik
7. ARBK-ja nuk i verifikon plotësisht bizneset e huaja para regjistrimit të tyre në regjistrin e bizneseve
8. KRPP-ja nuk kërkon verifikimin e përfituesve të kompanive para nënshkrimit të kontratave publike
9. ARBK-ja nuk ofron informata mbi historinë e menaxherëve të kompanive dhe ofron informata të kufizuara mbi pronësinë e tyre
10. Informatat e ARBK-së nuk janë të përditësuara dhe nuk ofrojnë histori të fakteve juridike
11. Nuk ka mundësi të verifikosh nëse menaxherët ose struktura të tjera që përfaqësojnë një kompani janë ose kanë qenë zyrtarë publikë
12. Kontratat janë të mbyllura dhe jo të hapura për publikun, përveç nëse dikush e kërkon këtë.
13. Qasja në kontrata shpesh refuzohet duke u thirrur në interesa komerciale
14. Ofertat e tenderuesve nuk publikohen

15. KRPP-ja ofron informacion të kufizuar në formatin e lexueshëm nga kompjuterët, shumica e informacionit duhet të shkarkohet në verzionin PDF.
16. KRPP-ja ofron informacion të kufizuar përmes e-prokurimit
17. Qasja në dosjen e e-prokurimit ende është e kufizuar vetëm për operator ekonomik dhe nuk mund të shkrakohet.
18. Agjencia Tatimore e Kosovës ofron transparencë të kufizuar online lidhur me shpenzimin e parasë publike. Qytetarët ose taksapaguesit nuk mund të ndjekin paratë e tyre për të shikuar se ku shpenzohen ato dhe nuk ka informacion online rreth profitit të bizneseve dhe pasqyrave të tyre financiare.
19. Planet e menaxhimit të kontratave, faturat dhe urdhërpagesat nuk janë të hapura për publik dhe qasja në to po kufizohet duke përdorur arsyetime sikur interesat ekonomike dhe sekretet tregtare.
20. Kosova ka shënuar regres në transparencën në prokurimin publik me plotësim ndryshimin e ligjit për PP-të. Nga transparencë ndaj çdo personi, siç ishte më parë, ligji i ri u ofron transparencë individëve të përzgjedhur të cilët mund të dëshmojnë se kanë interes material.
21. Institucionet janë duke kufizuar, në mënyrë të gabuar dhe të padrejtë qasjen në të dhënat e prokurimit duke zbatuar ligjin për qasje në dokumente publike
22. Procesi i qasjes në një kontratë publike merr shumë kohë, deri në 30 ditë
23. Në rastet kur lejohet qasja, ajo zakonisht është e kufizuar
24. Kufizimi i qasjes rrjedh nga neni 12 të LQDP-së, për mbrojtjen e interesave ekonomike tregtare dhe të tjera.
25. Kushtetuta parasheh kufizimin e qasjes në dokumente publike në rastet kur ka sekrete afariste, informacione personale dhe informacione të klasifikuara të sigurisë.
26. Çdo kufizim tjetër për mbrojtje të interesave ekonomike dhe komerciale përbën shkelje të Kushtetutës
27. Gjatë hapjes së tenderëve elektronikë nuk ka ndonjë dëshmitar nga shoqëria civile.

2.0 Contents

1.0 Të gjeturat kryesore	4
3.0 Përmbledhje ekzekutive.....	8
4.0 Hyrje	10
5.0 Metodologjia	15
5.1 Fushëveprimi i hulumtimit	16
6.0 Prokurimi Publik i cënueshëm ndaj korrupsionit	18
6.1 Vendet e OECD-së.....	18
6.2 Kosova	19
7.0 Kostoja e korrupsionit	21
8.0 Rekomandimet e OECD-së për parandalimin e korrupsionit.....	24
8.1 Integriteti në vendet e OECD-së	24
8.2 Kosova	26
9.0 Centralizimi kundrejt decentralizimit në prokurimit publik	28
10.0 Transparenca – Rast studimi.....	34
10.1 Transparenca	34
10.2 Transparenca në prokurimin publik	36
11. Kosova.....	37
11.1 Strukturat qeverisëse në prokurim publik në Kosovë.....	38
11.2 E-prokurimi.....	39
11.4 Administrata Tatimore e Kosovës	45
12.0 Sllovakia	46
12.1 Strukturat qeverisëse për prokurim publik në Sllovaki	48
12.2 Prokurimi elektronik	50
13.0 Përmbledhje e dallimeve ndërmjet Sllovakisë dhe Kosovës në prokurimin elektronik	58
14.0 Regjistri i bizneseve në internet – Sllovaki	59
15.0 Regjistri i partnerëve të sektorit publik	64
16.0 Regjistri i Llogarive	69
17.0 Pjesëmarrja e palëve të interesuara	71

17.1 Kosova	72
18.0 Kontratat e hapura	75
18.1 Çka janë kontratat e hapura?	76
18.2 Bërja publike e informatave rreth planifikimit të kontratave.....	77
18.3 Bërja publike e informatave rreth procesit të tenderimit ose negocimit	79
18.4 Bërja publike e informatave rreth dhënies së kontratave	80
18.5 Bërja publike e informatave mbi zbatimin e kontratave, përfshirë pagesat	82
19.0 Transparenca alternative – rasti i Transparency Slovakia	83
19.1 FOL kërkon reforma ambicioze në prokurimin publik në Kosovë	86
19.2 Krijimi i një platforme paralele të prokurimit publik të hapur	89
20.0 Transparenca aktive kundrejt asaj pasive	91
20.1 Nuk ka transparencë pa e kërkuar atë	92
21.0 Transparenca në prokurimin publik.....	94
21.1 Analizë e legjislacionit.....	94
21.1.1 Transparenca në prokurimin publik.....	94
21.1.2 Kushtetuta	95
21.1.3 Ligji për Prokurim Publik.....	95
21.1.4 Ligji për Qasje në Dokumentet Publike	98
21.1.5 Konflikt ligjesh?	99
21.1.6 Sekretet tregtare dhe qasja në informata.....	100
21.1.7 Kushtetuta	101
21.1.8 Ligji për Qasje në Dokumentet Publike (Ligji nr. 03/L-215)	102
21.2 Transparenca e përfituesve.....	103
21.2.1 Ofertuesit me pronarë të panjohur	104
22.0 Përfundime	106
23.0 Rekomandime.....	108
Bibliografia.....	111

3.0 Përmbledhje ekzekutive

Sot askush në Kosovë nuk e konteston faktin se korrupsioni është pengesa kryesore për zhvillimin e demokracisë. Shoqëria civile vazhdimisht vë në dukje se korrupsioni po e bllokon përparimin e Kosovës, po sjellë zhvillim të padrejtë dhe të pabarabartë në shoqëri. Për më tepër, ai po e ushqen krimin e organizuar dhe kriminelët, duke e dëmtuar kështu imazhin e vendit në arenën ndërkombëtare.

Një raport i kohëve të fundit i [firmës këshillëdhënëse SAR²](#), i autores [Sheelagh Brady](#) për Ambasadën e Norvegjisë në Kosovë, thekson se korrupsioni, ashtu si pushteti politik dhe financiar, është i përqendruar rreth qeverisë, dhe se fushat më të korruptuara janë: prokurimi publik, ndërmarrjet shtetërore dhe bizneset private.

Ndonëse pohime të tilla nuk janë të reja, ato asnjëherë nuk janë më pak shqetësuese. OJQ-të lokale nxjerrin këtë problem në pah çdo ditë. Megjithatë ende ka përpjekje të dobëta për ta çrrënjësuar atë, pjesërisht për shkak se pretendohet se vetë partitë politike dhe udhëheqësit të cilët i udhëheqin institucionet janë të përfshirë në krim të organizuar dhe korrupsion. Rrjedhimisht, ata nuk do ta luftojnë vetveten.

Zbulimi i rasteve të korrupsionit nuk është asnjëherë punë e lehtë. Besohet se shumë biznese të mëdha që veprojnë aktualisht në Kosovë janë të lidhur me politikanë dhe persona që mbajnë pozita të larta, por legjislacioni aktual nuk u mundëson qytetarëve ta shohin këtë pasi që e bllokon transparencën. Në Kosovë nuk ka transparencë të duhur kur vjen puna te shpenzimet publike. Ne nuk e dimë se kush i drejton bizneset që fitojnë tenderë publikë dhe nuk kemi qasje tek përfituesit, të cilët mund të jenë të lidhur me politikanë dhe persona të tjerë të cilët mbajnë pozita të larta.

² http://sarconint.com/?page_id=45

Ka raste kur shoqëria civile dhe mediat kanë bërë presion të drejtpërdrejtë lidhur me individë të përfshirë në krim të organizuar dhe korrupsion, [raste këto në të cilat prokurorisë i është dashur të vepronte](#)³.

Gjithashtu, ka raporte që vënë gishtin në prokurimin publik si fushën më të korruptuar e cila ka krijuar politikanë milionerë⁴. Është opinion i ditur në shoqëri se shumica e kompanive të cilat kanë fituar tenderë publikë gjatë dy dekadave të fundit kanë qenë të lidhura në një mënyrë ose tjetrën me politikanë të rëndësishëm dhe të afërm të tyre në një zinxhir të gjatë.

Lëvizja FOL, vazhdimisht ka monitoruar prokurimin publik në të kaluarën, me theks në transparencën e procedurave që e shtojnë një operator ekonomik të bëjë biznes me qeverinë. Procedurat e tilla jo çdoherë kanë qenë transparente, dhe disa nga kontratat e mëdha nuk janë bërë publike në kohën e duhur. Madje edhe në rastet kur kanë përmbajtur pjesë të ndjeshme të kontratës, ato janë fshehur nga publiku⁵.

Një reformë e cila siguron transparencë rreth shpenzimit të parasë publike, është e nevojshme në prokurimin publik. Një reformë e tillë kërkon ndryshim të ligjeve ekzistuese, miratim të ligjeve të reja dhe një ndryshim në të menduar, i cili promovon transparencën si mjet për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar.

‘Jo tatim pa informim’, është thirrje për transparencë, për ta parë se ku po shpenzohen taksat e qytetarëve. Është hiç më shumë se një e drejtë që t’u kërkojmë vendimmarrësve që të na mundësojnë të shohim se kush përfiton nga taksat tona dhe të shohim se ku po shpenzohen e investohen ato. Ky raport gjithashtu përbën një iniciativë të paparë nga Lëvizja FOL për të vendosur një prokurim publik plotësisht të hapur, një përpjekje për të kursyer paratë e taksapaguesve dhe për të zbuluar korrupsionin e nivelit të lartë.

³ <http://kallxo.com/nisin-hetimet-ndaj-adem-grabovcit/>

⁴ https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/news_corner/news/honouring-25-journalists-2017-eu-investigative-journalism-awards-western-balkans_en

⁵ <http://telegafi.com/zero-tolerance-zero-transparency/>

4.0 Hyrje

Prokurimi publik përbën procesin përmes të cilit autoritetet publike, sikurse departamentet qeveritare ose autoritetet lokale, blejnë punë, mallra ose shërbime nga kompanitë.⁶

Institucionet publike, si dhe ndërmarrjet shtetërore, duhet të prokurojnë mallra, shërbime dhe punë për të realizuar përgjegjësitë dhe kryer detyrat e tyre (OECD, 2016).

Për shkak të vëllimit të lartë të transaksioneve dhe nivelit të interesave financiare të involvuara, prokurimi publik përbën një nga aktivitetet e qeverisë më të rrezikuara dhe të cenueshme nga korrupsioni. Rreziqet nga korrupsionit shtohen për shkak se procesi është i ndërlikuar, për shkak të bashkëveprimit të ngushtë në mes të zyrtarëve publikë dhe bizneseve si dhe numrit të madh të palëve të interesuara (OECD, 2016).

Në vitin 2015, OECD-ja, kishte raportuar se në vendet e OECD-së, vëllimi i përgjithshëm i prokurimit publike llogaritej në 12% të BPB-së dhe 29% të shpenzimeve të qeverisjes së përgjithshme, në vlerë prej 4.2 trilionë euro⁷. Në anën tjetër, siç ka raportuar Partneriteti për Kontrata të Hapura (OCP), kontratat publike për mallra, punë dhe shërbime në mbarë botën arrijnë vlerën e 9.5 trilionë dollarë amerikanë në vit⁸.

Në vitin 2015, Komisioni Evropian kishte raportuar se në Kosovë ishin dhënë **10,895** kontrata, me një vlerë totale prej pothuajse **401 milionë** eurosh, të cilat përbënin **7% të BPB-së** (Komisioni Evropian, 2016).

Në Kosovë ekziston një perceptim i zakonshëm se prokurimi publik, dhënia e kontratave kompanive private, është i cenueshëm nga korrupsioni. (FOL, 2012) (FOL, 2013).

⁶ https://ec.europa.eu/growth/single-market/public-procurement_en

⁷ <http://www.oecd.org/gov/public-procurement/>

⁸ https://d3n8a8pro7vhmx.cloudfront.net/opencontracting/pages/1/attachments/original/1444666090/OCP_Strategy_2015.pdf?1444666090

Ky perceptim konfirmohet çdo vit nga Raporti i Progresit i Komisionit Evropian, ku kritikohet sidomos prokurimi publik. Në vitin 2015, Komisioni kishte shprehur shqetësimin e tij se prokurimi publik përballet me rrezikun e korrupsionit dhe kishte theksuar se në këtë fushë ka monitorim të pamjaftueshëm. (Komisioni Evropian, 2015, f. 41).

Vitin e kaluar BE-ja, sërish kishte arritur në përfundim se perceptimi i korrupsionit në prokurimin publik mbetet i përhapur dhe se zbatimi i rregullave të integritetit mbetet i pamjaftueshëm (Komisioni Evropian, 2016).

Rekomandimi kyç i Komisionit në vitin 2016 ishte që:

“të përmirësohet transparenca në të gjitha fazat e prokurimit publik, në veçanti përmes monitorimit në mënyrë sistematike të zbatimit të tenderëve të prokurimit publik, forcimit të sistemit të kompensimit të dëmeve dhe sigurimit që prokurimi elektronik të funksionojë siç duhet” (Komisioni Evropian, 2016)

Duke qenë në dijeni të faktit se shpenzimet publike kanë ndikim të drejtpërdrejtë në ekonomi, një proces transparent i prokurimit publik nuk është vetëm në interes të publikut, por do të nxiste rritjen ekonomike dhe zhvillimin e sektorit privat dhe do të sillte para përgjegjësisë ata që keqpërdorin autoritetin ose ushtrojnë ndikim për përfitim për veten ose familjet e tyre. (*Transparenca diskutohet hollësisht në faqe 34 së bashku me rastin e Sllovakisë*).

Kosova akoma përballet me probleme që rrezikojnë procesin e prokurimit, si: planifikimi i dobët i prokurimit, mungesa e vlerësimit adekuat të nevojave dhe monitorimi i dobët cilësisë së punës. Komisioni Evropian në vitin 2015, kishte raportuar për mungesë të një vlerësimi të qartë të nevojave dhe të një planifikimi të qartë të buxhetit nga ana e autoriteteve qeveritare. (Komisioni Evropian, 2015).

Me prokurimin elektronik, informacioni tani është më i dukshëm, gjë që u ndihmon bizneseve jo vetëm që të kursejnë kohë, por edhe të jenë të

informuar në mënyrë të barabartë mbi mundësitë e të bërit biznes, por platforma është larg nga të qenit plotësisht e hapur.

Një çështje e rëndësishme është anulimi i thirrjeve për kontrata. Në vitin 2014, rreth 30% të thirrjeve për kontrata ishin anuluar për shkak të vlerësimit të dobët të nevojave dhe numrit të vogël të ofertuesve. Megjithatë, kjo shifër është përmirësuar në vitin 2015, kur ka pasur 14% anulim (Komisioni Evropian, 2015).

Anulimi i thirrjeve për kontrata në rastet kur nuk ka konkurrencë të mjaftueshme, së bashku me mungesën e informatave mbi vlerësimin e nevojave (*planifikimi paraprak i prokurimit*), përbëjnë shqetësim të madh, për shkak të mungesës së konkurrencës dhe parregullsive. Kjo mund të ndikojë drejtpërsëdrejti në çmimin dhe cilësinë, ndaj tregon se ka pak ose aspak besim në neutralitetin dhe paanshmërinë e procesit të prokurimit publik. Kjo lë të kuptohet se bizneset akoma konsiderojnë se procesi është i manipulueshëm.

Kalimi nga prokurimi klasik në atë elektronik përbën një arritje të madhe për Kosovën. Sistemi është larg nga të qenit i përsosur dhe ka shumë probleme që janë raportuar dhe të cilat kanë të bëjnë me atë se sa është i përdorshëm sistemi, siguria dhe performanca e tij. Megjithatë, vetëm ekzistimi e tij përbën një hap të madh përpara drejt transparencës.

KRPP-ja, ka raportuar se sistemi nganjëherë ngadalësohet për shkak të ngarkesës⁹. Platforma ende nuk e mundëson regjistrimin e qytetarëve dhe OJQ-ve që duan t'i shkarkojnë dosjet.

E, megjithatë, ekzistenca e vetë sistemit përbën përparim. Shpalljet për tenderë tani mund të qasen pa u regjistruar, ashtu si edhe informatat kyçe rreth vlerës së kontratave, autoriteteve kontraktuese, procedurave të tenderimit, kritereve për përzgjedhjen, dhe informata të tjera të rëndësishme.

⁹ Safet Hoxha, Kryetar i KRPP-së, pjesëmarrës në tryezën e rrumbullakët "Prokurimi elektronik në Kosovë – sfidat dhe mundësitë". 25 prill 2017, Villa Gërmia, Prishtinë.

Sistemi në vetvete nuk garanton që korrupsioni, nepotizmi dhe favorizimi do të çrrënjosen. Shpalljet për tenderë duhet të mbikëqyrren, në radhë të parë nga ana e KRPP-së, por edhe nga mediat dhe shoqëria civile në mënyrë që kriteret e vendosura nga autoritetet kontraktuese të garantojnë një proces të drejtë dhe të mundësojnë konkurrencë, gjë që ndihmon që të arrihet vlera më e mirë për paratë e shpenzuara.

KRPP-ja, e ka përgjegjësinë kryesore për mbikëqyrjen e shpalljeve, sidomos për sa u përket kriterëve të përzgjedhjes, në mënyrë që korrupsioni, nepotizmi dhe shkeljet e rregullave e të procedurave të shmangen dhe që zyrtarët të veprojnë në përputhje me kodin e mirësjelljes mbi integritetin. Por, KRPP-ja nuk duhet të lihet vetëm në këtë proces. Rol më irëndësishëm në parandalimin e korrupsionit dhe rritjen e transparencës duhet të jetë ai i Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve (ARBK).

ARBK-ja, me ndihmën e Ministrisë së Tregtisë, Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Drejtësisë, duhet të krijojë mjete më efektive për të siguruar më shumë transparencë rreth bizneseve.

Ta kemi të qartë, ne nuk po kërkojmë që bizneseve t'u vështirësohet të ushtrojnë afarizëm në Kosovë, por të hidhet dritë mbi bizneset, të kuptojmë se cilat janë bizneset e vërteta dhe të ndihmohet në parandalimin e korrupsionit.

Bizneseve u jepen çdo javë shuma të mëdha parash nga tatimpaguesit përmes kontratave publike. Ne duhet të sigurohemi që biznese të tilla nuk drejtohen nga persona të lidhur me partitë politike, të cilët mund ta përdorin pushtetin e tyre për të drejtuar një kontratë kah një biznes i caktuar.

Komisioni Evropian rregullisht i kërkon Kosovës që të hetojë pasuritë e pashpjegueshme (Komisioni Evropian, 2015). Ne besojmë se kjo pasuri e pashpjegueshme është gjeneruar kryesisht përmes prokurimit publik, pra nga paratë e tatimpaguesve.

Nuk kemi dëshmi për të treguar se si politikanë të caktuar dhe individë me ndikim, persona të cilët drejtojnë agjencitë shtetërore dhe ndërmarrjet, dhe individë të tjerë, kanë mbledhur pasuri të tillë të pashpjegueshme. Nëse do t'i kishim do t'ua kishim prezantuar ato prokurorëve, por jemi të bindur se transparenca mund të hedhë dritë në këtë drejtim.

Mënyra më e mirë është të zbulohen informatat lidhur me përfituesit (beneficiaries), menaxherët e bizneseve dhe pronësia e tyre. Pastaj, të verifikohet ligjshmëria e bizneseve vendore dhe të huaja. Kësisoj do të jemi në gjendje t'i kërkojmë, hulumtojmë dhe të gjykojmë për vete si qytetarë, si media dhe si shoqëri civile.

Prandaj, ky raport bën thirrje për reformë në transparencën e prokurimit publik, mbase reforma më e madhe që është bërë ndonjëherë. Për ta bërë këtë, duhet të jemi pro-aktivë, na duhet ndihma e institucioneve dhe udhëheqësve për të kuptuar seriozitetin e situatës dhe për të kuptuar se transparenca nuk do t'i dëmtojë, por do t'u ndihmojë atyre.

Në epokën digjitale, ku secili ka qasje në informata, transparenca nuk mund të jetë zgjedhje, por domosdoshmëri.

Raporti është i ndarë në dy kapituj, 23 kryetituj dhe 31 nëntituj. Në kapitullin e parë flasim për korrupsionin në prokurimin publik, duke sjellë raportet e fundit nga Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), rreth korrupsionit në prokurimin publik, dhe përpiqemi të ndërlidhim këto të gjetura me Kosovën, në mënyrë që të ofrojmë një pasqyrë krahasuese. Përgjatë këtij kapitulli korrupsioni analizohet në aspektin e mungesës së transparencës në këtë proces, dhe si rezultat i kësaj.

Kjo i hap rrugën kapitullit të dytë, ku flasim për transparencën në prokurimin publik në Kosovë ose mungesën e saj. Në këtë kapitull sjellim një rast studimor, me qëllimin që të përçojmë me lehtë mesazhin e raportit. Si rast studimor është zgjedhur Sllovakia. Ky shtet është zgjedhur si e tillë për këto arsye: është vend që ka vuajtur nga korrupsioni në prokurimin publik, është pjesë e BE-së, së cilës Kosova synon t'i bashkohet

dhe nuk është ekonomi e avancuar, që nënkupton se reformat e tyre mbi transparencën mund të kopjohen nga cilido vend.

Në këtë kapitull analizohen kryesisht ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet Kosovës dhe Sllovakisë rreth dizajnit institucional dhe legjislacionit për transparencë në prokurimin publik. Në pjesën mbi modelin institucional analizohen dhe krahasohen ngjashmëritë dhe dallimet në funksionet dhe kapacitetet profesionale të institucioneve dhe mungesa e tyre. Për shembull, Sllovakia ka disa institucione që rregullojnë prokurimin publik e të cilat nuk ekzistojnë në Kosovë. Në pjesën mbi legjislacionin analizojmë ligjet dhe rregullat kryesore që rregullojnë transparencën në prokurimin publik. Në këtë pjesë analizojmë pengesat kryesore në Kosovë që pengojnë transparencën dhe i krahasojmë ato me legjislacionin sllovak që mundëson më shumë transparencë. Në këtë kapitull gjithashtu sjellim rastin e organizatës “*Transparency International*”, në Sllovaki (*Transparency International Slovakia*), në ndërtimin e platformës për prokurim publik të hapur, krahas zyrës së prokurimit publik, si dhe atë se si Lëvizja FOL, është duke marrë iniciativën për të ndërtuar një platformë të ngjashme në Kosovë. Në fund japim një listë rekomandimesh mbi atë se si të sjellim transparencë në prokurimin publik.

Në këtë raport prezantohen 14 rubrika të veçanta me informata të qarta dhe të sakta. Pasi që Sllovakia është rasti ynë studimor, shumë prej këtyre rubrikave sjellin dallimet kryesore ndërmjet Kosovës dhe Sllovakisë, por edhe raste studimore nga vende të tjera.

5.0 Metodologjia

Metodologjia e përdorur në këtë studim konsiston kryesisht në hulumtime në zyrë rreth transparencës në prokurimin publik. Metodot përfshijnë hulumtime të gjera në zyrë, mbledhjen e informatave, intervista, kontrollimin e fakteve, raste studimore, analiza krahasuese dhe shkrimin e raportit. Për qëllime hulumtimi shumë institucioneve u janë dërguar kërkesa për qasje në dokumente publike. Gjithashtu, kemi konsultuar, lexuar dhe analizuar masë të madhe të literaturës mbi prokurimin publik.

Më konkretisht, pasi që raporti merret vetëm me çështjen e transparencës në prokurimin publik, janë konsultuar raporte të shoqërisë civile – vendore dhe ndërkombëtare – për transparencën. Janë lexuar publikime, artikuj dhe revista akademike që trajtojnë transparencën në prokurimin publik, ndërkohë që janë shfletuar dhe analizuar edhe ueb-faqe të organeve të prokurimit publik në Kosovë, Sllovaki, dhe në vende të tjera, përfshirë ueb-faqe, raporte dhe publikime rreth bizneseve.

5.1 Fushëveprimi i hulumtimit

Ky raport fokusohet në luftimin e korrupsionit në prokurimin publik përmes transparencës. Prandaj këtu nuk analizohen aspekte të tjera të prokurimit publik, siç janë procedurat, korniza institucionale, efektiviteti e efikasiteti dhe aspekte të tjera. Transparenca mund të kontribuojë në natyrën praktike të procedurave dhe efektivitetit.

KAPITULLI - I

6.0 Prokurimi Publik i ceneshem ndaj korrupsionit

6.1 Vendet e OECD-së

OECD-ja, vlerëson se prokurimi publik është një nga aktivitetet e qeverisë më i ceneshti nga korrupsioni.

Përvetësimi i fondeve, ndikimi jo i duhur në vlerësimin e nevojave, dhënia e ryshfetit zyrtarëve publikë të përfshirë në procesin e dhënies së kontratave, ose **mashttrimet** në vlerësimin e tenderëve, faturave apo obligimeve kontraktuese përbëjnë veprimet më të përsëritura dhe të vazhdueshme në prokurimin publik (OECD, 2016).

Në shumë vende të OECD-së, rreziqe të mëdha të korrupsionit lindin nga **konflikti i interesit** në vendimmarrje, gjë që mund të shtrembërojë shpërndarjen e burimeve përmes prokurimit publik (Komisioni Evropian, 2014).

Për më tepër, **manipulimi i tenderëve** dhe **kartelizmi** mund të dëmtojnë edhe më tej procesin e prokurimit. Në vitin 2014, mbi gjysma e rasteve të ryshfetit nga palët e jashtme kanë ndodhur në procesin e fitimit të një kontrate të prokurimit publik, dhe pothuajse dy të tretat e rasteve të studiara të ryshfetit nga palët e jashtme kanë ndodhur në sektorët e lidhur ngushtë me kontrata ose licencim përmes prokurimit publik: në

sektorët e nxjerrjes së burimeve natyrore, ndërtimit, transportit dhe magazinimit, dhe në atë të informimit dhe komunikimit (OECD, 2015).

6.2 Kosova

Në vitin 2016, Kosova u rendit e 95-a, nga 176 vende, në Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit, të “*Transparency International*”, dhe ishte ranguar me 36 pikë, nga gjithsej 100¹⁰.¹¹ Ajo renditej e 66-a, nga 189 vende, në raportin e Bankës Botërore për të bërit biznes¹².

Në një sondazh të kryer nga UNDP-ja, 18% e qytetarëve e kishin përmendur korrupsionin si problemin e dytë, pas papunësisë, gjë që përbënte një ngritje, pasi që vazhdimisht renditej në vendin e tretë. 58% e të anketuarve besojnë se gjendja sa i përket korrupsionit nuk ka ndryshuar në 12 muajt e fundit dhe shumica e



Rubrika Fakteve - I

Raporti i Auditorit të Përgjithshëm në Kosovë

Parregullsitë kyçe në prokurim në nivelin qendror dhe atë lokal në Kosovë në vitin 2015:

Çështja: Blerjet pa procedura të prokurimit në raste kur kërkohet prokurimi. Shmangia e procedurave të hapura të prokurimit, aplikimi i kuotimit të çmimeve apo procedura me vlerë minimale.

Shkaku: Mungesa e kontrollit për të siguruar zbatimin e kërkesave të prokurimit në raport me madhësinë e kontratës

Ndikimi: Më pak konkurrencë dhe transparencë sjellin në dështim për të arritur vlerën për paratë e dhëna ose humbje të mundshme financiare.

Çështja: Mungesa e projekteve për investime kapitale

Shkaku: Mungesa e stafit me njohuri për dizajnimin e projekteve dhe neglizhenca e menaxherëve për ndarjen e fondeve të duhura për kontraktimin e këtyre shërbimeve.

Ndikimi: Mungesa e projekteve rrezikon cilësinë e punimeve dhe vlerën për paratë e dhëna, dhe ka rrezik se ndërtimi do të kushtojë më shtrenjtë se planifikimi.

¹⁰ <https://www.transparency.org/country/KOS#>

¹¹ 95 është rangimi i ulët, që nënkupton vendi i korruptuar, kur dihet se 176 është vendi më i korruptuar; kurse 36 është rangim i lartë duke konsideruar që 100 është vendi më pak i korrumpuar sipas metodologjisë së TI-së.

¹² <http://www.doingbusiness.org/data/exploreeconomies/kosovo>

pjesëmarrësve në fokus-grupe besojnë se korrupsioni është i përhapur në institucionet qendrore, përkatësisht në ndërmarrjet publike, **zyrat e prokurimit** dhe në sistemin e drejtësisë. (UNDP Kosova, 2016)

Në raportin e saj vjetor, Agjencia Kundër Korrupsionit (AKK), ka ngritur kallëzime penale ndaj menaxherëve dhe zyrtarëve të prokurimit publik për shkelje të procedurave dhe të të drejtave të operatorëve ekonomikë, dhe ka lëshuar 62 opinione dhe 25 këshilla për parandalimin e korrupsionit në prokurimin publik. (Agjencia Kundër Korrupsionit, 2016)

Zyra e Çështjeve Ekonomike dhe Tregtare, në Deklaratat e saj për Klimën e Investimeve për vitin 2016, publikuar nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara në Kosovë, jep një pasqyrë të përgjithshme të Kosovës lidhur me klimën e investimeve, duke vënë në dukje se në vitin 2016 Kuvendi ka miratuar ndryshimet në Ligjin e Prokurimit Publik që e bëjnë të

detyrueshëm prokurimin elektronik, me qëllim të përmirësimit të transparencës dhe zvogëlimit të rrezikut të korrupsionit. Aty vihet në dukje se ndonëse qeveria kërkon transparencë, kompanitë ndërkombëtare që konkurrojnë për kontrata të prokurimit publik me vlerë të lartë kanë raportuar parregullsi të shumta. Disa menaxherë të prokurimit në njësitë buxhetore të Kosovës janë paditur për korrupsion.

Në këtë raport vihet në dukje se pak organizata të sektorit privat dhe organizata jo-qeveritare shërbejnë si vëzhgues ose organizojë ofrim të kontributit si palë të interesuara në proceset rregullatore.

Në pjesën rreth korrupsionit raporti arrin në përfundimin se korrupsioni është **më i përhapuri në prokurimin publik** dhe se pranohet, si nga

Çështja: Mungesa faturave të sasisë.

Shkaku: Mungesa e përgjegjësisë dhe kontrolleve të mjaftueshme nga nivele të larta të kontrollit..

Ndikimi: Kjo tregon dobësi në identifikimin e nevojave, shkakton kosto shtesë e ndryshime në buxhet, dhe qon në vonesa në ekzekutimin e kontratave.

Çështja: Mosrespektimi i kërkesave të LPP-së

Shkaku: Dobësitë sistematike në prokurim për shkak se zyrtarët përkatës u janë shmangur procedurave dhe udhëzimeve të prokurimit

Ndikimi: Favorizim potencial ose diskriminim i Eos. Është arritur vlerë e dobët për paratë e dhëna dhe/ose shërbimet e specifikuar që janë ofruar.

bizneset vendore ashtu edhe ato ndërkombëtare, si një nga pengesat më të mëdha të Kosovës për të tërhequr investime.¹³

Komisioni Evropian, ka ngritur shqetësimin e tij në lidhje me numrin e madh të autoriteteve kontraktuese¹⁴, gjë që, sipas tyre, paraqet rrezik të lartë për korrupsionin¹⁵. Ky shqetësim duhet të lexohet si i ndërlidhur me kreun mbi anët pozitive dhe negative të decentralizimit apo centralizimit të prokurimit publik në faqe 27 . BE-ja, potencon se vazhdon të ketë rreziqe dhe mangësi në të gjitha fazat e prokurimit publik (Komisioni Evropian, 2016).

Ndonëse ligji i ri për prokurimin publik vendos mekanizma të rinj në lidhje me integritetin e zyrtarëve, megjithatë, BE-ja ka bërë të ditur se perceptimi i korrupsionit në prokurimin publik mbetet i përhapur dhe se zbatimi i rregullave të integritetit mbetet i pamjaftueshëm (Komisioni Evropian, 2016). *Sa i përket analizës sonë rreth rregullave të integritetit në prokurimin publik, shihni faqe 28*

7.0 Kostoja e korrupsionit

Sipas OECD-së, kostoja e drejtpërdrejtë e korrupsionit përfshinë humbjen e fondeve publike nëpërmjet ndarjes së tyre në mënyrë të gabuar ose shpenzimeve të larta e me cilësi të ulët të mallrave, shërbimeve dhe punëve (OECD, 2015).

Në rastet e prokurimit publik të punëve, ata që paguajnë ryshfet përpiqen të rikthejnë paratë e tyre **përmes fryrjes së çmimeve, faturimit të punëve që nuk i kanë kryer, dështimit të përmbushjes së standardeve të kontratës, uljes së cilësisë së punës, ose përmes përdorimit të materialeve të dobëta**. Kjo rezulton në kosto të tepruara dhe rënie të cilësisë.

¹³<https://www.state.gov/e/eb/rls/othr/ics/investmentclimatestatements/index.htm?dliid=254379&year=2016#wrapper>

¹⁴ Deri më tani në sistem janë regjistruar 174 autoritete kontraktuese.

¹⁵ Shihni kreun (...) për centralizim kundrejt decentralizimit. FOL gjithashtu beson se një sistem shumë i decentralizuar i prokurimit çon në më shumë korrupsion.

Ndonëse është e vështirë të matet kostoja e saktë e korrupsionit në vendet e OECD-së, për shkak të natyrës së tij të fshehtë, është vlerësuar se rreth 10-30% e investimeve në projektet e ndërtimit me fonde publike mund të humben për shkak të keqadministrimit dhe korrupsionit (COST, 2012).

Iniciativa për Transparencë në Sektorin e Ndërtimeve (CoST), vlerëson se *“humbjet vjetore në ndërtime, në nivel global, për shkak të keqmenaxhimit, joefikasitetit dhe korrupsionit, deri në vitin 2020 mund të arrijnë në 2.5 trilionë dollarë amerikanë ”* (COST, 2012).

Brenda Bashkimit Evropian, korrupsioni në përgjithësi vlerësohet të kushtojë rreth 120 miliardë euro në vit (Komisioni Evropian, 2014a), gjë që përfaqëson rreth 1% të BPB-së së BE-së, dhe përfaqësonte pak më pak se buxheti vjetor i BE-së në vitin 2014, i cili ishte 143 miliardë euro (Komisioni Evropian, 2014b).

Sa i përket kostos indirekte, korrupsioni në prokurimin publik çon në dëmtimin e konkurrencës, qasjen e kufizuar në treg dhe uljen e nxitjes së investitorëve të huaj për të bërë biznes.

Në Kosovë nuk ka vlerësime të kostos së korrupsionit në prokurimin publik. Është perceptim i përgjithshëm se rreth 20% e tenderëve shkojnë në xhepat e zyrtarëve qeveritarë. Bizneset zakonisht e përkthejnë këtë 20% në **fryrje të çmimeve, faturim për punë që nuk kryejnë, ulje të cilësisë së punës, ose duke përdorur material të dobët**. Përdorimi i materialit të dobët për të mbuluar humbjet në ryshfet që u shkojnë zyrtarëve qeveritarë konsiderohet si lloji më i zakonshëm i korrupsionit në Kosovë.^{16 17 18}

¹⁶ <http://archive.koha.net/?id=9&l=1589> “Asfaltohet rruga, prishet pas një muaji!”

¹⁷ <http://cms.koha.net/?id=9&l=38584> “Rruga e asfaltuar në Fushë Kosovë prishet një vit pas ndërtimit”

¹⁸ <http://www.gazetaexpress.com/lajme/ndodh-edhe-kjo-rruga-e-asfaltuar-para-dy-dite-prishet-ne-prizren-video-399017/>

8.0 Rekomandimet e OECD-së për parandalimin e korrupsionit

8.1 Integriteti në vendet e OECD-së

Çka është integriteti në prokurimin publik?

Sipas rekomandimeve të OECD-së, të dala nga Këshilli për Prokurimin Publik, i vitit 2015, integriteti në prokurimin publik i referohet:

“...përdorimit të fondeve, burimeve, pasurive dhe autoritetit në përputhje me qëllimet e synuara zyrtare dhe në një mënyrë që është e mirë-informuar, në përputhje me interesin publik, dhe në përputhje me parimet më të gjera të qeverisjes së mirë;” (OECD, 2015)

Integriteti i akterëve në procesin e prokurimit mund të zvogëlojë ndjeshëm rrezikun e korrupsionit. Integriteti i referohet respektimit të standardeve etike dhe vlerave morale të ndershmërisë, profesionalizmit dhe të drejtësisë, dhe është një guri themeltar për të siguruar drejtësi, mos-diskriminim dhe respektimin e rregullave në procesin e prokurimit publik. Duke njohur rëndësinë e integritetit për qeverisje të mirë dhe besim në institucionet publike, vendet zbatojnë **standarde kombëtare të integritetit për të gjithë zyrtarët publikë**, për shembull, nëpërmjet **rregulloreve të shërbimit civil** ose një **kodi të përgjithshëm të mirësjelljes** që përvijon standardet dhe pritjet për mirësjelljen e nëpunësve civilë. Shpesh ekziston një departament i veçantë

qeveritar i dedikuar për këtë qëllim, i cili është përgjegjës për zhvillimin, përditësimin dhe shpërndarjen me qëllim të zbatimit, të kodit të mirësjelljes, dhe mund të ofrojë, në formë të përshtatur, këshilla, udhëzime dhe shembuj praktikë në mbështetje të zbatimit të kodit.

Situatat më të zakonshme të konfliktit të interesit lidhen me interesa dhe aktivitetet personale, familjare ose afariste, me dhurata dhe shërbime turistike e të rekreacionit, zbulimin e informatave konfidenciale, dhe ofrimin e vendeve të punës në të ardhmen. Prandaj, standarde shtesë mund të përfshijnë dispozita mbi kërkesat e deklarimit të pasurisë, procedura të publikimit të informatave, dhe masa mbrojtëse për publikuesit e këtyre informatave që njihen edhe si “sinjalizues” (whistleblowers).



Rubrikë e Shkurtër - I

Kodi i Mirësjelljes në Prokurim Publik në Kosovë

Kodi i Mirësjelljes për Prokurim Publik në Kosovë është përditësuar më së fundmi në vitin 2016 nga Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik.

Objektivi Kodit është përcaktimi i vlerat thelbësore, standardet etike të sjelljes dhe parimet kryesore në prokurimin publik. Këto parime në të cilat bazohet Kodi i Mirësjelljes janë: integriteti, konfidencialiteti, aftësia profesionale dhe objektiviteti.

Ky kod gjithashtu përfshin disa lloje të sjelljes si: deklarimi i interesit (gjë që do të thotë se kudo që ka konflikt interesi në një procedurë prokurimi publik, ata duhet ta deklarojnë atë), ndarja e qartë e punës, konfidencialiteti, ndalimin për të pranuar dhurata dhe ryshfet, ndalimi për të punuar me biznese që nuk janë regjistruar në Kosovë dhe ato që nuk paguajnë tatime, dhe përpjekjet për krijimin e një konkurrencë të drejtë.

Ai gjithashtu përcakton se çfarë është konflikti i interesit në procesin e prokurimit dhe sqaron rrethanat në të cilat mund të paraqitet.

Ai jep indikacione të qarta se kur një proces i prokurimit publik mund të jetë në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes, të cilat quhen alarme në të kuqe, që përfshijnë, por jo vetëm, si në vijim: devijimin nga procedurat standarde, fatura të parregullta, humbjen e dokumentacionit, rezistimin për t'u audituar, stilin diktatorial të menaxhimit, etj.

Sa i përket menaxhimit të konfliktit të interesit, të gjitha vendet e OECD-së të mbuluara si pjesë e Anketës së OECD-së, të kryer në vitin 2014, për Menaxhimin e Konfliktit të Interesit në Degën e Ekzekutivit dhe Mbrojtjen e Informatorëve, kanë raportuar se posedojnë politikat, rregullat dhe procedurat për menaxhimin e konfliktit të interesit të zyrtarëve publikë. **Shkeljet e integritetit nga ana e kompanive mund të çojë në përjashtim të përhershëm ose të përkohshëm nga proceset e prokurimit publik.** Në përputhje me legjislacionin e BE-së, në shtetet anëtare të BE-së, janë në fuqi rregulla të detyrueshme të ndalimit/përjashtimit, sipas të cilave ofertuesit kundër të cilëve janë dhënë dënime të formës së prerë për korrupsion përjashtohen nga tenderët e ardhshëm (Komisioni Evropian, 2014a).

8.2 Kosova

Kosova ka një Kod të Mirësjelljes (KM) në prokurimin publik, të përditësuar më së fundmi në vitin 2016. Ky kod i mirësjelljes është shkruar mirë dhe synon standardet më të larta të moralit tek zyrtarët e prokurimit publik. Sipas kodit të mirësjelljes: të gjithë zyrtarët e prokurimit publik, anëtarët e komisioneve për vlerësimin e ofertave, si dhe zyrtarët e KRPP-së, OShP-së dhe AQP-së, duhet të betohen. (KRPP, 2016)

Kodi i mirësjelljes bazohet në parime si integriteti, konfidencialiteti, aftësia profesionale dhe objektiviteti. KM-ja kërkon që të gjithë zyrtarët publikë të japin një deklaratë të interesit, gjë që do të thotë se kurdo që ka një konflikt interesi në një procedurë prokurimi publik, ata duhet ta deklarojnë atë. Ai kërkon një ndarje të qartë të punës, në mënyrë që zyrtarët të mos nënshkruajnë dokumente që nuk kanë nevojë t'i nënshkruajnë. Ai ndalon pranimin e dhuratave dhe ndarjen e informatave konfidenciale të prokurimit, dhe gjithashtu dhënien e informatave të rreme ose mashtruese gjatë procesit të prokurimit.

Ai ndalon që të punohet me biznese që nuk janë të regjistruar në Kosovë dhe që nuk paguajnë tatimet. Ai përvijon të gjithë skenarët kur dhuratat mund të pranohen dhe ata në të cilët dhuratat duhet të refuzohen. Ai gjithashtu përcakton se çfarë përbën konflikt interesi në procesin e prokurimit dhe si duhet shmangur atë. Për më tepër, KM jep indikacione

të qarta se kur procesi i prokurimit publik mund të jetë në kundërshtim me të, raste të cilat i quan **flamuj të kuq**. Këto raste mund të përfshijnë shmangie nga procedurat standarde, fatura të parregullta, humbjen e dokumentacionit, rezistimin për t'u audituar, etj.

Ndonëse KM-ja është i shkruar mirë dhe vendos shumë masa, megjithatë mekanizmi i monitorimit dhe zbatimit është i dobët. Nuk ka raste të raportuara kur një zyrtar i prokurimit është përjashtuar nga puna apo është marrë ndonjë masë disiplinore për shkelje të kodit të etikës. Raporti vjetor i KRPP-së nuk përmend raste të tilla, kure raporti i Komisioni Evropian thotë se zbatimi i rregullave të integritetit është i pamjaftueshëm (Komisioni Evropian, 2016, p. 49).

Ka pyetje të thjeshta që duhet përgjigjur, të tilla si çfarë ndodh nëse një zyrtar merr një dhuratë që nuk duhet ta marrë dhe askush nuk e raporton këtë? Çfarë ndodh nëse një person nuk deklaron konfliktin e interesit dhe askush tjetër nuk e raporton këtë? Çfarë ndodh nëse një zyrtar shkel KM-në dhe askush nuk e raporton atë? A ka departamenti për monitorim dhe mbikqyrje në KRPP, mjete të duhura dhe kapaciteti për të parandaluar rastet e konfliktit të interesit dhe zbatimin e rregullave të integritetit?

Duhet të ketë një institucion që mbikëqyr rregullisht punën e zyrtarëve të prokurimit publik. Siç e dimë, vetëm krerët e zyrave të prokurimit janë të detyruar ta deklarojnë pasurinë, dhe jo pjesa tjetër e zyrtarëve. Kjo duhet të ndryshojë, pasi që të gjithë zyrtarët që punojnë në prokurim publik janë të cënueshëm ndaj korrupsionit, për shkak të natyrës tejet të ndërlikuar të prokurimit publik dhe rreziqeve të tij. Deklarimi i pasurisë nga të gjithë zyrtarët e prokurimit do ta forconte KM-në në aspektin e zbatimit.

9.0 Centralizimi kundrejt decentralizimit në prokurimit publik

OECD-ja vlerëson se korrupsioni në prokurimin publik mund të ndodhë si në nivelin kombëtar (qendror) ashtu edhe në atë komunal (lokal).

Në njëërën anë, përparësitë e centralizimit në prokurimin publik janë se çon në kontrata të prokurimit me vëllim të madh, gjë që mund të ulë çmimet përmes arritjes së ekonomisë së shkallës (masive), si dhe rritjes së konkurrencës. Për më tepër, kjo zvogëlon dyfishimin, kostot e transaksionit, si dhe përmirëson sigurinë, thjeshtësinë dhe uniformitetin, duke mundësuar arritjen e rezultateve më të fokusuara të qëllimeve të politikave.¹⁹

Mangësia e kësaj është se mund të rrisë rrezikun e korrupsionit, pasi që rrit shumën e parave që jepen përmes tenderëve. Në demokracitë e paqëndrueshme dhe vendet në zhvillim (si Kosova²⁰), ku institucionet e pavarura janë të brishta, në rastet kur tenderët janë të mëdhenj, edhe përpjekjet nga kompanitë për të ndikuar në proces janë po aq të mëdha. Sa më të mëdhenj tenderët, aq më tepër i tërheqin kompanitë/bizneset e mëdha dhe me ndikim. Kompani të tilla (*në rastin e Kosovës shumë kompani të mëdha janë të huaja*) rekrutojnë sekserë që të përpiqen t'u japin ryshfet zyrtarëve të prokurimit publik dhe politikanëve, për të ndikuar vendimet e tyre në favor të vetin.

Në anën tjetër, përparësitë e decentralizimit në prokurimin publik janë se mund të ngushtojë hapësirën për korrupsion, në përputhje me supozimin se politikanët dhe zyrtarët publikë në nivele komunale janë më të përgjegjshëm ndaj qytetarëve të cilëve u shërbejnë. Votuesit mund të jenë më mirë për të dalluar cilësinë e udhëheqësve të tyre dhe rezultatet që ata

¹⁹ <http://www.oecd-ilibrary.org/docserver/download/4215081ec045.pdf?expires=1496926425&id=id&accname=guest&checksum=E222F1DA1F835F66BDF7BEC68E165C7>

²⁰ Shënim i autorit.

ofrojnë. Po kështu, politikanët dhe nëpunësit civilë lokalë mund të jenë më shumë në kontakt me nevojat dhe kontekstin specifik të elektoratit të tyre (OECD, 2015).

Ana negative e kësaj është se në nivelin komunal (lokal) kapacitetet e qeverisjes mund të jenë më të dobëta, gjë që shpesh përkthehet në funksionet më pak të zhvilluara të auditimit, ekspertizë të kufizuar ligjore ose kapacitete të dobëta të teknologjisë informative, ose kontakte më të ngushta në nivel komuniteti ndërmjet zyrtarëve publikë dhe përfaqësuesve të bizneseve.

Centralizimi dhe decentralizimi që të dyja kanë përparësitë dhe mangësitë e tyre. Duke njohur kontekstin e Kosovës, ka kuptim që AQP-ja të centralizojë gjithnjë e më shumë produkte. Arsyeja e kësaj qëndron në atë se ekzistimi i shumë autoriteteve kontraktuese vështirëson jo vetëm auditimin nga ana e auditorit të përgjithshëm, por edhe monitorimin nga ana e shoqërisë civile, mediave dhe qytetarëve. Ndërveprimi i ngushtë mes zyrtarëve të prokurimit dhe bizneseve është i pashmangshëm në rastet kur ka shumë autoritete kontraktuese dhe shumë zyrtarë të prokurimit.

Në vitin 2011 është miratuar ligji i ri për prokurimin publik, i cili i ka dhënë fund mandatit të Agjencisë së atëhershme të Prokurimit Publik (APP) dhe ka themeluar Agjencinë Qendrore të Prokurimit (AQP)²¹.

Të gjitha arkivat, personeli dhe pasuritë janë transferuar nga APP-ja në AQP. Para se t'i ndryshohej mandati, AQP-ja ishte agjenci e pavarur që nxirrte vendime dhe mendime mbi procedurat e prokurimit publik. Megjithatë, ajo gjithashtu prokuronte mallra në nivel qendror, me kërkesë të qeverisë²².

Deri më sot nuk ekziston ndonjë analizë rreth asaj se çfarë lloj ndikimi ka sjellë ndryshimi i mandatit nga APP-ja për AQP. Komisioni Evropian, në raportin e tij të vitit 2016 për vendin, kishte tërhequr vëmendjen në lidhje me numrin e madh të autoriteteve kontraktuese, duke thënë se **“numri i madh i subjekteve (174 autoritete kontraktuese) sjell një rrezik**

²¹ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2772>

²² <https://aqp.rks-gov.net/sq/raportet>

në rritje të korrupsionit", duke nënkuptuar se vendi duhet të lëvizë drejt centralizimit më të madh.

Në nëntor 2016 Lëvizja FOL, ka publikuar një hulumtim mbi një shkelje ligjore në një kontratë të prokurimit publik nga ministri i atëhershëm i financave, Avdullah Hoti, i cili kishte refuzuar t'i nënshkruante tri kontrata, në vlerë prej 12 milionë euro. Kontratat ishin nënshkruar nga kreu i AQP-së, në bazë të ligjit në fuqi, por ministri kishte refuzuar t'i nënshkruante, pa ndonjë justifikim të arsyeshëm, dhe kishte shfrytëzuar autoritetin e tij për të frikësuar kreun e AQP-së dhe kishte ushtruar ndikim mbi KRPP-në, Auditorin e Përgjithshëm dhe OShP-në²³.

Raste të tilla, ku agjencitë e pavarura dhe ato shtetërore mund t'i nënshtrohen rrezikut të ndikimit politik, rrezikojnë integritetin e këtyre institucioneve dhe nuk shkojnë në dobi të centralizimit të prokurimit publik. Por, alternativa e kësaj është decentralizimi dhe shumë autoritete kontraktuese, gjë që është e bën prokurimin publik më të cënueshëm ndaj çfarëdo lloj ndikimi. Ajo çfarë nevojitet janë më tepër rregulla të integritetit, mbrojtja e informatorëve dhe mbikëqyrja dhe auditimi më e pavarur. Për më tepër, në rastet kur ushtrohet ndikim i tepruar mbi agjencitë e pavarura, duhet të ketë hetim nga prokuroria dhe të ndëshkohen si duhet nga sistemi i drejtësisë. Ky përbën mekanizmin më të mirë të frenimit dhe parandalimit.

²³ <http://levizjafol.org/folnew/wp-content/uploads/2016/11/Raporti-FINAL.pdf>



Rubrikë e Shkurtër - II

Agjencia Qendrore e Prokurimit në Kosovë

Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP) është agjenci e pavarur ekzekutive funksioni kryesor i së cilës është kryerja e procedurave të prokurimit të centralizuar për nivelin qendror dhe atë lokal.

Në vijim është një listë e artikujve që duhet të prokurohen nga AQP për nivelin qendror. Kjo listë është miratuar në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2017. Autoritetet Kontraktuese të përfshira në listën qendrore të blerjes nuk janë të autorizuar të zhvillojnë procedura të prokurimit për:

- Furnizim me karburante
- Furnizim me letër për kopjim
- Furnizim me material shpenzues për zyrë
- Furnizimi me materiale, mjete dhe pajisje pastrimi
- Furnizimi me produkte ushqimore dhe shërbime për të ofruar ushqim
- Furnizimi me bileta aeroplani
- Furnizimi me goma
- Furnizimi me pajisje të TI-së
- Shërbimet e fotokopjimit
- Furnizimi me vajra të makinave
- Shtypja

Burimi: <https://aqp.rks.gov.net/Uploads/Documents/Njoftim%20oper%20Autoritetet%20%20Kontraktuese%20Nivel%20qendror%20dhe%20Lokal> wvgauoukxs.pdf



Rubrikë e Shkurtër - III

Slovakia

Ministria e Brendshme vepron si organi qendror blerës për mallra, shërbime dhe punë që janë rëndom në dispozicion. MPB-ja menaxhon me një platformë në internet. EKS-ja, përfshin një treg elektronik, një sistem dinamik për blerje dhe një sistem për regjistrimin e të dhënave.

Shteti, komunat, administratat rajonale, si dhe organizatat e menaxhuara nga ana e tyre janë të detyruar të blejnë përmes tregut elektronik nëse vlera e mallrave, shërbimeve ose punëve ndërtimore tejkalon shumën prej 1,000 eurosh dhe arrin deri në 134,000 euro, për shtetin, ose deri në 207,000, për prokuruesit e tjerë. Kufiri për ndërtime është 5,186,000 euro.



Rubrikë e Shkurtër - IV

Prokurimit qendror në Shtetin e Luizianës

Zyra e Prokurimit të Shtetit (ZPSH), u shërben agjencive dhe njerëzve të Luizianës duke siguruar që aktivitetet e shtetit për kontraktim dhe blerje të kryhen në mënyrë të ligjshme, të drejtë dhe efikase.

Në vijim është një listë e artikujve që duhet të prokurohen në nivelin qendror nga ZPSH-ja:

Programe kompjuterike, duke përfshirë mirëmbajtjen e:

- Enterprise Server computer and peripherals (mainframe)
- Kompjuter Enterprise Server me pajisje përcjellëse (procesorë të mëdhenj)
- Serverë Intel File me aplikacione, dhe pajisje përcjellëse
- Kompjuterë personale dhe pajisje përcjellëse (përfshirë desktope, laptope, monitorë, printerë, skanerë, *Personal Digital Assistants* (PDA), pajisje tableti si iPad dhe pajisje të tjera të versionit smart)
- Komplekse personale të *Computer-Assisted Design and Drafting* (CADD) dhe pajisje përcjellëse
- Komplekse të *Sistemit Informues Gjeografik* (GIS) dhe pajisje përcjellëse
- Projektore për kompjuterë
- Çfarëdo sistemesh të tjera kompjuterike dhe/ose pajisje komunikimi pajisjes dhe pajisje përcjellëse (përfshirë krijimin e rrjeteve, pikave të qasjes në internet pa kablo, pajisje për leximin e disqeve, monitorë, pajisje për video-konferenca, etj.)
- Aplikacione kompjuterike, sisteme kompjuterike, programe kompjuterike, dhe mirëmbajtjen e tyre, qoftë brenda institucionit ose të blerë.
- Çfarëdo lloj kontrate që përfshin shërbimet e furnizimit, përkrahjes ose TI-së në lidhje me cilëndo njësi të listuar më sipër.

Ka disa gjëra që shpenzohen ose gjëra speciale që mund të kërkohen vetëm nga një agjenci e veçantë të cilat nuk duhet të prokurohen në mënyrë qendrore nga ZPSH-ja dhe agjencitë në fjalë mund t'i prokurojnë ato gjëra vetë.

KAPITULLI - II

10.0 Transparenca – rast studimi

Prokurimi publik në Sllovaki kundrejt atij në Kosovë, strukturat qeverisëse, qasshmëria dhe transparenca

10.1 Transparenca

Transparenca është një fjalë që përdoret sot gjerësisht në pothuajse çdo aspekt të qeverisjes. Ideja përreth fjalës ‘transparencë’ lidhur me qeverisjen është se ajo supozon se qytetarët janë të informuar për atë që po bëhet në emër të tyre. Ky përbën një supozim të ndershëm dhe të sinqertë lidhur me transparencën në qeverisje, pra ideja se nuk ka asgjë për të fshehur nga qytetarët. Pra, punët behën në dritën e diellit dhe në interesin më të mirë të qytetarëve.

Me disa dallime mes vendeve të zhvilluara dhe atyre më pak të zhvilluara, ne dimë se kjo nuk është kështu. Dihet se transparenca përbën një fjalë së cilës persona në pozita të larta nganjëherë i frikësohen më së shumti. Kjo është për shkak se jo çdo punë bëhet në dritën e diellit dhe me qëllimet më të mira.

Pazare të mëdha me shuma të mëdha parash bëhen prapa dyerve të mbyllura, diku në ndonjë dhomë të errët, ose natën vonë diku në ndonjë restorant a hotel të largët, ku interesat e qytetarëve përbëjnë brengën e fundit fare.

Në Kosovë kemi përjetuar zyrtarë të tillë nga niveli i lartë e i ulët, kemi parë se si e kanë shfrytëzuar tërë pushtetin e besuar nga qytetarët për të pasuruar veten dhe të afërmit e tyre.

Kjo duhet të marrë fund.

Në ditët e sotme, kur mbi 90% e qytetarëve të Kosovës kanë qasje në internet, është koha që të hidhet dritë mbi atë çfarë bën qeveria dhe që të bëhen në mënyrë të hapur.

E kuptojmë se nevoja për transparencë është në çdo sektor, jo vetëm në prokurimin publik, por prokurimi publik duhet të hapet urgjentisht.

Nga kontratat e vogla te ato të mëdha, çdo vit menaxhohen mbi 400 milionë euro përmes prokurimit publik, para këto që shpesh përfundojnë në xhepa të zyrtarëve dhe politikanëve të korruptuar që shfrytëzojnë ndikimin e tyre për të përfituar për vete dhe bizneset e të afërme të tyre në një zinxhir të stërzgjatur.

Pra, me transparencë nënkuptojmë aftësinë dhe mundësinë e qytetarëve për të pasur qasje dhe për të qenë në dijeni për pothuaj çdo gjë që bën qeveria në emër të tyre. Duke nisur nga njoftimet e thjeshta për ndryshimin e ngjyrave të mureve në një zyrë të vogël në një fshat të largët, e deri te kontratat e mëdha për ndërtimin e autostradave.

Të gjitha dokumentet e prokurimit publik – planet, njoftimet, kriteret, kontratat, pagesat dhe faturat – duhet të jenë të hapura për publikun që t'i shohim dhe të mund t'i mbikëqyrim. Nëse ka diku një drejtor shëndetësie që refuzon të furnizojë qendrën lokale shëndetësore me letër të pastër, por shpenzon mijëra euro në qira të makinave dhe larjen e tyre, atëherë qytetarët duhet të jenë në dijeni. Nëse ekziston një kryetar komune që shpenzon të gjitha paratë e taksave në asfalt vetëm e vetëm që një i afërm i tij/saj, që fshihet pas një biznesi, të përfitojë nga kontratat, përderisa shkollat nuk kanë ngrohje për dimër, atëherë prindërit duhet të jenë në dijeni të kësaj.

Nuk mund të humbasim asgjë nga të qenit transparentë dhe të hapur ndaj qytetarëve; të vetmit që humbasin janë ata që keqpërdorin paratë e tatimpaguesve.

10.2 Transparenca në prokurimin publik

Prokurimi publik është fusha që përballet më së shumti me rrezikun e korrupsionit. Kjo për shkakun se zyrtarët që punojnë në prokurim publik mund të ndikojnë në procesin përmes të cilit kompanive u jepen kontrata nga paratë e tatimpaguesve në shumë mënyra, disa nga to të diskutuara më sipër. Ndikimi i tillë mund të ushtrohet përmes manipulimit të kriterëve që favorizojnë një kompani në raport me të tjerat; ndarjes së informatave të brendshme me biznese të caktuara duke bërë që një kompani të ketë avantazh ndaj të tjerave; frikësimit të kompanive që nuk janë të gatshme t'u paguajnë ryshfet politikanëve dhe individëve me ndikim në poste të larta; kërkit të dokumenteve dhe përmbushjes së kriterëve jo-relevante dhe të panevojshme për të diskualifikuar kompani të caktuara që nuk paguajnë ryshfet.

Këto veprime korruptive dhe shumë të tjera, të cilat mund të rezultojnë në fitimin e kontratave nga ata që kanë korruptuar zyrtarët ose që kanë rënë dakord të ndajnë një pjesë të fitimit të tyre me zyrtarë të korruptuar.

Marrë parasysh potencialin për korrupsion, shumë vende kanë ndërmarrë përpjekje për të sjellë transparencë në prokurimin publik duke e hapur ndaj publikut procesin e dhënies së kontratave.

Transparenca në prokurimin publik dallon nga vendi në vend, varësisht nga niveli i korrupsionit dhe ai i besimit në institucione. Në vendet ku ka besim të ulët në institucionet publike ka nevojë për më shumë transparencë dhe mbikëqyrje, ndërsa në ato ku imazhi i institucioneve publike është pozitiv dhe që gëzojnë besim të fortë nga ana e qytetarëve, transparenca nuk përbën ndonjë brengë të madhe.

Sic tregojnë [raportet e Pulsit Publik të UNDP-së](#), Kosova bie në kategorinë e vendeve me besim të ulët në institucionet publike, veçanërisht ato në fushën e prokurimit publik, prandaj nevoja për transparencë është urgjente.

Sipas OECD-së, transparenca në prokurimin publik jo vetëm që promovon llogaridhënien dhe siguron qasje në informata, por gjithashtu luan një rol të rëndësishëm në **krijimin e një niveli më të barabartë për konkurrencë** për bizneset dhe në mundësimin ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme që të marrin pjesë në mënyrë të barabartë në këtë (OECD, 2015).

Në këtë raport analizojmë transparencën në Kosovë duke e krahasuar me Sllovakinë, vend ky i cili kohëve të fundit ka sjellë transparencë të plotë në prokurimin publik, për shkak të nivelit të lartë të korrupsionit dhe mosbesimit në institucione në këtë fushë.

11. Kosova

Në nenin 120 të Kushtetutës së Kosovës thuhet se: *“Shpenzimet publike dhe mbledhja e të hyrave publike duhet të bazohen në parimet e llogaridhënies, efektshmërisë, efikasitetit dhe **transparencës**.”*

Para Kushtetutës, Kosova kishte ligjin për qasje në dokumente zyrtare, që nga viti 2003. Ky ligj u shfuqizua dhe u zëvendësua, në vitin 2010, me ‘Ligjin nr. 03/L-215 për qasje në dokumente publike’.

Ky ligj ofron transparencë pasive, ose transparencë sipas kërkesës, që nënkupton se qeveria apo cilido autoritet publik nuk ofron qasje në dokumente nëse kjo gjë nuk kërkohet. Kjo qasje konsiderohet dekurajuese pasi që nuk mundëson ofrimin e informatave në kohë reale, kur nevojitet, por mund të vonojë informatat për një muaj, kohë kjo kur në disa raste informata e ofruar mund të humbasë rëndësinë e vet.

Në epokën digjitale, transparenca nënkupton qasjen në të gjitha informatat përmes internet, me një shtypje të mausit ose një prekje të ekranit. Nuk ka mundësi më që transparenca të nënkuptojë një proces ku një qytetar apo institucion dorëzon një kërkesë zyrtare dhe pret një muaj derisa të marrë informatat e kërkuara. Kjo lloj transparence është burokratike dhe e dizajnuar në atë mënyrë që të vonojë informatat dhe të bëjë më të vështirë qasjen në to.

Nga pikëpamja ligjore, asgjë nuk i ndalon institucionet që të ofrojnë transparencë aktive përmes ueb-faqeve të tyre të publikojnë të dhëna në formate të hapura dhe të lexueshme. Për më tepër, Ligji për Qasje në Dokumentet Publike kërkon që të gjitha institucionet **të publikojnë të gjitha të dhënat e publikueshme** në ueb-faqet e tyre. Kuptimi i frazës “*të gjitha të dhënave publikueshme*” duhet të ndryshohet sipas kuptimit të transparencës në shpenzimet publike, të dhënë në Kushtetutën e Kosovës. Shihni kreun “*Transparenca në prokurimin publik, analizë ligjore*”, faqe 93

Marrë parasysh se të gjitha institucionet kanë ueb-faqe ku mund të publikojnë informata të tilla, nuk është e qartë arsyeja përse nuk e bëjnë këtë.

11.1 Strukturat qeverisëse në prokurim publik në Kosovë

Duke qenë në hapat e parë të zbatimit, korniza ligjore që prek prokurimin publik në Kosovë ende ka nevojë të ndryshohet, në veçanti dispozitat në lidhje me transparencën.

Në Kosovë, organet e prokurimit publik funksionojnë ose nën autoritetin e Kuvendit të Kosovës ose atë të Ministrisë së Financave. Institucionet kryesore janë: Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP), Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) dhe Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP).

Agjencia Qendrore e Prokurimit, e cila funksionon në kuadër të Ministrisë së Financave, është autoriteti kontraktues qendror për blerjen dhe

prokurimin e mallrave dhe shërbimeve në nivelin qendror. Kompetenca kryesore e AQP-së është që të prokurojë aktivitete të centralizuar dhe të përbashkëta për institucionet publike në Kosovë²⁴.

Në Sllovaki, e cila është rast studimi i yni, këtë funksion e kryen Ministria e Brendshme, e cila vepron si organ qendror blerës. Kjo ministri menaxhon me platformën online *e-tregu*, e cila përbën një sistem dinamik të mallrave dhe të të dhënave, dhe qëllimi i saj kryesor është rritja e transparencës në prokurimin publik dhe promovimi i konkurrencës së drejtë dhe transparente.

Ngjashëm me [Organin Shqyrtues të Prokurimit](#), në Sllovaki funksionon [Zyra kundër Monopoleve](#), e cila ka fushëveprim më të gjerë të kompetencave lidhur me prokurimin publik. OshP-ja në Kosovë është entitet i pavarur përgjegjës për shqyrtimin e procesit të prokurimit. Kompetencat kryesore të OShP-së konsistojnë në veprimin e saj në çfarëdo shtate ku ka shkelje të Ligjit të Prokurimit Publik. Në raste të tilla, OshP-ja ka autoritet të kërkojë qasje në të dhëna, informata apo dokumente nga kompanitë apo autoritetet publike, me qëllimin për të hetuar ose bërë shqyrtimin e një aktiviteti të caktuar të prokurimit. OshP-ja ka autoritet që të nxjerrë një urdhër që e bën një kontratë të lidhur dhe nënshkruar të pavlefshme nëse është nënshkruar pa u publikuar paraprakisht sipas kërkesave të Ligjit të Prokurimit Publik, ose nëse kontrata është nënshkruar para kalimit të afatit të përmendur në këtë ligj²⁵.

11.2 E-prokurimi

Sipas Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik në Kosovë, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP) është përgjegjës për zhvillimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e sistemit të prokurimit publik në Kosovë. Një nga funksionet e tij është që zhvillojë dhe mirëmbajë një ueb-faqe informuese që ofron të **qasje** të pakufizuar të publikut në lidhje me të

²⁴ Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës. Agjencia Qendrore e Prokurimit.

²⁵ Ligji nr 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës. Organi Shqyrtues i Prokurimit.

gjitha informatat në lidhje me prokurimin publik në Kosovë. (Ligji nro. 04/L-042).

Në vitin 2014, me financim nga Banka Botërore përmes Ministrisë së Financave në Kosovë, kompania kroate “[INFODOM](#)”, në partneritet me kompaninë kosovare “[KOMTEL](#)”, ishte kontraktuar për të krijuar, për herë të parë në Kosovë, një platformë të prokurimit elektronik, të quajtur ‘[e-prokurimi](#)’. Deri në shtator 2016, e-prokurimi ishte në dispozicion për institucionet e mëdha buxhetore, ndërsa nga janari 2017 është hapur për të gjitha institucionet kontraktuese. Është raportuar se deri në prill 2017 në të ishin regjistruar 159 autoritete kontraktuese, me 4,200 përdorues, ndërsa që prej fillimit të përdorimit përmes saj janë përfunduar 1,700 procedura.²⁶

Prokurimi elektronik është një nga hapat më të mëdhenj përpara në drejtim të transparencës së shpenzimeve publike. Ueb-faqja ka potencial që të zhvillohet më tej dhe të ofrojë transparencë më të gjerë. Konsiderojmë se formati aktual i prokurimit elektronik mbetet prapa në lidhje me transparencën, në krahasim me vendet e tjera, veçanërisht me Sllovakinë, e cila është rast studimi yni në këtë raport.

Kjo platformë mirëmbahet dhe menaxhohet nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP), dhe ofron si në vijim:

- a) Njoftime për kontrata;
- b) Njoftime për nënshkrimin e kontratave;
- c) Njoftime për dhënien e kontratave;
- d) Njoftime për anulimin e aktiviteteve të prokurimit.²⁷

Kjo platformë u ofron përdoruesve të paregjistruar informata të kufizuara për çdo kontratë, të tilla si lloji i kontratës, blerësi, shuma e përafërt, datat dhe numrin, ndërsa nëse shkarkohet në format PDF-je, përmban shpalljen e plotë, së bashku me kriteret e përzgjedhjes. Megjithatë, mund të kesh qasje të plotë në dosjen e tenderit vetëm nëse je përdorues i regjistruar, konkretisht vetëm nëse jeni i regjistruar si operator ekonomik.

²⁶ Safet Hoxha, Kryetar i KRPP-së, pjesëmarrës në tryezën e rrumbullakët “Prokurimi elektronik në Kosovë – sfidat dhe mundësitë”. 25 prill 2017, Villa Gërmia, Prishtinë.

²⁷ <https://e-prokurimi.rks-gov.net/Home/default.aspx>

Përdoruesit përballen me një numër vështirësish në përdorimin e kësaj platforme. Përveç faktit se ajo nuk përditësohet shpesh, disa kontrata nuk janë paraqitur në mënyrë të saktë në aspektin e shumave tyre.

Ballina e ueb-faqes u mundëson përdoruesve të zgjedhin kategoritë e informatave, përfshirë e-njoftimet për prokurim dhe shitjet, si dhe kontratat e dhëna. Njoftimet për kontrata që janë të qasshme për publikun përmbajnë numrin e prokurimit, autoritetin kontraktues, llojin dhe shumën e kontratës. Megjithatë, nëse zgjedh një kontratë për ta parë si përdorues i paregjistruar, e tërë dosja e tenderit nuk është në dispozicion.




Foto 1: Ballina e e-prokurimit në Kosovë

Njoftim - B05 Njoftim per Kontrat

Hape:

Bleresi	MINISTRIA E INFRASTRUKTURES
Kodi/Numri	2017/205-17-2671-2-2-1/B05-0006071
Emertimi	Ndërtimi i mbajimit në rrugën Nacionale N25 – segmenti: Besi – Podujevë, Lot 5 – Km 18+770 (te "Qershat")
Lloji i dokumentit	B05 Njoftim per Kontrat
Lloji i kontratës	5 Pune
PPP	45000000-7 Pune ndërtimi
Lloji i procedurës	1 Procedurë e hapur
Vlera e parashkuar	341.000,00
Afati për dorëzimin e ofertave/krkesës për pjesëmarrje	04.07.2017 14:00
Data e njoftimit	19.06.2017
Data e dërgimit	14.06.2017
Ligji	LIGJI Nr. 04/L-042 PER PROKURIMIN PUBLIK NE REPUBLIKEN E KOSOVES
Dorëzimi elektronik i ofertave	Po

Njoftimet të tjera në procedurën e njëjtën të prokurimit :

Lloji i dokumentit	Data e publikuar	Data paraqitur
B05 Njoftim per Kontrat	19.06.2017 00:00:00	14.06.2017 00:00:00

Dosja e Tenderit

21. qershor 2017.

KARTELA E KONTRATËS ZK104-17-982-2-2-1/C2

PER PROKURIM

Reference: ZK104-17-982-2-2-1

Titulli: Shërbime të dizajnit - ritender

TE DENAT E KONTRATËS

Reference: ZK104-17-982-2-2-1/C2

Ane kontratës: EUROPRINTY SH.P.K.

Tipi kontratës: Kontratë me urdhërat

Vlera e kontratës (pa TVSh): 8.954,40

Status: Në përgatitje

Data e miratimit: 07.06.2017

Data e miratimit:

Data e mbarimit:

Foto 2: Njoftimet janë të shkurtëra në formatin e lexueshëm nga kompjuterët, pjesa tjetër duhet të shkarkohet. Mungojnë legjendat që klasifikojnë dokumentet

Fotot e ueb-faqes në vijim tregojnë se çfarë ofron kjo platformë, kur nevojitet një llogari dhe çfarë informata i ofrohen publikut. Këto skica përfshijnë edhe një shembull se si duket një kontratë për përdoruesin.

Gjithashtu mungojnë informata të hollësishme rreth kontratave të dhëna. Me përjashtim të listës së institucioneve (autoriteteve kontraktuese) dhe informatave të zakonshme, si emri i furnizuesit dhe informata të tjera bazë, platforma nuk ofron informata të tjera të brendshme. Kjo është ndryshe nga rasti në Sllovaki, ku përdoruesit, edhe si i paregjistruar, ka qasje në historinë e furnizuesit dhe hollësi të tjera që e lidhin furnizuesin me punën e kontraktuar.

11.3 Agjencia për Regjistrim të Bizneseve

Një tjetër institucion i rëndësishëm në lidhje me transparencën në prokurimin publik është Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve (ARBK). Sipas ligjit Nr. 04/L-006, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë administron sistemin e regjistrimit të bizneseve që nga 13 shtatori 2001. Regjistri i Shoqërive Tregtare dhe Markave Tregtare është themeluar në bazë të Rregullores 2001/6 dhe Urdhëresës Administrative 2002/22.

Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve kryen regjistrimin e të gjitha organizatave afariste, përfshirë bizneset e huaja, sipas Ligjit nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare dhe Ligjit nr. 04/L-006 për plotësim-ndryshimin e Ligjit në fuqi për Shoqëritë Tregtare. Ajo ofron informata dhe bashkëpunon me Zyrën e Statistikave, Administratën Tatimore, Doganat, Shërbimin Policor dhe agjenci të tjera.

Kjo është agjenci kyçe kur bëhet fjalë për transparencë në prokurimin publik. Ndonëse askush nuk e ndërlidh ARBK-në me prokurimin publik, FOL-i beson se KRPP-ja, duhet të bashkëpunojë me ARBK-në për t'u sjellë transparencë të plotë bizneseve që marrin pjesë në prokurimin publik. Kur vjen puna tek të bërit biznes me shtetin, informatat që janë në dispozicion në këtë agjenci janë vendimtare për të identifikuar adresat e kompanive, personat e autorizuar, dhe pronarët.

Sipas hulumtimeve tona, ARBK-ja është larg nga ofrimi i transparencës minimale lidhur me kompanitë që bëjnë biznes me shtetin. Në fakt, për shkak se nuk ekziston një regjistër i partnerëve të sektorit publik, ARBK-ja nuk bën dallim mes bizneseve që marrin pjesë në prokurimin publik dhe atyre që nuk marrin. Siç do të tregojmë më poshtë, krahasuar me Sllovakinë në këtë pikë, ARBK-ja ka nevojë për reforma të mëdha për të arritur transparencë.

Në ilustrimin më sipër kemi dhënë një pamje të asaj çfarë ofron ARBK. Kompania e marrë si shembull për ilustrim, e regjistruar në ARBK, është [REDACTED]. Siç shihet në figurën 3, ARBK-ja ofron qasje të kufizuar në informata mbi pronarët e kompanisë. Te rubrika rreth pronësisë vihet re se është shënuar vetëm emri.

Marrë parasysh faktin se kompanitë bëjnë biznes me shtetin, pra me paratë e taksapaguesve, është asgjë më tepër se e drejtë që qytetarët të dinë se kush janë pronarët, pra kush janë ata që përfitojnë nga paratë e taksapaguesve.

Përveç që nuk tregon përfituesit, ARBK-ja nuk ofron ndonjë histori rreth ndryshimeve në përbërjen e menaxhmentit, pronësinë dhe përfituesit, gjë që do t'u mundësonte qytetarëve të kontrollojnë ligjshmërinë e afarizmit dhe të shohin nëse dikush në të kaluarën në këtë kompani ka qenë zyrtar publik. Siç do të shohim më poshtë në rastin e Sllovakisë, për të gjitha këto pyetje ka përgjigje në sistemin e tyre online.

11.4 Administrata Tatimore e Kosovës

Agjencia tatimore është e një rëndësie të jashtëzakonshme në çdo vend. Politikat tatimore si dhe zbatimi i tyre e mbledhja e tatimeve përbëjnë themelet e çdo vendi të shëndetshëm. Besimi se secili paguan pjesën që i takon është ajo që krijon një ndjenjë të drejtësisë dhe solidaritetit në vend dhe shoqëri. Prandaj, të kesh një sistem transparent të taksave është çelës për të krijuar atë ndjenjë e siguri se nuk po të plaçkitin, por se ke të drejtën dhe mundësinë të shohësh kah po shkojnë paratë tua, ku investohen ato, dhe se si po kthehen për të mirën e shoqërisë.

Kosova ka mbetur mbrapa kur është fjala për transparencë në tatime. Titulli i këtij raporti është i qëllimshëm. Nëse qytetarët e kanë për detyrë të paguajnë taksa, atëherë institucionet e kanë për detyrë që të japin informata se si këto taksa po shpenzohen dhe kush po përfiton nga to. Deri

²⁸ Name and other information regarding the company have been blacked to avoid any judgment on certain company.

tani, qytetarët nuk kanë mundësi të kontrollojnë kompanitë që bëjnë biznes me shtetin, të shohin nëse po paguajnë pjesën e tyre të taksave; të kenë mundësi të kontrollojnë kush janë përfituesit, të kontrollojnë dhe të jenë të sigurohen se askush në poste të larta nuk po përfiton paligjshëm nga taksat e tyre.

Administrata Tatimore e Kosovës nuk ofron mundësi për qasje në informata të rëndësishme financiare lidhur me kompanitë, siç janë: pasqyrat vjetore financiare të kompanive, veçanërisht të atyre që bëjnë biznes me shtetin, dhe informata të tjera të rëndësishme. Drejtoria për Planifikim dhe Analiza në kuadër të Administratës Tatimore mbledh pasqyra financiare vjetore nga bizneset e regjistruara në Kosovë. Ndonëse kjo drejtori i posedon këto informata, ato nuk janë në dispozicion në internet për publikun në ueb-faqen e Administratës Tatimore, në ndërkohë që kjo drejtori nuk ka asnjë ueb-faqe të sajën zyrtare. Siç do të shohim më poshtë, në Sllovakia ofrohet një mundësi e tillë online, në kohë reale dhe me informata të përditësuara.

12.0 Sllovakia

Në vitin 2000, Sllovakia e ka miratuar Ligjin për Lirinë e Informacionit.²⁹ Supozimi prapa tij bazohet në hapje bazuar në kërkesë (*sikurse rasti i Kosovës tani*), që nënkuptonte se qytetarët mund të kërkonin dhe të merrnin çfarëdo informate mbi punën e qeverisë, me përjashtim të atyre informatave që do të dëmtonin privatësinë apo interesin kombëtar. (TI Sllovakia, 2015).

Në vitin 2010, Sllovakia amendamentoi Ligjin për Lirinë e Informacionit, duke kaluar kështu nga transparenca pasive (*transparenca e bazuar në kërkesa*) në transparençë aktive (*transparençë automatike*). Sipas ligjit të ri, Qeveria automatikisht publikon online kontratat, faturat dhe urdhër pagesat automatikisht, pa kërkesën e ndokujt. Për më tepër, asnjë kontratë qeveritare nuk hyn në fuqi **pa u publikuar online**³⁰. Ky ndryshim vlen për të gjitha institucionet që marrin vendime për kontratat

²⁹ Është i krahasueshëm me Ligjin e Kosovës për Qasje në Dokumentet Publike.

³⁰ <http://www.transparency.sk/wp-content/uploads/2015/05/Open-Contracts.pdf>

që kanë të bëjnë me paratë publike, nga organet e qeverisjes qendrore dhe ato lokale, e deri te institucionet apo kompanitë e ngritura nga ana e tyre. (TI Sllovakia, 2015).

Në Sllovaki, beteja për transparencë ka nisur nga niveli komunal. Në vitin 2007, **Sala**, një qytet me 25 mijë banorë në jugperëndim të Sllovakisë, i pari ka filluar publikimin e kontratave dhe faturave në internet. Pas tre vjetësh, një qytet verior në qendër të vendit, **Martin**, me një popullsi prej 60 mijë banorë, e ka aplikuar të njëjtën qasje të transparencës aktive. Në vitin 2009, dy vjet pasi komuna Sala ka filluar ta zbatoj qasjen aktive të transparencës së kontratave, dy grupe të deputetëve të opozitës propozuan që kjo politikë të aplikohet në nivelin kombëtar.

Ka pasur debate midis partive politike, ku disa prej tyre kanë kundërshtuar transparencën me argumentin se njerëzit do të keqpërdorin informatat, por përkundër kundërshtimeve, beteja është fituar.

Me përjashtim të disa shqetësimeve lidhur me sekrete tregtare (*know-how*), shoqatat e bizneseve në Sllovaki kryesisht kanë mbështetur legjislacionin e ri, edhe pse, si palë në raport me shtetin, duhet të lejonin qasje në kontrata. Ato e kanë parë transparencën si mjet efektiv kundër korrupsionit, pasi që kjo e fundit ka qenë shqetësim i madh për ndërmarrësit.

Çështja e sekreteve tregtare ishte e rëndësishme në fillim, por nuk është më. Vet kompanitë deklarojnë se çfarë është sekret tregtar në bazë të ligjit, dhe autoritetet duhet të shqyrtojnë dhe miratojnë, nëse kërkesat e tilla janë të vërteta, dhe të vendosin se çfarë është sekret tregtar sipas ligjit. Përfundimisht, çështja e sekreteve tregtare është venitur, pasi që kompanitë nuk kanë pasur sekrete tregtare aq të mëdha për t'i fshehur nga publiku.³¹

Shembulli i Sllovakisë me hapjen e detyrueshme të kontratave është marrë si model edhe nga Republika Çeke dhe Sllovenia. (TI Sllovakia, 2015)

³¹ Intervistë me Gabriel Sipos, Drejtor Ekzekutiv i *Transparency International Slovakia*.

12.1 Strukturat qeverisëse për prokurim publik në Sllovaki

Sllovakia konsiderohet ndër vendet e para të Evropës Qendrore që kanë rregulluar kornizën ligjore për prokurimin publik në përputhje me direktivat e Bashkimit Evropian. Niveli i lartë i korrupsionit që e karakterizon këtë sektor ka bërë që transparenca në prokurim publik të jetë prioritet për Sllovakinë.³²

Sistemi i prokurimit në këtë vend është relativisht i centralizuar, pasi që autoritetet kontraktuese (në nivelin qendror, rajonal ose lokal) merren me kontrata, ndërsa autoritetet e tjera kontraktuese blejnë mallra ose shërbime nga Ministria e Brendshme, e cila vepron si organi qendror blerës³³. Ministria e Drejtësisë ka një rol në sistemin e prokurimit publik, nëpërmjet Departamentit të Strategjive Sektoriale, Buxhetit dhe Administratës. Prokurimi publik organizohet përmes këtij departamenti dhe ai gjithashtu harton udhëzues metodologjikë për prokurim publik³⁴.

Zyra e Prokurimit Publik (PPO), e Sllovakisë është organ i pavarur dhe në të njëjtën kohë, ajo përfaqëson institucionin qendror të administratës shtetërore për prokurim publik në këtë vend. Ngjashëm me Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP), në Kosovë, detyra kryesore e këtij institucioni është të kontrollojë respektimin e pajtueshmërinë e procedurave të prokurimit publik me ligjet në fuqi. Për më tepër, kjo zyrë

³² http://ec.europa.eu/regional_policy/sources/policy/how/improving-investment/public-procurement/study/country_profile/sk.pdf

³³ http://ec.europa.eu/regional_policy/sources/policy/hoë/improving-investment/public-procurement/study/country_profile/sk.pdf

³⁴ <http://wwwold.justice.sk/a/ëfn.aspx?pg=ho52&htm=ho/h05/sdeaa.htm>

merret me mbikëqyrjen e prokurimit publik, **gjobat ndaj shkeljeve nga ana e administratës**, dhe publikon dokumente në sistemin elektronik, për të mundësuar komunikimin elektronik ndërmjet furnizuesve dhe autoriteteve kontraktuese.

Ndryshe nga Auditori i Përgjithshëm në Kosovë, i cili nuk ka ndonjë bashkëpunim të veçantë me KRPP-në, në Sllovaki Zyra Supreme e Auditimit shërben si organ kryesor i kontrollit të jashtëm që shqyrton procedurat e prokurimit dhe përputhshmërinë e tyre me ligjet, dhe nxjerr rekomandime për Zyrën e Prokurimit Publik.



Rubrikë me Fakte II

Organet qeverisëse Sllovakia vs Kosova

Prokurimi elektronik	
Po, nga viti 2011	Po, nga viti 2017
Organet qendrore për blerje:	
Ministria e Punëve të Brendshme	Agjencia Qendrore e Prokurimit (Ministria Financave)
Organet rregullatore	
Zyra e Prokurimit Publik Funksioni shtese: gjobat	Komisioni Rregullativ Prokurimit Publik (KRI)
Organet ndihmëse	
Zyra Supreme e Auditimit Funksioni shtesë: organi kryesor për monitorim të jashtëm	Departamenti i Rregullave

Krahasuar me Organin Shqyrtues të Prokurimit, në Sllovaki funksionin Zyra kundër Monopoleve e cila ka fushëveprim më të gjerë të punës në lidhje me prokurimin publik. Në Kosovë Organi Shqyrtues i Prokurimit është organ i pavarur shqyrtues përgjegjës për zbatimin e procedurave për shqyrtimin e procesit të prokurimit. Kompetencat kryesore të OShP-së kanë të bëjnë me marrjen e masave në rast të shkeljeve të mundshme të Ligjit për Prokurim Publik. Në raste të tilla, OshP-ja e ka autoritetin për të kërkuar qasje në të dhëna, informata apo dokumente nga kompanitë apo autoritetet publike për të hetuar ose inicuar shqyrtimin e aktiviteteve të caktuara të prokurimit. OshP-ja ka autoritet që të nxjerrë urdhra që e bëjnë një kontratë të lidhur dhe nënshkruar të pavlefshme nëse është

nënshkruar pa publikim paraprak, sipas kërkesave të Ligjit të Prokurimit Publik, ose nëse është nënshkruar para skadimit të afatit të specifikuar në këtë ligj .

Zyra Kundër Monopoleve në Sllovaki funksionon si organ i pavarur qendror në kuadër të administratës shtetërore. Detyra kryesore e këtij organi është mbrojtja dhe promovimi i konkurrencës. Në të njëjtën kohë, kjo zyrë

ndërhyn kundër praktikave të ndaluara, me fokus kryesor në shpërdorimin e pozitës nga ana e operatorëve ekonomikë dhe kontrollin e transaksioneve në sasi të mëdha. Kjo zyrë gjithashtu ka autoritetin që të sanksionojë organet e administratës shtetërore ose lokale në rastet kur një operatori ekonomik i është dhënë ndonjë avantazh, ose nëse është kufizuar konkurrenca e ndershme në çfarëdo forme.

Organet mbrojtëse/shqyrtuese	
Zyra kundër Monopoleve Funksioni shtesë: mbrojtja dhe promovimi i konkurrencës	Organi Shqyrtues i Prokurimit
Organi organizativ	
Ministria e Drejtësisë: Funksioni shtesë: organizon prokurimin publik dhe harton udhëzues metodologjikë për prokurim publik	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik

12.2 Prokurimi elektronik

E themeluar me Ligjin nr. 63/1999 Coll. për Prokurim Publik, Zyra e Prokurimit Publik në Sllovaki (UVO), ka kompetenca për të menaxhuar dhe vënë në dispozicion shembuj të dokumenteve elektronike, software të veçantë që plotësojnë kushtet për komunikim elektronik dhe elemente të tjera të nevojshme për të siguruar komunikimin elektronik, në ueb-faqen e vet, ndërmjet autoriteteve kontraktuese dhe subjekteve kontraktuese në prokurimin e furnizimeve³⁵.

Në platformën e saj UVO-ja, publikon kontrata të hapura dhe ofron mundësinë për të shkarkuar dokumente që lidhen me secilën kontratë. Në

³⁵ http://www.kozbeszerzes.hu/data/filer_public/ed/bo/edb03598-371a-4122-b4ba-37c3fdfe105/emilia_gregorova_angol1.pdf

rubrikën e quajtur Buletini i Prokurimit Publik, platforma ofron publikime dhe profile të shkurtra për blerësit.

Kontratat paraqiten në format të hapur dhe të lexueshëm me makinë, edhe me dokumente të bashkëngjitur, në format PDF, duke u mundësuar kështu përdoruesve shfrytëzimin apo shkarkimin etyre.

[EVO-ja](#) është platformë elektronike që përdoret në Sllovaki për tenderët e prokurimit publik, e cila është ekuivalente me platformën [e-prokurimi](#) në Kosovë. Ajo mirëmbahet në nivel qendror nga Zyra e Prokurimit Publik. Qasja jepet nga secili autoritet kontraktues ose entitete që ofrojnë shërbime publike, sipas kërkesës. Secila organizatë së cilës i krijohet qasje në EVO ka hapësirën dhe rolin e vet (administratorët lokalë, konsulentët, këshillin dhe auditorin). Brenda një sistemi ka disa organizata me hapësirat e tyre (*sistem në sistem*). Organizatat nuk mund të shohin ose të kenë qasje në dosjet e njëra-tjetrës³⁶.

Platforma EVO, tregon listën e kontratave, ndërsa gjithashtu përmban kategori si *Pasqyra e ankandëve* dhe *Pasqyra e tenderëve*. Përdoruesit janë pjesëmarrës të mundshëm të cilët, nëse janë të regjistruar, mund të lexojnë informata më të hollësishme mbi kontratat e përzgjedhura.

³⁶ http://www.kozbeszerzes.hu/data/filer_public/ed/bo/edb03598-371a-4122-b4ba-37c3fdfef105/emilia_gregorova_angol1.pdf



Corrigendums

corrigenda2 7.1 IDES test by VS 01

INTERNAL EVO

TENDER OVERVIEW

AUCTION OVERVIEW

NEWS

HOW TO REGISTER

GUIDES FOR CONTROL
AUTHORITIES

GUIDES FOR CANDIDATES

FAQ

ERROR REPORT

NOTICE OF CONTRACT AWARD

Form: Annex. 7 Pursuant to Decree No. 530/2009 Coll.

SECTION I: CONTRACTING

I.1. Name and address of contact point (s)
SECOND TEST
ID: 00000002
The unrealistic X, 850 00 Bratislava - city district Petržalka
Slovakia
Contact point (s): Test IDES
Contact: test IDES
Phone: +421 287 654 321
Fax: +421 287 654 321
Email: evo1@uvo.gov.sk
I.2. Type of contracting authority and main activity or activities
I.2.1. Type of contracting authority
Ministry or any other national authority, including their regional or local sub-divisions
Classification procuring entity under the Act:
§ 6 par. 1 point. a)
I.2.2. Main activity or activities
General public services
I.2.3. The contracting authority is purchasing on behalf of other contracting authorities
Not

SECTION II. OBJECT OF THE CONTRACT

II.1. description
II.1.1. Title attributed to the contract
IDES test by VS 01
II.1.2. Type of contract and location of works, place of delivery or of performance
goods
purchase
Main place of delivery: test IDES
NUTS code (for the selected category)
SK01
II.1.4. Short description of the contract or purchase (s)
IDES test
II.1.5. Common (CPV)
Main object
Main vocabulary: 03111100-3
II.2. Total final value of contract (s)
II.2.1. Total final value of contract (s)
Value 1 000,0000 EUR
including VAT
VAT rate (%): 23

SECTION IV. APPROACH

IV.1. Type of procedure
IV.1.1. Type of procedure
public tender
IV.2. Award criteria
IV.2.1. Award criteria
Lowest price
IV.2.2. Use the electronic auction
Yes
IV.3. administrative information
IV.3.2. Previous publication (s) concerning the same contract
Yes
If yes (please fill in the appropriate box) notice of the contracting authority
Notice number in the VVO: 12611-MST, no VVO 203/2012 of 19/10/2012

SECTION V: AWARD OF CONTRACT

Title: test IDES
V.1. Date of contract
21/10/2012
V.2. The number of submitted bids
10
V.3. Name and address of the supplier, with whom contracted
IDES Test
ID: Test IDES
test IDES test test IDES IDES
Slovakia
Phone: +421 123456789
V.4. Information on value of contract
Initial estimated total value of the contract
Value: 1 000,0000 EUR
Without VAT
Total final value of contract
Value 1 000,0000 EUR
including VAT
VAT rate (%): 23
V.5. It is likely to be subcontracted
Not

SECTION VI. ADDITIONAL INFORMATION

VI.1. The contract relates to a project and / or program financed by EU funds
Not
VI.2. More details
IDES test
VI.3. Date of dispatch of this notice
22/10/2012

Foto 5: Të dhënat e hollësishme të një njoftimi për dhënie të kontratës, në format të lexueshëm me makinë


**ÚRAD PRE VEREJNÉ
OBSTARÁVANIE**

Private zone | Contacts SK EN

Vyhľadať SEARCH

About office | The contracting authority / entity | The candidate / tenderer | Legislation / methodology / Supervision | information service

Introduction > Journal

Communication 1200 - in US

[← BACK](#)

Contents

1200 - In US
Bulletin no. 14/2014 - 01/22/2014

NOTICE OF CONTRACT AWARD
Form: Annex. 3 in accordance with Implementing Regulation (EU) No. 842/2011

Type of procedure: Restricted
Type of contract: Services

SECTION I: CONTRACTING

I.1) NAME, ADDRESSES AND CONTACT POINT
The Ministry of Interior of the Slovak Republic
National ID: 00151866
Pribinova 2, 81272 Bratislava - Nové Mesto
Slovakia
Contact point (s): Ministry of Interior of the Slovak Republic Pribinova 2, 812 72 Bratislava
Contact person: Ing. Alena Polakovičová
Phone: +421 250944841
Fax: +421 250944008
E-mail: alena.polakovicova@minv.sk

I.2) TYPE OF AUTHORITY
Type of the contracting authority Ministry or any other national authority, including their regional or local sub-divisions

I.3) Main activity
General public services
Public order and safety

I.4) Contract award on behalf of other contracting authorities
Yes
Annex AI) address of another contracting authority on behalf of which contracting authority is purchasing
Enter as many times as is used in Annex A: 1
Official name: The in point VI.2) of this notice
, national ID number: 00000000
Mailing address: Listed in point VI.2) of this notice
City / Town: As referred to in paragraph VI.2) of this notice
ZIP: 00000
Country: Slovakia

Foto 6: Kontratat e Hapura në Sllovaki. Të ofruara nga Zyra për Prokurim Publik, ekuivalentja e KRPP-së në Kosovë.

SECTION II: OBJECT OF THE CONTRACT

II.1) DESCRIPTION

II.1.1) Title attributed to the contract

Professional consulting services

II.1.2) Type of contract and location of works, place of delivery or of performance service

Categories of services listed in Annex C1 11

Main site or location of works, place of delivery or of performance: Slovak Republic

NUTS code

SK0

II.1.3) Information on framework agreement or dynamic purchasing system (DPS)

The notice involves framework agreement

II.1.4) Short description of the contract or purchase (s)

Consulting services in the areas of:

- financial audit and performance
- audit, human resources,
- audit systems
- Audit processes
- audit management and financial management system of the operational program,
- legal services,
- legal advice
- legal representation.

II.1.5) Common (CPV)

Main object

Main vocabulary: 79410000-1

II.1.6) Information about Government Procurement Agreement (GPA)

The contract is covered by the Government Procurement Agreement (GPA) Yes

II.2) Total final value of contract (s)

II.2.1) Total final value of contract (s)

one value

Value 100,000 000,0000 EUR

Without VAT

IV.1) TYPE OF PROCEDURE

IV.1.1) Type of procedure

restricted

IV.2) AWARD CRITERIA

IV.2.1) Award criteria

The most economically advantageous tender in terms of

1. Price - 80
2. Functional Features - 20

IV.2.2) Information about electronic auction

An electronic auction was used No

IV.3) ADMINISTRATIVE INFORMATION

IV.3.1) File reference number attributed by the contracting authority

OVO2-2013 / 000501

IV.3.2) Previous publication concerning the same contract

Yes

Fill Prior Information Notice

Notice number in OJ. in. EU: 2013 / S 130-224557

from: 06.07.2013

Fill notice Contract

Notice number in OJ. in. EU: 2013 / S 140-244025

from: 20.07.2013

Other previous publications (if applicable) Yes

Notice number in OJ. in. EU: 2013 / S 160-279417

from: 20.08.2013

The buyer profile

Order: [Professional consulting services](#)

authority: [The Ministry of Interior of the Slovak Republic](#)

Foto 7: Brendesia e nje kontrate te hapur ne Sllovaki. Vini re detajet e kontrates.



Rubrikë me Fakte III

E- PROKURIMI

Slovakia VS. Kosova

Qasja online	
Po, nga viti 2011	Po, nga viti 2017
Platformat	
UVO, e themeluar nga Këshilli Kombëtar i Republikës Sllovake EVO, mirëmbahet nga UVO	KRPP-ja, e themeluar nga Kuvendi i Kosovës e-prokurimi, mirëmbahet nga KRPP-ja
Lista e njoftimeve	
a) Informatë për njoftim paraprake/njoftim indikativ periodik b) Njoftim për kontratë/Shpallje për tender (parakualifikim) c) Sistemi i kualifikimit d) Sistemi Dinamik për Blerje e) Shpallje indikative periodike/Shpallje për konkurrim f) Njoftim për kontratë/Shpallje për tender (me procedurë të hapur) g) Njoftim për kontratë/Shpallje për tender (me procedurë të kufizuar) h) Njoftimi për kontratë/Procedurë e negociuar i) Njoftim për kontratë/me procedurë të kufizuar (QS) j) Njoftim për kontratë/me procedurë të negociuar (QS) k) Njoftim për kontratë/me procedurë të kufizuar (QS) l) Njoftim për dhënie të kontratës m) Njoftim për anulim të tenderit	a) Njoftim për kontratë b) Njoftim për nënshkrim të kontratës c) Njoftim për dhënie të kontratës d) Njoftim për anulim të aktivitetit të prokurimit e) Shabllon standard për korrigjimin e gabimeve në Njoftimet e publikuara
Kontratat e dhëna	
PO. Të hapura, pa regjistrim Në format të lexueshëm më makinë Informatat rreth kontratës: emri, lloji dhe adresa e autoritetit kontraktues, prokurimi, komunikimi, fushëveprimi i kontratës (përfshirë titullin), kodi FPP, përshkrimi shkurtër, vlera e përafërt, vendi dhe datat e ekzekutimit	PO. Në formë të shkurtër, në format PDF ose tabelë Excel, me informata të shkurtra, si numri i referencës, emri dhe lloji i kontratës, shuma e përafërt, statusi i kontratës dhe datat.

Kontratat Aktive	
Po. Të hapura për publikun: Platformë e ndarë për tenderë aktivë, të pajisur me legjendë që tregon fazën e kontratës. Kontratat e hapura përmbajnë informata të tilla të hollësishme si autoritet kontraktues dhe detaje rreth tyre, lloji i kontratës, vendi i kryerjes së punimeve, vendi i ekzekutimit, përshkrimi i blerjes së kontratës, qëllimi i kontratës, kohëzgjatja e kontratës, shuma e përafërt, emri i furnizuesit dhe informatat kontaktuese, kriteret për vlerësimin e ofertave, kushtet për dokumentet e kërkuara. Sa i përket furnizuesit, ka kushte dhe kriterë lidhur me kapacitetet e tyre financiare dhe teknike. Njoftimi mund të përfshijë informata shtesë, varësisht nga lloji i kontratës/projektit. Të kufizuara, që kërkojnë regjistrim: Dosjet e njoftimit për kontratë (parakualifikimi), Shpallje për tender	Po. Të përfshira në platformën e KRPP-së Të hapura për publikun: Titulli i kontratës, lloji i kontratës, blerësi, numri i kontratës, vlera e përafërt dhe datat. Të kufizuara, që kërkojnë regjistrim: Dosja e plotë e tenderit
Informata rreth menaxherëve të kompanisë	
PO Informata lidhur me menaxherët e kaluar dhe ata aktualë, përfshirë aksionet e tyre, vendet e mëparshme të punës dhe/ose përfshirjen e tyre në institucionet publike	JO
Informata rreth kapitalit të kompanisë	
PO Informata rreth kapitalit të kaluar dhe atij aktual, përfshirë kapitalin e secilit pronar ose aksionar	PO Nuk ka histori (të dhëna nga vitet paraprake)
Informata rreth akteve juridike të kompanisë (*)	
PO Këto informata konsistojnë në pasqyrat financiare, dokumentet dhe memorandumet themeluese, apo dokumente të tjera të ngjashme	JO
Perditesimi i databazës	
O. Të përditësuara	Në disa kontrata ka shuma të ndryshme në listën e kontratave dhe të ndryshme në dokumentet në format PDF

13.0 Përmbledhje e dallimeve ndërmjet Sllovakisë dhe Kosovës në prokurimin elektronik

Nga fotot më sipër mund të krijohet një pasqyrë e qartë se ku qëndron Kosova në raport me Sllovakinë sa i përket transparencës së prokurimit elektronik. Për të lehtësuar procesin e kërkimit për një kontratë të caktuar të prokurimit publik, Sllovakia ka dy platforma të ndara. Të dy këto platforma mundësojnë qasjen e publikut. Megjithatë, për të pasur qasje në dosjen e plotë të një kontrate aktive EVO-ja, kërkon një llogari elektronike.³⁷ Por, platforma UVO, ngjashëm me ueb-faqen e KRPP-së në Kosovë, i ofron publikut kontratat e hapura pa pasur nevojë për regjistrim.

Nëpërmjet UVO-së në Sllovaki ofrohet mundësia për të parë kontrata në portal pa pasur nevojë për t'i shkarkuar ato. Kontratat e tilla janë të lexueshme me makinë, të qasshme pa u regjistruar dhe pa pagesë. KRPP-ja, në Kosovë nuk ofron fare mundësinë për t'i parë kontratat. UVO-ja, përmes EVO-së, dallon lidhur me kontratat aktive dhe pasive. Me 'aktive' nënkuptohen kontratat që nuk janë dhënë akoma, ndërsa me 'pasive' ato që janë dhënë, ndërsa gjithashtu ka edhe shënime që tregojnë statusin e secilit dokument.

KRPP-ja, në Kosovë nuk e bën një dallim të tillë, gjë që e bën të vështirë të kuptosh dallimin ndërmjet dokumenteve.

Foto 2 “Njoftim për kontratë” nga KRPP-ja në Kosovë tregon të dhënat për kontratat e dhëna. Kur e krahasojmë me foton 5 “Njoftimi mbi kontratën e dhënë”, nga UVO-ja, në Sllovaki, mund të shohim çfarë informatash mungojnë. Në rastin e Sllovakisë, njoftimi është i ndarë në pjesë: **I:**

³⁷ Megjithatë, kriteret e përzgjedhjes dhe kriteret e tjera janë në dispozicion pa u regjistruar, ashtu si në platformën e-prokurimi në Kosovë, por në një nivel më të avancuar dhe format të lexueshëm me makinë.

Kontraktimi – ku jepen informata mbi autoritetin kontraktues, **II: Lënda e kontratës** – që përmban informata mbi llojin dhe vlerën e kontratës. Në Kosovë KRPP-ja, nuk ofron informata të tilla. Ajo ofron informata mbi vlerën dhe llojin e kontratës në një format që nuk mund të ripërdoret, përkatësisht në format PDF, gjë që do të thotë se informatat nuk janë të lexueshme me makinë.

KRPP-ja për momentin dërgon raporte tek Auditori Gjeneral kur ka shkelje të procedurave por nuk ka bashkëpunim konkret në mes këtyre dy institucioneve. Me një bashkëpunim më të mirë, auditori gjeneral mund të identifikojë mangësitë në prokurim publik dhe KRPP-ja mund t'i adresoj ato tek autoritetet kontraktuese. Që të dy autoritetet duhet të bashkëpunojnë me prokurorinë kur ka shkelje të rënda.

14.0 Regjistri i bizneseve në internet – Sllovaki

I administruar nga Ministria e Drejtësisë së Sllovakisë, Regjistri i Bizneseve ofron informata të gjera në lidhje me bizneset që funksionojnë në këtë vend.

Rubrika për kërkim online u mundëson përdoruesve të kërkojnë informata mbi një biznes përmes emrit të biznesit, emrit të pronarit ose numrit të regjistrimit. Pasi të kesh kërkuar një biznes të caktuar, platforma shfaq këto të dhëna:

- a) historinë e biznesit,
- b) përfshirë informatat mbi partnerët;
- c) kontributet e secilit anëtar;
- d) organin menaxhues (*në të kaluarën dhe aktualisht*);
- e) kapitalin;
- f) organin mbikëqyrës; dhe
- g) përfaqësuesit e kompanisë

Përveç kësaj, platforma ofron mundësinë për të hulumtuar mbi çdo person, pra nëse kërkon një pjesëtar ose partner të një biznesi, sistemi shfaq historinë e personit në fjalë me biznesin përkatës. Këto informata gjithashtu përfshijnë dokumentet e mbledhur të bizneseve, si dokumente mbi rezultatet financiare, dokumentet themeluese dhe deklarata të anëtarëve të bordeve të tyre.

MINISTRY OF JUSTICE OF THE SLOVAK REPUBLIC

BUSINESS REGISTER
ON INTERNET

Slovensky  |  English

Searching by business name

Business name :

Legal form :

Court :

Way of searching : ☐ string anywhere in the name

Scope of searching : ☒ in actual records only

Searching by : [business name](#) | [identification number](#)
[registered seat](#) | [registration number](#) | [name of a person](#)

Foto 8: Regjistri i bizneseve.



MINISTRY OF JUSTICE OF THE SLOVAK REPUBLIC

BUSINESS REGISTER
ON INTERNET

Slovensky  |  English

Results of searching by business name
(searching in actual records only)

Business name starts with:

Legal form: any

Court: any

Page: 1 / 1

Records: 1 - 6 / 6

Date: 6/20/2017

	Business name	Extract	Collection of documents
1.		Actual Full	
2.		Actual Full	
3.		Actual Full	
4.		Actual Full	
5.		Actual Full	
6.		Actual Full	

Foto 9: Lista e kompanive që jepen nga sistemi.

Extract from the Business Register of the District Court Bratislava I
This extract has only indicative character and is not applicable for legal acts!

Section :	Sro	
Business name:	[REDACTED]	(from: 07/20/2005)
Registered seat:	Digital Park II, Einsteinova 23 Bratislava 851 01 Digital Park II, Einsteinova 23 Bratislava 851 01 Apollo BC, Prievozská 2/B Bratislava 2 821 09	(from: 09/11/2009) (from: 08/21/2009 until: 09/10/2009) (from: 07/20/2005 until: 08/20/2009)
Identification number (IČO):	35 946 067	(from: 07/20/2005)
Date of entry:	07/20/2005	(from: 07/20/2005)
Legal form:	Private limited liability company	(from: 07/20/2005)
Objects of the company:	činnosť podnikateľských, organizačných a ekonomických poradcov v rozsahu voľnej živnosti konzultačná a poradenská činnosť v oblasti manažmentu činnosť účtovných poradcov poradenská činnosť v oblasti obchodu a služieb v rozsahu voľnej živnosti sprostredkovateľská činnosť v oblasti obchodu a služieb v rozsahu voľnej živnosti organizovanie seminárov a školení školiaca činnosť v rozsahu voľnej živnosti počítačové služby služby súvisiace s počítačovým spracovaním údajov prieskum trhu a verejnej mienky administratívne služby vydavateľská činnosť činnosť agentúry dočasného zamestnávania	(from: 07/20/2005) (from: 07/20/2005) (from: 07/20/2005) (from: 07/20/2005) (from: 07/20/2005) (from: 08/05/2006) (from: 08/05/2006) (from: 04/06/2011) (from: 04/06/2011) (from: 04/06/2011) (from: 04/06/2011) (from: 04/06/2011) (from: 11/12/2016)
Partners:	[REDACTED] Lampousova Nicosia P.C.1095 Cyprus Arch. Makarios III Avenue, Eftapato Court 255 Limassol CY3105 Cyprus	(from: 02/10/2006) (from: 07/20/2005 until: 02/09/2006)
Contribution of each member:	[REDACTED] Amount of investment: 6 639 EUR Paid up: 6 639 EUR [REDACTED] [REDACTED] Amount of investment: 200 000 Sk Paid up: 200 000 Sk	(from: 02/26/2009) (from: 07/20/2005 until: 02/09/2006) (from: 02/10/2006 until: 02/25/2009)
Management body:	konatelia Marian Hudák Vretenová 3654/16 Bratislava 841 04 From: 12/15/2008 Ing. Ivan Lužica Triblavinská 1018/17A Chorvátsky Grob 900 25 From: 06/01/2011 Vladimír Masár Hlaváčiková 3594/35B Bratislava 841 05 From: 09/01/2013 Gavin Flock U parku 978 Praha - Průhonice 252 43 Česká republika From: 07/01/2015 Ivana Lorencovičová Laténska 731/3 Bratislava Rusovce 851 10 From: 06/01/2016 Marian Hudák Bakošova 44 Bratislava 841 03 From: 12/15/2008 Iain Child	(from: 07/20/2005) (from: 06/09/2009) (from: 06/01/2011) (from: 09/05/2013) (from: 07/02/2015) (from: 06/04/2016) (from: 01/13/2009 until: 06/08/2009) (from: 02/10/2006 until: 11/30/2010)

Foto 10: Shihni përshkrimin e plotë rreth partnerëve, përfshirë adresat dhe vendet. Shihni kontributet e secilit anëtar në hollësi. Shihni të gjitha hollësitë rreth organit menaxhues dhe historinë e menaxherëve me emra, adresa dhe data. ARBK në Kosovë nuk ofron informata të tilla.

Iain Child Tunbury Ave South 185 Walderslade, Chatham, Kent Velká Británie From: 02/01/2006	(from: 02/10/2006 until: 11/30/2010)
Iain Child Tunbury Ave South 185 Walderslade, Chatham, Kent Velká Británie From: 02/01/2006 Until: 12/01/2010	(from: 12/01/2010 until: 11/30/2010)
John Edward Nicholson Durham st. 28 Langley Park, Durham Velká Británie From: 02/01/2006	(from: 02/10/2006 until: 01/12/2009)
John Edward Nicholson Durham st. 28 Langley Park, Durham Velká Británie From: 02/01/2006 Until: 12/15/2008	(from: 01/13/2009 until: 01/12/2009)
Ing. Michal Petřman Iřská 796/1 Vokovice, Praha 6 160 00 Česká republika From: 02/01/2006	(from: 02/10/2006 until: 09/30/2009)
Ing. Michal Petřman Šermířská 2378/5A Břevnov, Praha 6 169 00 Česká republika From: 02/01/2006	(from: 10/01/2009 until: 11/09/2012)
Ing. Michal Petřman Šermířská 2378/5A Břevnov, Praha 6 169 00 Česká republika From: 02/01/2006 Until: 10/08/2012	(from: 11/10/2012 until: 11/09/2012)
Johnny Jozef Hubert Ploem Na malé šarce 810 Praha 6 Nebušice 164 00 Česká republika From: 10/08/2012	(from: 11/10/2012 until: 07/01/2015)
Johnny Jozef Hubert Ploem Na malé šarce 810 Praha 6 Nebušice 164 00 Česká republika From: 10/08/2012 Until: 07/01/2015	(from: 07/02/2015 until: 07/01/2015)
Jiří Polák Strašín 57 Říčany, Praha - Východ 251 01 Česká republika From: 07/20/2005	(from: 07/20/2005 until: 01/30/2007)
Jiří Polák Strašín 57 Říčany, Praha - Východ 251 01 Česká republika From: 07/20/2005 Until: 12/12/2006	(from: 01/31/2007 until: 01/30/2007)
Ing. Maroš Sokolovský Páříčkova 13 Bratislava 821 08 From: 06/01/2011	(from: 06/01/2011 until: 03/31/2014)
Ing. Maroš Sokolovský Páříčkova 13 Bratislava 821 08 From: 06/01/2011 Until: 04/01/2014	(from: 04/01/2014 until: 03/31/2014)
Trevor Wallinger Crofton Close 16 Bedford MK418AJ Velká Británie From: 07/20/2005	(from: 07/20/2005 until: 02/09/2006)
Trevor Wallinger Crofton Close 16 Bedford MK418AJ Velká Británie From: 07/20/2005 Until: 02/01/2006	(from: 02/10/2006 until: 02/09/2006)
Acting in the name of the company:	Společnost má jednoho nebo více konatelů. Ak je menovaný jeden konateľ, koná v mene spoločnosti konateľ samostatne. Ak je menovaných viacero konateľov, konajú za spoločnosť dvaja konatelia spoločne. Podpisovanie za spoločnosť sa uskutočňuje tak, že každý konateľ k písanému alebo vytlačenému obchodnému menu spoločnosti a k menu pripoji svoje meno a vlastnoručný podpis. (from: 11/12/2016)
Capital:	Konateľ koná za spoločnosť samostatne. Podpisovanie za spoločnosť sa uskutočňuje tak, že konateľ spoločnosti pripoji svoje meno a svoj vlastnoručný podpis k napísanému alebo vytlačenému obchodnému menu spoločnosti. (from: 07/20/2005 until: 11/11/2016)
Other legal facts:	6 639 EUR Paid up: 6 639 EUR (from: 02/26/2009) 200 000 Sk Paid up: 200 000 Sk (from: 07/20/2005 until: 02/25/2009) Obchodná spoločnosť bola založená zakladateľskou listinou zo dňa 20.04.2005 podľa § 57, §§ 105-153 Obchodného zákonníka č. 513/1991 Zb. v znení neskorších predpisov. (from: 07/20/2005) Rozhodnutie jediného spoločníka zo dňa 7.6.2006 - rozšírenie predmetu podnikania. (from: 08/05/2006) Rozhodnutie jediného spoločníka spoločnosti zo dňa 12.12.2006 - odvolanie konateľa spoločnosti. (from: 01/31/2007) Rozhodnutie jediného spoločníka zo dňa 28.11.2008. (from: 01/13/2009) Rozhodnutie jediného spoločníka zo dňa 30.7.2009 - zmena sídla. (from: 08/21/2009) Rozhodnutie jediného spoločníka zo dňa 30.7.2009 - zmena sídla. (from: 08/21/2009) Rozhodnutie jediného spoločníka zo dňa 10.03.2011. (from: 04/06/2011) Rozhodnutie jediného spoločníka zo dňa 08.10.2012. (from: 11/10/2012) Rozhodnutie jediného spoločníka zo dňa 21.03.2014. (from: 04/01/2014) Rozhodnutie jediného spoločníka zo dňa 26.05. 2016. (from: 06/04/2016)
Date of updating data in databases:	06/19/2017
Date of extract :	06/20/2017

Searching by : business name | identification number
registered seat | registration number | name of a person

Foto 11: Vini re listën e gjatë të anëtarëve të organit menaxhues dhe faktet juridike

Siç shihet nga fotoja numër 8, Regjistri i Bizneseve në Internet në Sllovakia është shumë më i avancuar kur bëhet fjalë për transparencë. Sistemi ofron mundësinë për të kontrolluar në internet partnerët e kompanisë dhe selinë e tyre të regjistruar. Ky është mjet i rëndësishëm që ***mund të ndihmojë gazetarët dhe organizatat e shoqërisë civile për të kontrolluar lidhjet e kompanive dhe prejardhjen e tyre gjatë hulumtimit të kontratave të dyshimta.***

Sistemi gjithashtu mundëson të kontrollosh aksionarët – kapitalin, informatë kyçe kjo mbi përfitimet për secilin anëtar gjatë afarizmit me shtetin.

Ndërsa në rubrikën në të djathtë është e lehtë t'i vësh re pikat në të cilat regjistri i bizneseve në Kosovë ngec.

Mund të vërehet se regjistri i bizneseve në Sllovakia ofron mundësinë për

 	
Rubrikë me Fakte - IV	
Regjistri i Bizneseve	
Sllovakia vs. Kosova	
Organi qeverisës	
Ministria e Drejtësisë	Ministria e Tregtisë
Informata rreth selisë së bizneseve	
Informata të plota. Për të kaluarën dhe aktualisht	Informata të kufizuara Vetëm për pjesën aktuale.
Informata rreth aktiviteteve afariste	
PO	PO
Informata rreth partnerëve	
Po, të hollësishme	JO
Informata rreth kontributit të anëtarëve	
Po, të hollësishme	JO
Informata rreth menaxherëve të kompanisë	
PO. Të kaluarat dhe të tashmen. Të hollësishme	JO
Informata rreth personave të autorizuar	
PO	PO
Informata rreth kapitalit të kompanisë	
PO. I kaluari dhe i tashmi	PO. Nuk ka histori.
Informata rreth akteve juridike të kompanisë	
PO. Në hollësi	JO
Information on database update	
YES. Up to the date	JO

të parë kush e drejton kompaninë. Këto informata janë të hollësishme, dhe në sistem pasqyrohen të gjitha ndryshimet në menaxhim. Edhe në këtë pikë, informatat e tilla janë kyçe për të kuptuar sjelljen e kompanisë; për të kuptuar nëse kompania është themeluar nga ose e lidhur me zyrtarë publikë ose persona të lidhur me ta në të kaluarën, apo nëse aktualisht ekziston një konflikt i mundshëm i interesit.

Për më tepër, sistemi ju mundëson të shikoni historinë e ndryshimeve ligjore të bëra nga një kompani. Akte të tilla ligjore përfshijnë informata mbi vendime për ndryshimin e aksionarëve, vendime për ndryshime në menaxhment, etj., të cilat gjithashtu janë mjet shumë i mirë për hulumtimin e lidhjeve ndërmjet bizneseve dhe zyrtarëve publikë e bashkëpunëtorëve të tyre.



Rubrikë me Fakte - V

Regjistri i partnerëve të sektorit publik Sllovakia VS Kosova

Organi qeverisës

Ministria e Drejtësisë	Nuk ekziston
------------------------	--------------

Provided Information

Emri i biznesit, forma ligjore, numri i identifikimit, adresa, data e themelimit, etj.	Nuk ekziston
Personi i autorizuar	
Pronarët që përfitojnë	
Zyrtarët publikë në strukturën e menaxhimit	
Njoftimi për verifikimin e përfituesit	
Gjobat	
Të dhëna të përditësuara	

15.0 Regjistri i partnerëve të sektorit publik

Regjistri i partnerëve të sektorit publik (RPVS), është listë **statutore** e të dhënave mbi partnerët e sektorit publik në Sllovakia, e cila është në dispozicion online. Sipas Ligjit nr. 315/2016, vetëm bizneset e regjistruar

në regjistrin e veçantë mund të marrin fonde publike nga qeveria. Kjo vlen për të gjitha nivelet e prokurimit publik (*si të qeverisë, ashtu edhe ato komunale*) që tejkalojnë shumën prej 100,000 euro, ose kur shuma e përgjithshme i kalon 250,000 euro për vit kalendarik. Regjistrimi nuk kërkohet për shpërndarjen e mallrave, punëve apo shërbimeve që paguhen nga Ambasada e Republikës së Sllovakisë.

Regjistri administrohet dhe menaxhohet nga Ministria e Drejtësisë, ndërsa regjistrimi kryhet në Gjykatën e Qarkut Žilina (Zhilina). Partnerët e sektorit publik duhet të regjistrohen në regjistër për të paktën aq kohë sa zgjat zbatimi i kontratës.

Informatat që duhet të dorëzohen nga kompanitë janë:

- a) emri ose emrin e biznesit;
- b) selia;
- c) forma ligjore;
- d) numri identifikues i organizatës, nëse i është dhënë një i tillë;
- e) lista e pronarëve përfitues;
- f) lista e zyrtarëve publikë që kryejnë funksione në Republikën Sllovake e të cilët janë pjesë e strukturës së pronësisë ose strukturës menaxhuese të partnerit të sektorit publik;
- g) të dhëna rreth personit të autorizuar.

Nëse në regjistër ndryshojnë të dhënat e futura lidhur me pronarët përfitues, partneri në fjalë i sektorit publik është i detyruar të informojë menjëherë personin e autorizuar të regjistruar në regjistër dhe personi i autorizuar është i detyruar ta njoftoj autoritetin regjistruar brenda 60 ditëve nga data kur janë bërë ndryshimet në fjalë.

Saktësia e të dhënave të futura në regjistër, identifikimi i pronarit përfitues, dhe verifikimin e pronarit përfitues, janë në përgjegjësi të partnerit të sektorit publik dhe të personit të autorizuar të regjistruar në regjistër.

Në rast se kërkesa për regjistrim përmban informata të rreme ose jo të plota, ***partneri i sektorit publik do të gjëbohet me shumë në vlerë të barabartë me përfitimin ekonomik që ka nxjerrë***, ndërsa në

rast se shumet reale të fituara nuk mund të identifkohen autoriteti për regjistrim duhet ta gjobisë atë me 10,000 deri në 1 milionë euro. Në rast të shkeljes së detyrës nga organi statusor duhet të jepet gjoba prej 10,000 deri në 100,000 euro.

Kompanitë nuk mund të regjistrojnë veten në sistemin RPVS. Regjistrimi kryhet nga një person i autorizuar (*ligji autorizon avokatët, noterët, bankat, degët e bankave të huaja, kontabilistët apo këshilltarët tatimorë, zyrtarët e regjistruara ose vëndndodhjen e biznesit në Sllovaki*). Këto autoritete duhet të nënshkruajnë një marrëveshje pajtueshmërie me personin e autorizuar nga kompania që duhet të regjistrohet në RPVS. Pas kësaj procedure, personi i autorizuar mund të kryejë të gjitha veprimet që lidhen me RPVS, në kapacitetin e partnerit të sektorit publik.

Me fjalë të tjera, regjistrimi në regjistrin e partnerëve të sektorit publik është i detyrueshëm për çdo kompani që dëshiron të bëjë biznes me shtetin.

Regjistrimi është shumë i rëndësishëm jo vetëm për sa i përket transparencës, por edhe verifikimit ligjor të kompanive.

Kjo platformë ofron informata lidhur me:

- a) Të dhënat mbi kompaninë – emrin e biznesit, formën ligjore, numrin identifikues, adresën, datën e themelimit;
- b) Personin e autorizuar – personin e autorizuar nga ana e kompanisë;
- c) Pronarët përfitues – personat që zotërojnë kompaninë, ata që përfitojnë nga kompania;
- d) Zyrtarët publikë në strukturën e menaxhimit;
- e) Njoftimin e verifikimit të përfituesve;
- f) Gjobat – gjobat e dhëna kompanisë nga ana e autoriteteve;
- g) Të dhëna të përfitësuar.

Legjislacioni i Kosovës nuk parasheh një kërkesë të tillë për operatorët ekonomikë kur punojnë me fonde publike. Kosova nuk kërkon që bizneset të regjistrohen në një regjistër të veçantë para se të bëjnë biznes me shtetin, dhe as nuk kërkon identifikimin e përfituesve. Për më tepër, as informatat aktuale të dhëna Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve nuk

janë plotësisht të konfirmuara³⁸. Megjithatë, kjo mund të rregullohet lehtë.

FOL-i rekomandon dy opsione se si mund të inkorporohet një rregullim i tillë në legjislacionin kombëtar:

- a) Hartimin e një ligji të veçantë mbi regjistrin e partnerëve të sektorit publik – kjo mund të arrihet përmes miratimit të një ligji, të ngjashëm me atë të Sllovakisë.
- b) Plotësim-ndryshimin e ligjeve aktuale – Ligji për Prokurim Publik dhe Ligji për Shoqëritë Tregtare mund të plotësohen-ndryshohen duke u shtuar dispozita që do t'i detyronin operatorët ekonomikë të regjistrohen në regjistrë të veçantë në mënyrë që të kualifikohen për të lidhur kontrata me institucionet publike, dhe dispozita të tjera relevante

MINISTERSTVO
SPRAVODLIVOSTI
SLOVENSKEJ REPUBLIKY

Register Partners public sector

GENERAL INFORMATION | REGISTER | ELECTRONIC SERVICES

Current data

Also historical data Download statement

Public Sector Partner

Business name	[REDACTED]
ID	31343414
Legal form	Limited Liability Company
Address / place of business / residence	Digital Park II, Einsteinova 23, 85101 Bratislava, Slovak Republic
Date of	02/01/2017
Date of deletion	It is not
file number	10607

Authorized person

Business name	
---------------	--

Foto 12: Regjistri i partnerëve të sektorit public. Kosova nuk ka një regjistrë të tillë

³⁸ Regjistrimi i bizneseve të huaja në Kosovë bëhet përmes procedurave të thjeshta dhe ARBK nuk kërkon identifikim të plotë të kompanisë amë. Verifikimi i tillë do të përfshinte dokumentet origjinale të lëshuara nga vendi i regjistrimit, të verifikuar nga noteri dhe shteti dhe verifikimin e përfituesve të kompanisë amë

Notice of verification of beneficial

No matching records

fined

No matching records

Date of updating data 06/21/2017

Date of listing 06/22/2017

Public officials in the management structure

No matching records

Beneficial owners

Name and surname	Date of birth	Nationality	Address	public official
Alastair Teare Guy Beaumont		United Kingdom of Great Britain and Northern Ireland	Zsiroshegyi Ut. 36, 1029 Budapest, Hungary	Not
Václav Loubek		Czech Republic	Petrovická 153/5, 10000 Praha - Strašnice, Czech Republic	Not
Martin Tesař		Czech Republic	Field 303, 25245 Zvole near Prague, Czech Republic	Not
Frederic Maziere		The French Republic	Bulgarian 588/1, 11000 Prague 10, Czech Republic	Not
Petr Michalik		Czech Republic	Záhradní 368/5, 77900 Samotšky, Czech Republic	Not
Diana Rádl Rogerová		Czech Republic	Gočárova 847, 14900 Prague 4, Czech Republic	Not
David Batal		Czech Republic	U hřístě 396, 25081 Nehvizdy, Czech Republic	Not
Attila Zoltán Kövesdy		Hungary	Galgoczy U. 28, 1125 Budapest XII., Hungary	Not
Pavel Raštica		Czech Republic	Trestle 831, 66401 Bilovice nad Svitavou, Czech Republic	Not
Ladislav Šauer		Czech Republic	Dalecin no. 166, 59241 Dalečín, Czech Republic	Not

Verification document (pdf) For the body was found verification document

Foto 13: Vini re detajet në regjistër. Të dhënat e të gjithë përfituesve janë dhënë duke përfshirë emrat dhe mbiemrat, nacionalitetin, adresën e fundit të banimit dhe faktin nëse ata janë zyrtarë publik apo jo

16.0

Regjistri i Llogarive

Regjistri i Llogarive funksionon në emër të Ministrisë së Financave të Sllovakisë. Ajo është krijuar për të përmirësuar dhe lehtësuar klimën afariste dhe për të zvogëluar barrën administrative të bizneseve. Duke përdorur këtë ueb-faqe përdoruesit mund të kërkojnë listën e subjekteve, të shfletojnë pasqyrat financiare në dispozicion dhe dokumentet e tjera të publikuara në Regjistër, si dhe të shikojnë, ruajnë dhe shtypin deklaratat dhe dokumentet e tjera të publikuara në Regjistër.

Kjo platformë ofron:

- Pasqyra financiare të kompanive;
- Raporte të auditorit;
- Raporte vjetore.

Platforma ofron informata në pjesën e qasshme për publikun dhe në atë jopublike. Në pjesën publike janë në dispozicion pasqyrat financiare të kompanive, korporatave, agjencive shtetërore, subjekteve qeveritare dhe subjekteve të cilat mbulohen nga standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe subjekte të tjera të zgjedhura.



Rubrikë me Fakte - VI

Regjistri i Llogarive

Sllovakia VS Kosova

Organi qeverisës

Ministria e Financave	Nuk ekziston
Përkrahës:	
Dhoma Sllovake e Auditorëve, Oda Sllovake e Këhsillëtarëve Tatimorë dhe Asociacioni Sllovak i Financierëve të Korporatave	Nuk ekziston


Informatat e ofruara

Pasqyrat financiare	Nuk ka
Raportet e auditimit	
Raportet vjetore	

Në pjesën jopublike të regjistrit gjenden pasqyrat financiare të subjekteve që nuk janë në atë publike. Këto përfshijnë në veçanti llogaritë e ndërmarrësve – individëve dhe organizatave jofitimprurëse që nuk janë të obliguar t'i publikojnë ato.

Kjo është shumë e rëndësishme për të hedhur dritë mbi të dhënat për bizneset, sidomos ato që bëjnë biznes me shtetin.

Regjistri i Llogarive në Sllovaki është përkrahur nga Oda Sllovake e Auditorëve, Dhoma Sllovake e Këshilltarëve Tatimorë dhe Shoqata Sllovake e Financierëve të Korporatave.



Register accounts
Ministry of Finance of the Slovak Republic

» [Search ÚJ](#) » [Detail ÚJ and the FS](#)

Detail entity

Data Source: SO SR, updated: 31.05.2017

Identification: [REDACTED] Tax: 2020325516 NACE: 69200 Accounting Business	Address: Einsteinova 23 85101 Bratislava-Petrzalka District: region: Bratislava Region	Date of establishment: 05.03.1993 Date of termination: - Legal form: Spol. Ltd Cat. size: 100-149 employees ownership: Foreign
---	---	--

Individually financial statements | **Annual reports**

season	type statements	tabled on	prepared on	approved on	audited day
▶ 01/2016 - 12/2016	individual ordinary	05/26/2017	05/16/2017		
▶ 01/2015 - 12/2015	individual ordinary	03/24/2016	03/24/2016	07/01/2016	
▶ 01/2014 - 12/2014	individual ordinary	07/15/2015	29.03.2015	17.06.2015	
▶ 01/2014 - 12/2014	individual ordinary	30.03.2015	29.03.2015	05/05/2015	
▶ 01/2013 - 12/2013	individual ordinary	31.03.2014	26.03.2014		
▶ 01/2012 - 12/2012	individual ordinary				
▶ 01/2011 - 12/2011	individual ordinary				
▶ 01/2010 - 12/2010	individual ordinary				
▶ 01/2009 - 12/2009	individual ordinary				

Screenshot 14: Regjistri I llogarive. Vini re raportet financiare vjetore dhe deklaratat.

17.0 Pjesëmarrja e palëve të interesuara

Për të nxitur llogaridhënien e qeverisë dhe besimin në institucionet publike, disa vende të OECD-së kanë praktika që ekzistojnë për një kohë të gjatë ku një gamë e gjerë e palëve të interesuara përfshihen në procesin e prokurimit, duke përfshirë këtu zyrat kundër korrupsionit, organizatat e sektorit privat, shfrytëzuesit e fundit të shërbimeve, shoqëria civile, mediat dhe publiku i gjerë. Kohët e fundit, disa vende kanë futur në përdorim kontroll të drejtpërdrejtë shoqëror, duke i përfshirë kështu qytetarët në fazat kritike të procesit të prokurimit. **Dialogu i hapur dhe i rregullt** me furnizuesit dhe shoqatat afariste mund të forcojë të kuptuarit e njëjtë nga të gjithë të faktorëve që formësojnë tregjet publike. Për shembull, Këshilli i Zyrtarëve Kryesorë të Përvetësimit të Kapitalit në Shtetet e Bashkuara ka institucionalizuar dialogun me palët e jashtme të interesuara.

Përfshirja e palëve të interesuara në proceset e politikave gjithashtu përbën një element themelor të instrumenteve të OECD-së për promovimin e integritetit. *Këshilli për Prokurim Publik i OECD-së* (OECD, 2015), rekomandon që entitetet zbatuese të nxisin **pjesëmarrjen transparente dhe efektive të palëve të interesuara**. Për më tepër, *Draft-rekomandimi i OECD-së, i Këshillit për Integritet Publik*, i inkurajon entitetet zbatuese që të ruajnë integritetin dhe të mbrojnë interesin publik në të gjitha fazat e proceseve politike dhe të politikave, në veçanti përmes (1) ofrimit të gjitha palëve të interesuara – organizatave të shoqërisë civile, bizneseve, medieve dhe qytetarëve – të hapësirës së barabartë për t'u dëgjuar në zhvillimin dhe zbatimin e politikave publike; dhe (2) lehtësimit të përfshirjes së shoqërisë civile, gjë që përfshin organizata që i kërkojnë llogari qeverisë, grupe qytetarësh dhe media të pavarura, për të siguruar llogaridhënie efektive.

17.1 Kosova

Kosova tashmë ka prokurim publik elektronik, i cili nndhet nën menaxhimin e KRPP-së, ndaj është e rëndësishme të dihet se si funksionon procesi dhe nëse ka vend për shoqërinë civile që ta monitorojë atë drejtpërsëdrejti.

Në nenin 36 të [*Rregullores dhe udhëzuesit për prokurim publik*](#) thuhet si në vijim:

“36.2 Në çdo proces të prokurimit elektronik krijohen dy çelësa që i përkasin ekskluzivisht procedurës për të cilën janë krijuar.

*36.4 Procesi i hapjes publike mund të fillojë pas skadimit të afatit për dorëzimin e ofertave. Pas skadimit të afatit shfaqet formulari automatik për ngarkimin e çelësve privatë. **Përfaqësuesit e autorizuar** janë të detyruar të përdorin platformën dhe secilin çelës privat veç e veç që u është dorëzuar atyre fillimisht përmes e-mailit.*

36.5 Procedura e hapjes e tenderit fillon me hyrjen e përfaqësuesve të autorizuar të autoriteteve kontraktuese.”

Bazuar në shembullin e Meksikës, edhe Kosova mund të caktojë përfaqësues nga shoqëria civile në kontratat me vlerë mbi një prag të caktuar. Kjo do të përmirësojë edhe më tej transparencën dhe do të rrisë besueshmërinë e procesit të hapjes së tenderëve.

Kosova duhet të rishikojë mundësinë e krijimit të një ombudsmani të prokurimit. Organi i Shqyrtimit Publik do t`i kryej funksionet e njëjta, por zyra që do të krijohet tek avokati i popullit do të shërbente si organ alternativ për zgjidhje të mosmarrëveshjeve kur palet bien dakord. Nëse zgjedhja e anëtarëve të OSHP-së do të bëhej me konkurs, me kritere të qarta dhe transparente, do të rritej edhe më tej besimi në OSHP, por për momentin, anëtarët e OSHP-së, zgjedhen përmes Parlamentit.



Rubrikë e Shkurtër - V

Dëshmitarët shoqërorë

Që nga viti 2009, dëshmitarët socialë janë të detyruar të marrin pjesë në të gjitha fazat e procedurave të tenderimit publik mbi një prag të caktuar, si mënyrë për të promovuar kontrollin nga publiku. Në vitin 2014, këto pragje ishin deri në MXN 336 milionë ($\approx$ 25 milionë USD) për mallra dhe shërbime dhe MXN 672 milionë ($\approx$ USD 50 milionë) për punë publike.

Dëshmitarët shoqërorë janë organizata joqeveritare dhe individë të përzgjedhur nga Ministria e Administratës Publike (SFP) përmes tenderëve publikë. SFP mban një regjistër të dëshmitarëve shoqërorë të miratuar dhe vlerëson punën e tyre; performanca e pamjaftueshme mund të rezultojë në largimin e tyre nga regjistri

Kur një entitet federal kërkon përfshirjen e një dëshmitari shoqëror, ai e informon SFP-në, e cila e cili cakton njërin nga regjistri.

Që nga janari 2014 SFP ka regjistruar 39 dëshmitarë shoqërorë për projektet e prokurimit publik: 5 organizata të shoqërisë civile dhe 34 individë.



Rubrikë e Shkurtër - VI

Ombudspersoni i Prokurimit në Kanadë

Në Kanada është themeluar një Ombudsperson i Prokurimit, në vitin 2008, me qëllimin për të përmirësuar efektivitetin dhe transparencën e praktikave të punës në lidhje me prokurimin. Kjo ishte pjesë e një sërë reformash për zbatimin e Planit Federal të Veprimit për Llogaridhënie, me qëllimin për të ndihmuar në forcimin e llogaridhënies, transparencës dhe mbikëqyrjen e aktiviteteve të qeverisë federale.

Objektivat

Objektivi i përgjithshëm i Zyrës së Ombudspersonit të Prokurimit është që të promovojë drejtësi, hapje dhe transparencë në prokurimin e qeverisë federale. Mandati dhe roli i tij janë si në vijim:

1. Shqyrtimi i praktikave të departamenteve për marrjen e materialeve dhe shërbimeve, për të vlerësuar drejtësinë, hapjen dhe transparencën dhe nxjerrja e çfarëdo rekomandimeve të duhura për departamentin relevant
2. Shqyrtimi çfarëdo ankese lidhur me dhënien e një kontrate për blerjen e mallrave me vlerë nën 25,000 dollarë kanadezë dhe shërbimeve me vlerë nën 100,000 dollarë, në ato raste kur vlejnë kriteret e Marrëveshjes së brendshme të Kanadës për Tregti të Brendshme, por për pragun në dollarë
3. Shqyrtimi çfarëdo ankese lidhur me administrimin e një kontrate për blerjen e materialeve ose shërbimeve nga një departament ose agjenci, pavarësisht nga vlera në dollarë
4. Sigurimi se ekziston një proces për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve, nëse të gjitha palët në kontratë bien dakord të marrin pjesë

Burimi: OECD (2013a), <http://dx.doi.org/10.1787/9789264201385-en>.

18.0 Kontratat e hapura

As të publikuara e as të hapura

Në vitin 2009, Kosova ka nënshkruar kontratën më të madhe ndonjëherë. Vlera e saj reale kurrë nuk u është bërë e qartë qytetarëve, pasi që bazuar në atë se si ishte negociuar vlera e saj mund të shkonte nga disa qindra milionë euro deri në mbi një miliardë euro. Kontrata është fituar nga një konsorcium ndërtimi i quajtur “**Bechtel & Enka**”. Autostrada “Ibrahim Rugova”, është e para në Kosovë e ndërtuar sipas standardeve ndërkombëtare. Ajo është përfunduar në nëntor 2013 nga kompania amerikane “Bechtel”, së bashku me atë turke “Enka”, dhe të cilat fituan tenderin për ndërtimin e saj. Autostrada e gjatë 72 kilometra me katër korsi në Kosovë ka kushtuar \$1.3 miliardë – ose rreth \$18 milionë për kilometër³⁹.

Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës nuk jep kurrfarë detajesh lidhur me pronarët dhe përfituesit e kompanive “Enka” dhe “Bechtel”. Të vetmet entitete të regjistruara me këto emra kompanish janë “**Bechtel International Inc C20091007-0301**” dhe “**Bechtel International Inc**” dhe “**Enka Insaat Ve Sanayi A.S.**”.

Deri më sot nuk dihet se kush janë njerëzit pas këtyre korporatave të mëdha dhe ku ka shkuar i tërë fitimi i financuar nga paratë e tatimpaguesve të Kosovës.

Për shkak të kostos enorme të kontratës, shoqëria civile ka ngritur dilema rreth nevojës për një projekt të tillë, por gjithashtu ka kërkuar transparencë në zbatim, pasi që bëhet fjalë për para të tatimpaguesve.

Ministria e Infrastrukturës me vite të tëra ka refuzuar ta bëjë këtë proces transparent dhe nuk ka dhënë informata të plota rreth kësaj dosjeje tenderi.

³⁹ http://foreignpolicy.com/2015/01/30/steamrolled-investigation-bechtel-highway-business-kosovo/?utm_content=buffer01d63&utm_medium=social&utm_source=facebook.com&utm_campaign=buffer

Për shkak të shpenzimeve të projektit, konsorciumi ka nënkontraktuar një numër të madh të kompanive vendore. Shumë besojnë se kompanitë vendore ishin të lidhura drejtpërsëdrejti me vendimmarrës në qeveri në kohën kur është nënshkruar kontrata dhe më pas gjatë ndërtimit të rrugës (Lëvizja FOL, 2011).

Kontrata me “Bechtel & Enka”, ka qenë dhe mbetet një nga shembujt më të fuqishëm që tregon arsyen për hapjen e kontratave në tërësi dhe pse duhet të bëhen të ditur përfituesit e tyre.

18.1 Çka janë kontratat e hapura?

Një nga diskutimet më të mëdha kur bëhet fjalë për transparencën në prokurim publik është hapja e kontratave për publikun e gjerë. Ata që e kundërshtojnë këtë ide nuk e kuptojnë me të vërtetë dhe plotësisht rëndësinë e saj në promovimin e konkurrencës së drejtë dhe të shëndetshme, kursimin e parave të taksapaguesve dhe luftimin e korrupsionit.

Siç do të tregojmë në pjesën mbi analizën e legjislacionit, qeveria po e interpreton gabimisht Ligjin për Shoqëritë Tregtare, atë për prokurimin publik dhe atë për qasje në dokumentet publike vetëm për të kufizuar qasjen në dokumente publike, përfshirë këtu kontratat.

Ndonëse ka diskutime të ashpra lidhur me kontratat e hapura, jo të gjithë e dinë se çfarë në të vërtetë është një kontratë të hapur. Dhe pasi që nuk ka udhëzime të qarta mbi publikimin e dokumenteve, atëherë kjo ka çuar në një gjendje ku institucione të ndryshme zbatojnë ligjet për qasje në dokumente publike në mënyra të ndryshme.

Deri në një farë mase, në Kosovë ekziston një besim se nëse vendosni një dokument në ueb-faqe është realizuar misioni i transparencës, Kjo, pavarësisht nëse vegëza në internet prishet ose dokumenti është i cilësisë së dobët, apo i skanuar në mënyrë jo të duhur.

Në epokën digjitale, një kontratë duhet të konsiderohet të jetë me të vërtetë e hapur nëse i plotëson këto kushte:

- Është publikuar dhe është në dispozicion në internet;
- Është pa pagesë;
- Ka 'të dhëna plotësuese' (që lidhen me të dhëna të tjera) brenda saj;
- Është e qasshme dhe mund të bësh kërkime brenda saj në një format të lexueshëm me makinë.⁴⁰

Sipas "Partneritetit për Kontrata të Hapura", rrjet ky me seli në Uashington, kontratat e hapura përfshijnë tërë zinxhirin e marrëveshjeve që bën qeveria, nga shitja e pasurive shtetërore deri te prokurimi i mallrave dhe shërbimeve për qytetarët. Kjo mbulon jo vetëm dhënien e kontratave, por edhe prokurimin, negocimin e kontratave, zbatimin dhe performancën (Partneriteti për Kontrata të Hapura (OCP), 2015).

18.2 Bërja publike e informatave rreth planifikimit të kontratave

Transparenca gjatë planifikimit të një kontrate është vendimtare kur bëhet fjalë për arritjen e Vlerës më të Mirë për Paratë e dhëna (VMMP), por edhe në parandalimin e skemave të korrupsionit. Për shembull,

Foto 15: Kontrata e dërguar nga Agjencia e Kosovës për Privatizim pasi e kemi kërkuar atë zyrtarisht. Vini re se si faqja e parë është në format portret, ndërsa e dyta në format panoramik.

⁴⁰ Dokumentet e lexueshëm me makinë janë në një format që mund të kuptohet dhe të përdoret përmes kompjuterit.

http://lexicon.ft.com/Term?term=machine_readable&mhq5j=e1

“Portali i Kontratave Publike”, në Skoci përmban një plan paraprak për të paktën një vit, për t’u mundësuar operatorëve ekonomikë që të përgatiten paraprakisht⁴¹. Ky plan ka për qëllim të japë informata mbi mundësitë për bashkëpunim nga organizatat blerëse të sektorit publik në Skoci, të cilat mund të shpallen gjatë 12-18 muajve të ardhshëm. Kjo i njofton paraprakisht furnizuesit mbi mundësitë për bashkëpunim që mund të ofrohen nga sektori publik në të ardhmen – në mënyrë që të mund të planifikojnë në përputhje me rrethanat.”

Në Kosovë, në të kaluarën kemi qenë dëshmitarë se si rrugët dhe urat janë ndërtuar në periudha vjetore zgjedhjesh. Kosova ka një kornizë shumë të mirë ligjore për planifikimin e prokurimit. Neni 8 i Ligjit për Prokurimin Publik përcakton afate dhe rregullat të qarta për planifikimin paraprak të prokurimit.

Ai i kërkon secilit autoritet kontraktues që ta dërgoj parashikimin e prokurimit njëvjeçar në Agjencinë Qendrore të Prokurimit jo më vonë se 15 ditë para fillimit të vitit të ri fiskal. Planifikimi paraprak i prokurimit ndihmon në parandalimin e pagesave të minutës së fundit. Edhe pse ky është dokument publik nga vetë natyra e tij, ai nuk mund të gjendet në internet, dhe si i tillë nuk është duke u ndarë me operatorët ekonomikë për t’u dhënë atyre përparësinë e përgatitjes dhe bashkëpunimit. Për të arritur VMMP-në, ky lloj dokumenti duhet të bëhet publik dhe të jetë në dispozicion të operatorëve ekonomikë. Transparenca në fazën e planifikimit jo vetëm që ndihmon në arritjen e VMMP-së, duke kursyer paratë e taksapaguesve, por gjithashtu u ndihmon mediave dhe shoqërisë civile për të monitoruar keqpërdorimin e mundshëm të fondeve publike dhe aferat korruptive.

⁴¹ <https://www.publiccontractsscotland.gov.uk/Default.aspx>

18.3 Bërja publike e informatave rreth procesit të tenderimit ose negocimit

Informatat e dhëna nga autoritetet gjatë procesit të tenderimit janë të rëndësishme në mënyrë që operatorët ekonomikë të sigurohen se procesi



është i drejtë dhe transparent. Ndër të tjera, kjo do të rrisë konkurrencën në procesin që çon në VMMP. Bazuar në parimet udhëheqëse në fuqi në Qipro (rubrika VII.), autoritetet duhet të veprojnë në mënyrë të drejtë gjatë tërë ciklit të prokurimit, pa u vënë furnizuesve ose furnizuesve potencialë ngarkesa ose kufizime të panevojshme dhe duhet të shmangin çfarëdo trajtimi favorizues ndaj një furnizuesi të caktuar aktual ose potencial.

Në Kosovë, informatat lidhur me procesin e tenderimit janë të hapura përmes prokurimit elektronik. Siç tregon rubrika III përmes prokurimit elektronik jepen informata të rëndësishme lidhur me kontratat, procedurat e tenderimit, vlerën e tyre, dhe kriteret e përzgjedhjes.

Krahasuar me platformën e prokurimit elektronik EVO, në Sllovaki, platforma e-prokurimi në Kosovë ofron më pak informata në format të lexueshëm me makinë, por mundëson shkarkimin në format PDF-je, të disa informatave, si kriteret e për zgjedhjes, të cilat janë tejet të rëndësishme.

Dallimet ndërmjet kontratave aktive në Kosovës dhe kontratave aktive në Sllovaki ilustrohen në rubrikën në vijim.

18.4 Bërja publike e informatave rreth dhënies se kontratave

Pasi procesi i tenderimit të ketë përfunduar dhe autoriteti ka vendosur të japë kontratën, është me rëndësi kyçe që kontrata në fjalë të publikohet në internet. Bërja publike e kontratave është e rregulluar në mënyra të ndryshme, në vende të ndryshme. Në Sllovaki, e cila është rasti ynë i studimit në këtë raport, kontratat janë tërësisht të hapura. Sipas ligjit të Sllovakisë, secili autoritet kontraktues është i detyruar të publikojë kontratat në internet, në ueb-faqen e Zyrës së Prokurimit Publik (UVO), ose në ueb-faqen e vet, dhe kontratat që **nuk janë të publikuara në internet nuk konsiderohen të jenë në fuqi**.

Sllovakia gjithashtu bën publike të gjitha anekset dhe shtojcat e kontratës.

Në Kosovë ofrohet qasje e kufizuar në kontrata. KRPP-ja nuk ofron mundësinë për të parë kontratat në

Rubrikë e Shkurtër - VII

Ofrimi i Vlerës më të Mirë për Paratë e dhëna (VMMP)

Qëllimi dhe parim themelor në prokurimin publik është **arritja e vlerës më të mirë për paratë e dhëna (VMMP)**. Kjo nënkupton se autoritetet kontraktuese vënë parime strikte kur bëhet fjalë për shpenzimin e parave të tatimpaguesve.

Parimet udhëheqëse që përdor Drejtoria e Prokurimit Publik në Qipro për të arritur VMMP janë:

Konkurrenca – Duhet të inkurajohet konkurrenca ndërmjet furnizuesve në mënyrën më efektive dhe efektive.

Efikasiteti dhe efektiviteti – Efikasiteti dhe efektiviteti duhet të kërkohet në procesin e prokurimit për të siguruar vlerën për paratë e dhëna për autoritetin kontraktues.

Drejtësia / Jo -diskriminimi – Vepro në mënyrë të drejtë gjatë gjithë ciklit të prokurimit, pa krijuar ngarkesa ose kufizime të panevojshme ndaj furnizuesve ose furnizuesve të mundshëm. Shmangni çfarëdo trajtimi favorizues ndaj një furnizuesi ose furnizuesi potencial.

Objektiviteti / Integriteti / Ndershmëria – Deklaroni çfarëdo konflikti të interesit që ndikon ose duket se ndikon në gjykimin tuaj. Refuzoni dhurata, mikpritje dhe përfitime të çfarëdo lloji nga një furnizues ose furnizues potencial, të cilat mund të shihet se kompromitojnë në mënyrë të arsyeshme objektivitetin apo integritetin e tyre.

internet, e as ndonjë vegëz në ueb-faqe me një bazë të dhënash nga ku mund të shkarkohen kontratat e tilla. Sipas rregullit të gjithakontratave janë të mbyllura dhe nuk ndahen me publikun, përveç nëse dikush kërkon ndryshe përmes një letre të shkruar. Kjo e fut Kosovën në kategorinë e atyre vendeve që ofrojnë transparencë pasive në prokurimin publik, që nënkupton se informatat vihen në dispozicion vetëm nëse dikush e kërkon këtë gjë.

Ndonëse ky është informim sipas kërkesës, Kosova nuk arrin të përmbushë standardet e transparencës as me këtë sistem. Lëvizja FOL, ka testuar me institucionet qasjen e transparencës sipas kërkesës, dhe rezultatet janë zhgënjyese. Jo vetëm që procesi i qasjes në një kontratë publike merr shumë kohë, por edhe kur jepet qasja ajo është zakonisht e kufizuar.

Transparenca – Siguroni kushte dhe qasje të barabarta të të gjithë operatorëve ekonomikë, duke i informuar ata në mënyrë të hapur dhe transparente.

Llogaridhënia – Jepni llogari për përgjegjësitë e dhëna, si dhe për vendimet që marrin ata, dhe mbani të dhënat e duhura.

Konfidencialiteti / Saktësia e informatave ionit / Mbrojtja e pronësisë intelektuale – Respektoni konfidencialitetin e informatave të marra gjatë kryerjes së detyrave dhe mos zbuloni kurrfarë informatash pa pasqion të tillë, pa pasur autoritetin e duhur dhe legjitim.

Respektimi i ligjeve që i shërbejnë interesit publik / Përgjegjshmëria – Në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe të BE, si dhe me kërkesat e obligimet e tjera sa i përket prokurimit publik. Shërbeni interesit të publikut dhe veproni me përgjegjshmëri në shfrytëzimin e parave të tatimpaguesve

Profesionalizmi – Punoni sipas standardeve të larta të profesionalizmit duke u sjellë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe zbatimin e legjislacionit në fuqi dhe zbatimin e praktikave të mira.

“Blerje të gjelbra” – Shfrytëzoni mundësitë për të përfshirë konsideratat dhe çështjet e mjedisit në secilën fazë të ciklit të prokurimit.

18.5 Bërja publike e informatave mbi zbatimin e kontratave, përfshirë pagesat

Pas përfundimit të procedurës së tenderimit dhe nënshkrimit të kontratës, kontraktuesit i kërkohet të **zbatojë** projektin në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës, ndërsa Autoritetit Kontraktues, nga ana e tij, i kërkohet të **menaxhojë kontratën** që është nënshkruar me Palën e Kontraktuar dhe të **monitorojë** performancën e tij gjatë ekzekutimit të punëve.

Në këtë fazë kërkohet bërja publike e informatave lidhur me administrimin dhe menaxhimin e kontratës dhe, ç'është më e rëndësishmja, pagesat. Pagesat për palën e kontraktuar lidhen zakonisht me të arriturat në zbatimin e kontratës. Bërja publike e pagesave i mundëson shoqërisë civile, mediave dhe qytetarëve të shohin nëse kompanitë po paguhen sipas kushteve të kontratës dhe nëse ata kanë përmbushur kërkesat e kontratës. Të gjitha informatat relevante gjatë procesit të monitorimit dhe vlerësimit gjithashtu duhet të bëhen publike.

Në këtë fazë Kosova po dështon keq në transparencë. Siç do të shohim në kreun e analizës ligjore, faqe 93 në këtë fazë pothuajse asgjë nuk është duke u bërë publike. Lëvizjes FOL, i është refuzuar qasja në menaxhimin e kontratave dhe pagesave nga ana e institucioneve të rëndësishme, me arsyetimin e sekreteve tregtare, por arsyet të tilla nuk vlejnë, dhe me sa duket institucionet shkelin Kushtetutën dhe ligjin mbi qasjen në dokumentet publike sa herë që refuzojnë qasjen. Për më tepër, shihni në faqen 93.


Në këtë pjesë, të gjitha faturat e dorëzuara autoritetit kontraktues nga operatorët duhet të bëhen publike, si dhe urdhrat dhe pagesat e ekzekutuara nga autoriteti kontraktues. Kjo është e një rëndësie kyçe, pasi që i mundëson shoqërisë civile dhe mediave të kontrollojnë cilësinë e punës së bërë me paratë e tatimpaguesve.

Rubrika VII tregon disa parime themelore që duhet merrë parasysh nga organet e prokurimit gjatë ciklit të çdo procedure të prokurimit.

KRPP-ja e ka një kod të mirësjelljes (shihni rubrikën I, faqe 25) dhe shumica e parimeve të integritetit janë aty, por duhet të ketë mekanizma për zbatimin e tyre.

19.0 Transparenca alternative – rasti i “*Transparency Slovakia*”

Në janar të vitit 2011, Sllovakia ka filluar me zbatimin e një regjimi të paparë të qasjes së hapur duke vendosur të bënte publike shumicën e kontratave publike dhe duke i publikuar ato në internet, duke përfshirë ‘meta të dhëna’⁴², të ofruara në një format të hapur dhe të lexueshëm me makinë.




“*Transparency International Slovakia*”, e shfrytëzoi këtë mundësi për të ndërtuar platformën e vet që do t’i mundësoj hulumtime të gjera nga

⁴² Tërësi të dhënash që përshkruan ose jep informata lidhur me të dhëna ose informata të tjera, ose informata që përshkruajnë informata të tjera për t’u ndihmuar t’i kuptoni apo përdorni ato. <https://en.oxforddictionaries.com/definition/metadataoxford>

shoqëria civile, mediat dhe qytetarët për identifikimin e pikave alarmante për rastet e korrupsionit në prokurimin publik.

Ideja e TI Sllovakisë ishte që të shfrytëzonte portalin për të ndërlidhur bazën e të dhënave të kontratave me urdhërpagesat dhe faturat, me dokumentacionin e prokurimit dhe regjistrin e bizneseve, me bazën e të dhënave të granteve dhe atë të subvencioneve, e kështu me radhë, për të krijuar një mjet gazetarie hulumtuese për gazetarët, por edhe për qytetarët.

Portali i TI Sllovakia ‘Kontratat e Hapura Publike në Sllovaki’ (<http://tender.sme.sk>) përfshin kontrata që datojnë që nga viti 2009. Kjo ueb-faqe mbulon mbi 40,000 kontrata. Përdoruesit mund të kërkojnë informata sipas kontratave, organeve të qeverisë që japin kontratat, si dhe sipas kompanive fituese të kontratave.



Që nga nëntori 2015, të gjitha informatat mbi pronarët përfitues të kompanive fituese të kontratave publike në Sllovaki janë publikuar në një

regjistër publik: <https://rpvs.gov.sk/rpvs>. Kjo i ka mundësuar *TI Sllovakia* të përqendrohet më thellësisht në pronarët që përfitojnë nga kompanitë fituese të kontratave publike, bazuar në të dhënat e regjistrit të bizneseve. TI zbuloi se në të kaluarën ‘kompani guaskë’⁴³ të lidhura me zyrtarë partie kanë fituar kontrata publike në Sllovaki. Pasi kjo u bë publike qeveria në Sllovaki vendosi të propozonte ligjin, të cilin e miratoi parlamenti, që të **kufizonte pjesëmarrjen në prokurimin publik të ofertuesve me pronarë të panjohur**. Ligjvënësit në Sllovaki u fokusuan në të ashtuquajturat ‘**parajsa tatimore**’⁴⁴, duke e vendosur si rregull që çdo kompani me seli në një prej vendeve të tilla nuk kualifikohet për të marrë pjesë në tenderët publikë në Sllovaki. TI Sllovakia lidhi kategoritë e të dhënave të regjistrit të prokurimit publik me ato të regjistrit të bizneseve dhe identifikoi dy skandale të mëdha të prokurimit publik, [në hotelieri dhe në ndërtime në sektorin e kujdesit shëndetësisë](#). Më pas mediet bënë publike të dhënat, dhe një numër zyrtarësh publikë u detyruan të jepnin dorëheqje, dhe kështu u pranua që reformat më ambicioze për transparencë të ktheheshin në ligj.

⁴³ Kompani jo-tregtare që shfrytëzohet si mjet për manovra të ndryshme financiare ose që mbahet pasive për t’u shfrytëzuar në të ardhmen në ndonjë cilësi tjetër.

https://en.oxforddictionaries.com/definition/shell_company

⁴⁴ Vend ku njerëzit paguajnë më pak tatime sesa që do të paguanin nëse jetojnë në vendin e tyre. <http://dictionary.cambridge.org/dictionary/english/tax-haven>

19.1 FOL kërkon reforma ambicioze në prokurimin publik në Kosovë

Transparenca dhe llogaridhënia

Prokurimi elektronik ka treguar se mund të jetë një hap i madh përpara drejt transparencës në prokurimin publik në Kosovë. Procesi nuk mund të zmbropset nga prokurimi elektronik, por duhet të avancojë më tej në mënyrë që të bëhet gjithnjë e më efektiv, efikas dhe transparent. Por, siç tregon ky raport dhe rasti studimor, Kosova është vetëm në hapat e parë të sigurimit të transparencës dhe vetëm prokurimi elektronik nuk mjafton.

Në analizën e legjislacionit më poshtë nxjerrim në pah natyrën e ndërlikuar të pengesave drejt arritjes së kësaj transparence.

Tashmë kemi identifikuar disa hapa të rëndësishëm që duhet të ndërmerren për të hapur rrugën drejt transparencës në prokurimin publik.

Institucionet e caktuara duhet të ndërmarrin veprimet në vijim për të sjellë transparencë në prokurimin publik dhe për të luftuar korrupsionin e nivelit të lartë.

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik duhet:

- a) T`i publikoj automatikisht në ueb-faqen e tij të gjitha kontratat, kontratat shitesë dhe shtojcat e kontratave, që nga viti 2010 e këndej, në format të lexueshëm me makinë;
- b) T`i publikoj në internet të gjithë urdhërpagesat, faturat dhe pagesat që rrjedhin nga kontratat publike të menaxhuara nga KRPP, në format të lexueshëm me makinë;
- c) T`i publikoj planet njëvjeçare paraprake të prokurimit nga të gjitha autoritetet kontraktuese, në format të lexueshëm me makinë;

- d) T`i publikoj të gjitha informatat rreth njoftime mbi kontrata, kriterëve të përzgjedhjes (shpalljeve për tenderë), me legjenda të thjeshta, në format të lexueshëm me makinë;
- e) T`i publikoj ofertuesit/ofertat në format të lexueshëm me makinë;
- f) T`i përjashtoj pronarët e panjohur nga pjesëmarrja në prokurimin publik;
- g) T`i përjashtoj nga pjesëmarrja në prokurim publik operatorët ekonomikë ose bizneset me pronarë të fshehur apo pronarë përfitues që janë të panjohur;
- h) T`i përjashtoj kompanitë, pronarët e kompanive dhe përfituesit e tyre të cilët janë gjobitur për korrupsion apo keqpërdorim të fondeve publike, që të marrin pjesë në çfarëdo mënyre në procesin e prokurimit publik

ARBK-ja duhet t`i publikoj:

- a) Të dhënat e plota, të përditësuara, të bizneseve, përfshirë adresat, shtetësinë e personave të autorizuar, dhe të pronarëve, menaxherëve dhe partneriteteve;
- b) Historinë e plotë të personave të autorizuar, pronarëve, menaxherëve dhe partneriteteve;
- c) Historinë e plotë të ndërhyrjeve ligjore, dhe akteve ligjore;
- d) Të gjitha të dhënat e pronarëve përfitues, në një ueb-faqe të veçantë. Pronarët e tillë duhet të listohen pasi të jenë verifikuar nga noterët, siç është e rregulluar me ligj.

Ministria e Financave duhet t`i publikoj:

Rubrikë e Shkutër -VII

Çfarë janë të dhënat e lexueshme nga robotët?

Të dhënat janë të lexueshme me makinë nëse janë në format që mund të lexohen, shkruhen, shfaqen dhe analizohen lehtë nga kompjuteri.

Dokumentet e qasshme në mënyrë digjitale janë parakusht që të jenë të lexueshme me makinë, por vetëm nëse janë në format të caktuar.

Formati i lexueshëm me makinë nënkupton një format të dosjes të strukturuar në atë mënyrë që aplikacionet e programeve kompjuterike lehtë të mund t'i identifikojnë, njohin dhe nxjerrin të dhëna të veçanta, përfshirë deklaratat individuale faktike, si dhe strukturën e tyre të brendshme.

Formatet e lexueshme me makinë që përdoren më së shumti nga qeveritë dhe kompanitë janë: CSV, JSON dhe XML.

Vlerat e ndara me presje (CSV) është format i të dhënave tabelore. Ai ruan të dhënat tabelore (numra dhe tekst) në formë teksti të thjeshtë

CSV-ja paraqet linja të dhënash, ku secila është e ndarë nga tjetra me nga një presje. Ajo mund të ngarkohet në aplikacione si Excel, duke mundësuar që të jetë e qasshme për përdoruesit. ergo duke e bërë atë të kuptueshme për përdoruesit.

I konsideruar si 'emërues' për të dhëna të hapura, CSV-ja mbështet ripërdorimin e gjerë të të dhënave të hapura.

Burimi: Doracaku i të dhënave të hapura, Portali Evropian i të Dhënave Data.gov

- a) Të dhënat vjetore financiare në internet të të gjitha kompanive që bëjnë biznes me shtetin në një platformë për regjistrimin e partnerëve të sektorit publik. Të gjitha kompanitë e tilla që konsiderohen partnerë

duhet të bëjnë publike të gjitha informatat në mënyrë që tatimpaguesit të dinë se kush zotëron dhe operon me kompani të tilla.

- b) Administrata Tatimore duhet të publikojë më shumë të dhëna për t'u mundësuar qytetarëve të përcjellin ku po shpenzohen tatimet e tyre.

Qeveria duhet të rishikojë dhe plotësojë-ndryshojë ligjet për:

- a) Qasje në dokumente publike
- b) Prokurimin publik, dhe
- c) Shoqëritë tregtare

Dhe të hartojë ligje të reja mbi:

- a) Pronarët përfitues dhe 'parajsat tatimore', dhe
- b) Regjistrin e partnerëve të sektorit publik

Të gjitha këto ndryshime do të forcojnë transparencën dhe llogaridhënien në prokurimin publik. Kompanitë nuk do të konsiderohen partnerë në prokurimin publik nëse nuk janë të regjistruar në regjistrin e partnerëve të sektorit publik dhe i bëjnë publike të gjitha informatat rreth biznesit të tyre.

19.2 Krijimi i një platforme paralele të prokurimit publik të hapur

Bazuar në përvojën e “*Transparency International Slovakia*”, FOL-i, ka në plan të ndërtojë një platformë të ngjashme në Kosovë në muajt e ardhshëm. Kjo platformë do të jetë e ngjashme me platformën *tender.sme.sk* të TI Sllovakisë, por me më shumë filtra dhe përmbajtje vizuale. FOL-i do ta plotësojë këtë platformë me të dhëna bazuar në kërkesat e ligjit për qasje në dokumente publike rreth qasjes në kontrata, fatura e urdhërpagesa, të dhënat e zbatimit të kontratave dhe planet e menaxhimit, të dhënat e bizneseve, e kështu me radhë. Kjo do t'u

mundësojë akterëve të shoqërisë civile dhe mediave të kërkojnë më shumë llogaridhënie dhe transparencë. Aty ku do të shfaqen sfida (*siç tregon kreu ...*) do të kërkojmë ndihmë nga institutionet përgjegjëse, por gjithashtu do t'i adresohemi institucioneve të duhura, përfshirë Gjykatën Kushtetuese dhe ligjvënësit.

Gjithashtu, do të kërkojmë nga ARBK-ja që të japë të gjitha informatat që janë publike sipas ligjit lidhur me bizneset, dhe ***do të përpiqemi të lidhim të gjitha kategoritë e të dhënave në një platformë të hapur të prokurimit.***

Qytetarët duan ta dinë se si si arrihet deri te një marrëveshje, kush ka fituar një kontratë dhe përse. Kush është përgjegjës për zbatimin e kontratës dhe kush është përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të saj? Cilat janë rezultatet në terren dhe a janë ato të kënaqshme?

Si tatimpagues, ata duhet të jenë në gjendje të shohin se ku shkojnë paratë e tyre. Këto informata duhet të jepen në mënyrë të hapur, të qasshme dhe të kapshme. Derisa të arrihen reformat ligjore FOL-i, do të përpiqet të ofroj këtë lloj transparence duke shfrytëzuar ligjet aktuale.

Besojmë se transparenca ndihmon në parandalimin e punëve korruptive dhe keqpërdorimit të autoritetit. Kur procesi është i hapur për të gjitha palët është shumë më lehtë të mbikëqyrësh procesin dhe të gjesh parregullsi, gjë që ndihmon për një proces të drejtë. Kur punët kryhen në nën dritën e diellit të gjithë mund të shohim se kush po përfiton nga tatimet tona dhe si. Nëpërmjet transparencës mund të zbulohen parregullsitë, nepotizmi, manipulimi i ofertave dhe favorizimi, dhe ata që qëndrojnë pas parregullsive do të mbahen përgjegjës.

20.0 Transparenca aktive kundrejt asaj pasive

Vonesat e mëdha dhe dekurajuese

Në nenin 120 të Kushtetutës së Kosovës thuhet se: *“Shpenzimet publike dhe mbledhja e të hyrave publike duhet të bazohen në parimet e llogaridhënies, efektshmërisë, efikasitetit dhe transparencës”*.

Përpara se Kosova të bëhej me Kushtetutë, në dispozicion ishte Ligji për qasje në dokumente zyrtare, i vitit 2003. Në vitin 2010 ky ligj u shfuqizua dhe u zëvendësua me ‘Ligjin nr. 03/L-215 për qasje në dokumentet publike’.

Në teori, Ligji për Qasje në Dokumentet Publike parasheh qasjen nga të gjithë qytetarët në atë që është publike, për të siguruar transparencën dhe llogaridhënien, dhe për të mbikëqyrur punën e institucioneve, por në praktikë vetëm njerëzit e arsimuar mund të qasen në dokumente. Parimisht këtë ligj e përdorin më së shumti mediat dhe shoqëria civile, jo qytetarët e rëndomtë.

Kjo për faktin se ligji nuk ofron transparencë automatike, por transparencë sipas kërkesës. Rregulli është se **“nëse nuk e kërkon një dokument zyrtar, përmes kanaleve zyrtare të komunikimit ai dokument nuk është publik”**. Edhe, kur ta kërkon atë, procesi i marrjes së informatave është i dizajnuar në atë mënyrë që t’u dekurajojnë që të bëni më tepër pyetje. Sipas ligjit, çdo institucion mund t’i vonoj informatat e kërkuara deri në shtatë ditë pune, dhe nëse ju nuk jeni të kënaqur me informatat që u janë dhënë mund të kërkon rishqyrtim. Rishqyrtimi, sipas nenit 8 të ligjit për qasje në dokumente publike, merr edhe tetë ditë të tjera, por ka një trik. Kjo pasi që ligji thotë se afati i fundit do të *“vazhdohet”*; disa institucione e konsiderojnë këtë afat të ri, që do të thotë se afati i mëparshëm ka mbaruar dhe me rishqyrtim hyhet në afatin e ri prej 15 ditësh.

Ky interpretim është dhënë nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik kur u kemi kërkuar të rishqyrtojnë vendimin e tyre. Ata janë përgjigjur duke

vendosur një afat të ri prej 15 ditësh, duke iu referuar (nënkuptuar) nenin 8 të LQDP-së.

Nëse afati nuk vazhdohet përtej afatit fillestar prej 7 ditësh, por konsiderohet si afat i ri, atëherë i tërë procesi i marrjes së një dokumenti publik merr 22 ditë pune, pra, bashkë me fundjavat, një muaj.

20.1 Nuk ka transparencë pa e kërkuar atë

Nëse flasim në mënyrë strikte, dallimi kryesor në mes të transparencës aktive dhe asaj pasive është nëse të dhënat janë në dispozicion sipas kërkesës ose nëse ato vihen në dispozicion në internet automatikisht.

Në vendet ku transparenca është pasive, të dhënat konsiderohen si pjesërisht të hapura, dhe qytetarët mund t'u qasen atyre në bazë të njohurive që kanë lidhur me dokumente të caktuara dhe kapacitetin e tyre për t'u drejtuar me shkrim të institucioneve përmes kanaleve zyrtare të komunikimit.

Në vendet ku transparenca është aktive, të gjitha informatat vihen në dispozicion online pa i kërkuar dikush.

Në Kosovë, Ligji nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike (LQDP) kërkon që informatat të vihen në dispozicion sipas kërkesës, por gjithashtu në mënyrë elektronike, sipas mundësisë. Neni 16 i ligjit kërkon që institucionet të publikojnë ***gjithçka që mund të publikohet në mënyrë elektronike***, por nuk specifikon nëse dokumente të rëndësishme, si kontratat, duhet të publikohen pa kërkesë. Prandaj, asnjë institucion në Kosovë nuk i publikon kontratat e dhëna nëpërmjet procesit të prokurimit publik pa pasur kërkesë për t'i publikuar ato.

21.0 Transparenca në prokurimin publik

21.1 Analizë e legjislacionit

Prokurimi publik është procesi përmes së cilit Qeveria dhe organet e tjera publike blejnë mallra, shërbime ose punë nga një kompani. Marrë parasysh se Kushtetuta parasheh që “**shpenzimet publike dhe mbledhja e të hyrave publike duhet të bazohen në parimet e llogaridhënies, efektshmërisë, efikasitetit dhe transparencës**”, FOL-i, ka kryer një hulumtim mbi legjislacionin e Kosovës, për të parë se si ofrohet kjo lloj transparence.

Qasja në dokumentet që përmbajnë informata publike rregullohet me Kushtetutë dhe Ligjin për Qasje në Dokumentet Publike. Përveç këtyre dy akteve, transparenca e informatave dhe dokumenteve të mbledhura dhe të përdorura gjatë procesit të prokurimit është e rregulluar me Ligjin për Prokurim Publik.

Prandaj, kur bëhet fjalë për atë se deri në çfarë mase ofrohet qasja në informata të prokurimit, ka tri akte ligjore që rregullojnë këtë fushë specifike. Në këtë analizë të shkurtër të legjislacionit, në **pjesën e parë** jepet një analizë e shkurtër mbi këto akte, pajtueshmërinë e tyre, dhe interpretimin e tyre nga ana e institucioneve publike, ndërsa **pjesa e dytë** trajton çështjen e sekreteve tregtare, gjë që, sipas hulumtimeve tona, po interpretohet gabimisht nga ana e institucioneve për të kufizuar dhe refuzuar qasjen në informatat publike.

21.1.1 Transparenca në prokurimin publik

Prokurimi publik kryhet duke përdorur fondet publike. Korniza e transparencës rreth përdorimit të këtyre fondeve është vendosur nga Kushtetuta, ndërsa është e rregulluar hollësisht nga LPP-ja.

21.1.2 Kushtetuta

Fondet publike duhet të shpenzohen bazuar në p.sh. parimet e transparencës⁴⁵.

21.1.3 Ligji për Prokurim Publik

LPP-ja, përmban një tërësi të qartë rregullash që sigurojnë një nivel të lartë të transparencës së informatave që lidhen me aktivitetet e prokurimit publik.

Së pari, ai përcakton qëllimin e tërësisë së rregullave *“të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike [...] duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen [...], nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit[...]”*.

Paragrafi 2 i të njëjtit nen thotë në mënyrë të qartë se qëllimi i ligjit, ndër të tjera, është që të arrihet përdorimi transparent dhe i drejtë i fondeve publike *“duke vepruar në përputhje të plotë me kërkesat procedurale dhe materiale të këtij ligji.”* Në kuptim të këtij paragrafi, ky ligj duhet të zbatohet për të gjitha aktivitetet që lidhen me procesin e prokurimit, të cilat duhet të jenë transparente.

Për më tepër, Neni 2, paragrafi 2, vazhdon ta përcaktojë fushëveprimin e ligjit, i cili vlen për ***“të gjithë personat, operatorët ekonomikë, ndërmarrjet, ashtu siç përcaktohen këto terma në këtë ligj, që përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, drejtpërsëdrejti ose tërthorazi, në të gjitha aktivitetet e prokurimit që mbulohen nga ky ligj; të tillë persona, operatorë dhe ndërmarrje gjithashtu duhet t'i***

45

respektojnë dhe të veprojnë në përputhje me kërkesat procedurale dhe materiale të këtij ligji”.

Bazuar në paragrafët e mësipërm, është e qartë se qëllimi i LPP-së është vendosja e një tërësie rregullash që do të mundësojnë shfrytëzimin e drejtë të fondeve publike, dhe që shfrytëzimi i tyre të jetë transparent, në të gjitha aktivitetet që lidhen me të, ndërsa këto rregulla duhet të monitorohen nga të gjithë personat që janë të interesuara drejtpërsëdrejti ose tërthorazi në këtë proces.

Megjithatë, LPP-ja, është plotësuar-ndryshuar në janar 2016, me Ligjin nr. 05/L -068. Janë bërë disa ndryshime në ligjin bazik, më konkretisht në Nenin 10, i cili rregullon mjetet për promovimin e transparencë dhe qasjen në të dhënat lidhur me aktivitetet e prokurimit.

Ligji bazik, në paragrafin 3 të nenit 10, parashihte që ***“me kërkesë të cilitdo person, autoriteti kontraktues i siguron qasje të menjëhershme dhe të arsyeshme personit të tillë.”.***

Paragrafi 2 i të njëjtit nen parasheh që të qasshme të jenë të paktën:

- (i) të gjitha dokumentet që kanë të bëjnë me një aktivitet të prokurimit ose që janë zhvilluar apo pranuar gjatë, ose që janë mbledhur ose shfrytëzuar për të filluar ose përmbyllur një aktivitet të prokurimit, pa marrë parasysh nëse aktiviteti i tillë rezulton në një kontratë ose në dhënien e konkursit të projektimit;
- (ii) nëse aktiviteti i prokurimit ka rezultuar në dhënien e një kontrate ose konkursi të projektimit, atëherë të gjitha dokumentet që kanë të bëjnë me dhënien e tillë;
- (iii) **nëse aktiviteti i prokurimit ka rezultuar në ekzekutimin e një kontratë publike, atëherë një kopje të kontratës publike dhe të të gjitha**

dokumenteve që kanë të bëjnë me kontratën dhe/ose ekzekutimin e saj.

Më tej, ky paragraf i referohet qasjes në dokumente, të përshkruara në Nenin 81 të LPP-së: plani i menaxhimit të kontratave, në veçanti për aspektet organizative, ekonomike, teknike dhe ligjore të menaxhimit të kontratave, të përfshijë:

- (i)** ekipet e menaxhimit të projekteve
- (ii)** rishikimin e shpeshtë të kontratës
- (iii)** protokollet për dorëzimin e pajisjeve të porositura
- (iv)** dialogun e rregullt me kontraktuesin
- (v)** përdorimin e standardeve të sakta të cilësisë
- (vi)** menaxhimin e pagesave/kërkesave
- (vii)** procedurat e ankesave
- (viii)** mjetet e kontrollit të përcaktuara në kontratë

Në vitin 2016, me Ligjin mbi plotësim ndryshimin e LPP-së, ishte ndryshuar edhe gjuha e përdorur në nenin 10. Ky ndryshim lidhet me identifikimin e palëve të cilët mund të kenë qasje në dokumentet e listuara më sipër. Ligji themelor parashihte qasje në informata *për cilindo person*, ndërsa e njëjta frazë tani është zëvendësuar me frazën *palë e interesit*.

Palë e interesit, siç e përkufizon ligji, është:

“personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshirë cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar.”

Ky ndryshim në ligj kufizon qasjen në informatat e prokurimit duke e kufizuar audiencën që mund të ketë qasje në të dhëna, pasi që qasja në aktivitetet e prokurimit u lejohe vetëm atyre që mund të tregojnë interes material. **Ky ndryshim nuk është në pajtim me parimet e transparencës, të përcaktuara në LPP-ja dhe në Kushtetutë, pasi që bie në kundërshtim të drejtpërdrejt me to duke kufizuar transparencën e prokurimit nën standardet minimale që kërkohen.**

Deri më tani nuk kemi mundur të konfirmojmë se si interpretohet nga institucionet publike ky ndryshim në ligj, pasi që kur lejojnë ose refuzojnë qasjen në dokumente i referohen LQDP-së, ndonëse qasja në ato dokumente duhet të përcaktohet nga LPP-ja, siç shtjellohet më poshtë në pjesën **D**. Megjithatë, për shkak të ndikimit të mundshëm të këtij ndryshimi në transparencën e prokurimit publik dhe konkretisht në qasjen në informata, mendojmë se është me interes të përgjithshëm të tërheqim vëmendjen e publikut me efektin e mundshëm të ndryshimit të sipërpërmendur.

Kështu, në rast se ky ndryshim do të ndikojë në qasjen në informata të lidhura me prokurimin, vetëm nga ana e atyre që tregojnë interes legjitim material, duke pasur parasysh se prokurimi kryhet duke shfrytëzuar fondet publike dhe ndodhet brenda suazave të interesit të çdo qytetari të Kosovës që të shohë se si, për çfarë dhe ku janë shpenzuar fondet publike.

21.1.4 Ligji për Qasje në Dokumentet Publike

Qasja në dokumentet që hartohen dhe mbahen nga institucionet publike në Kosovë është e rregulluar me Ligjin për Qasje në Dokumentet Publike. Në Nenin 1 të këtij ligji thuhet: *“ky ligj zbatohet për të gjitha dokumentet që mbahen, hartohen apo pranohen nga institucionet publike.”*

Bazuar në hulumtimet tona, kur kemi kërkuar dokumente specifike të performancës së një kontrate të prokurimit, sipas nenit 10 të LPP-së, përkatësisht të dhëna rreth pagesave, inspektimeve të cilësisë, planeve të menaxhimit të kontratave, qasja në ato dokumente është bazuar në LQDP, jo në LPP.

Kur refuzojnë qasjen në informatat e kërkuara, institucionet publike i referohen nenit 12.1.6 dhe 12.1.7., i cili parasheh arsyet për refuzimin e qasjen në dokumente, për të mbrojtur *“privatësisë dhe interesa të tjera legjitime private” dhe “interesave komerciale dhe të tjera ekonomike.”*

Dokumentet e kërkuara janë në fokus të LPP-së, sipas nenit 10(2), i cili kërkon që *“Dokumentacioni në lidhje me ekzekutimin e kontratës përfshinë në veçanti planin e menaxhimit të kontratës i kërkuar sipas nenit 81 të këtij ligji”*, të jenë në dispozicion të personave të interesuar, sipas kërkesës.

Megjithatë, pavarësisht faktit se LPP-ja, parasheh qasje në informata të tilla, institucionet publike kufizojnë qasjen në dokumente të tilla duke iu referuar LQDP-së.

21.1.5 Konflikt ligjesh

Qasja në të dhënat e prokurimit është e rregulluar përmes dy ligjeve të ndryshme, ndaj qasja në informata të njëjta kufizohet në mënyra të ndryshme.

Në rast kur ekziston një konflikt ligjesh, zbatohet ai duke marrë për bazë doktrinën *“lex specialis derogat legi generali”*. Ky parim parasheh zgjidhjen e konfliktit të ligjeve përmes identifikimit të fushëveprimit të ligjit. Sipas këtij parimi, ligji specifik (në këtë rast LPP) duhet të zbatohet mbi të ligjin e përgjithshëm (LQDP). Ligji i përgjithshëm (LQDP) duhet të zbatohet vetëm nëse ligji specifik (LPP), nuk e ka rregulluar çështjen në fjalë, ose nëse vendos kufizime më poshtë atyre të përcaktuara me ligjin e përgjithshëm.

Rrjedhimisht, institucionet gabimisht i referohen LQDP-së, për të vendosur mbi qasjen në të dhënat e prokurimit, pasi që qasja në dokumente të tilla duhet të jepet bazuar në LPP-së, pasi që ky i fundit e ka rregulluar qasjen në informata të prokurimit.

21.1.6 Sekretet tregtare dhe qasja në informata

Siç shpjegohet në I.C, Lëvizja FOL u ka kërkuar disa institucioneve informata për prokurim si pjesë e hulumtimit mbi prokurimin publik. Nga këto institucione, Agjencia Kosovare e Privatizimit dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik kanë refuzuar qasjen në dokumente publike duke iu referuar *interesit ekonomik apo interesit tjetër tregtar* si arsye për refuzimin e qasjes, ndërsa Ministria gjithashtu i është referuar nenit 11 të LPP-së (sekreteve tregtare).

Transparenca e fondeve publike, siç parashihet me Kushtetutë dhe ligje, nënkupton se i tërë procesi në lidhje me atë se si shpenzohen fondet publike duhet të jetë transparent, dhe informatat duhet të jetë në dispozicion të publikut të gjerë, për të përmbushur kërkesat e transparencës.

Pasi që dokumentet publike akoma nuk janë në dispozicion të publikut në internet, për të monitoruar këtë proces informatat janë marrë gjatë procesit të kërimit të tyre nga institucionet përmes kërkesës për qasje në dokumentet publike⁴⁶. Qasja në këto dokumente është e rregulluar me **I. Kushtetutë** dhe **II. Ligjin për Qasje në Dokumentet Publike**, por ky i fundit kufizon qasjen në informata të caktuara, gjë që rezulton në kufizimin ***që përbën shkelje të Kushtetutës***.

⁴⁶Ky proces konsiderohet transparençë pasive. Shih faqe 91

21.1.7 Kushtetuta

Neni 41 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës⁴⁷, në paragrafin 1, parasheh se “*Secili person gëzon të drejtën të qasjes në dokumente publike.*”

Paragrafi 2 përcakton se çfarë konsiderohet dokument publik duke i identifikuar ato si “*Dokumentet që mbajnë institucionet publike dhe organet e pushtetit shtetëror janë publike...*”⁴⁸. Më tej, kjo dispozitë parasheh kufizimin lidhur me atë se kur informata që përmban një dokument publik mund të kufizohet për publikun, duke përcaktuar se këto dokumente do të jenë të qasshme “*...me përjashtim të informacioneve që janë të kufizuara me ligj, për shkak të **privatësisë, të sekreteve afariste** ose të informacioneve **të klasifikuara të sigurisë.***”

Ky paragraf qartazi identifikon se:

- a) Vetëm **informatat** që përmban një dokument (jo dokument në tërësi) mund të kufizohen
- b) Informatat qasja në të cilat mund të kufizohet në mënyrë të ligjshme duhet të jenë të natyrës që shkelin:
 - Privatësinë
 - Sekretet afariste të bizneseve, ose
 - Bien në kuadër të klasifikimeve të sigurisë

Kufizime të tjera që zbatohen, e të cilat nuk janë të listuara në Kushtetutë dhe si rezultat limitojnë qasjen në informata, përbëjnë shkelje të Kushtetutës.

⁴⁷ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 15 qershor 2008, qasur në: <http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Kushtetuta.e.Republikes.se.Kosoves.pdf>.

⁴⁸ *Id.*

21.1.8 Ligji për Qasje në Dokumentet Publike (Ligji nr. 03/L-215)

Kur u është kërkuar qasja në dokumente publike, institucionet publike kanë mundësuar/refuzuar kërkesën duke u bazuar në Ligjin për Qasje në Dokumentet Publike.

Në dy rastet studimore, kur institucioni ka refuzuar kërkesën për qasje në dokumente në arsyetim i janëreferuar nenit 12 (1.7) të LQDP-së, pa dhënë ndonjë shpjegim të mëtëjshëm për refuzimin ose ndonjë interpretim të asaj se si aplikohet dispozita e tillë për informatën e kërkuar.

Neni 12 i LQDP-së, parasheh rrethanat kur kufizimi i së drejtës për qasje duhet të ushtrohet proporcionalisht, përkatësisht për qëllim të mbrojtjes së *“interesave komerciale dhe interesave të tjera ekonomike⁴⁹.”*

Kërkesat e dërguara nga FOL-i, përfshirë një listë të dokumenteve, përkatësisht plani i kontratës, informatat e pagesave, performanca e kontratës, etj., qasja në informata të tilla është kufizuar bazuar në LQDP.

Kjo dispozitë e ligjit kufizon shumë më shumë qasjen në dokumentet sesa çfarë parasheh Kushtetuta.

Kur është fjala për aspektin komercial të informatave që mund të klasifikohen si sekret, vetëm informatat që mund të nxirrnin sekrete tregtar mund të klasifikohen si sekret. Përrjashtimet nga e drejta e qasjes në dokumente nuk mund të ushtrohen në bazë të *interesave komerciale dhe interesave të tjera ekonomike*, pasi që kjo nuk përbën sekret afarist në formën të *“çfarëdo formule, modeli, makine, apo procesi të prodhimit të përdorur në një biznes që*

⁴⁹ Ligji nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumentet Publike, neni 12 (1.7). Qasur në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2724>

mund t'i japë përdoruesit përparësi konkurruese; plani ose procesi, mjeti, mekanizmi, apo kompleksi të njohur vetëm për pronarin e tij dhe të punësuarit të cilëve është e domosdoshme t'u jepet qasja."

Në rast se informatat e kërkuara në të vërtetë përbëjnë sekret afarist, atëherë *"nëse elementi i tillë gjendet në një dokument që gjithashtu përmban informata jo-konfidenciale, atëherë institucioni duhet të përgatisë një version 'të pastruar' të një dokumenti të tillë."*

Megjithatë, edhe në rast se dokumenti i kërkuar përmban vetëm sekrete tregtare, atëherë *"autoriteti kontraktues do të bashkëngjisë në ballinë të versionit të tillë të pastruar një njoftim që thotë se (i) autoriteti kontraktues i ka klasifikuar disa elemente të caktuara të informatës në dokumentin origjinal si informata sekrete afariste, me kërkesën e operatorit përkatës ekonomik, dhe (ii) versioni i pastruar i bashkëngjitur është përgatitur nga autoriteti kontraktues dhe është një kopje e saktë e origjinalit pas heqjes ose fshirjes së informatave të tilla sekrete afariste."*

21.2 Transparenca e përfituesve

Legjislacioni i Kosovës nuk parasheh obligimin e operatorëve ekonomikë për t'u regjistruar në një regjistër të veçantë, e as identifikimin e përfituesve. Megjithatë, kjo mund të rregullohet lehtë. FOL-i, rekomandon dy opsione se si një rregullim i tillë mund të përfshihet në legjislacionin kombëtar:

- a)** Me ligj specifik mbi regjistrin e partnerëve të sektorit publik – kjo mund të arrihet duke miratuar një ligj, ngjashëm si ligji i Sllovakisë
- b)** Duke plotësuar-ndryshuar dy ligje – Ligji për Prokurim Publik dhe Ligji për Shoqëritë Tregtare mund të ndryshohen duke shtuar dispozita që do të vendosin detyrimin që operatorit ekonomikë të regjistrohen në regjistrin e veçantë

në mënyrë që të kualifikohen për të lidhur kontrata me institucionet publike, si dhe dispozita të tjera relevante

21.2.1 Ofertuesit me pronarë të panjohur

Qeveria vendosi të të propozonte këtë ligj, të cilin Parlamenti e miratoi, për t'ua kufizuar ofertuesve me pronarë të panjohur pjesëmarrjen në prokurim publik. 23 ligjvënës u fokusuan në të ashtuquajturat 'parajsa tatimore', duke e bërë çdo kompani me seli në njërin prej tyre të pakualifikueshme për të marrë pjesë në tenderë publike në Sllovaki. (Transparency International Slovakia, 2016)

22.0 Përfundime

Jemi të vetëdijshëm se çfarë po kërkojmë. Ne nuk po kërkojmë të ndryshohet një rregullore ose një ligj, ose të publikohet një dokument i veçantë. Ne po kërkojmë një reformë të madhe në prokurimin publik, mbase reformën më të madhe ndonjëherë, që më në fund do të sjellë transparencë në shpenzimet publike, dhe respektimin e kushtetutës së vendit dhe të tatimpaguesve – qytetarëve.

Gjithashtu jemi të vetëdijshëm për burimet dhe shpenzimet që kërkohen në këtë nismë të paparë për të sjellë transparencë në shpenzimet publike. Por jemi të bindur, më shumë se kurrë, se kjo është qasje e drejtë, dhe se kostoja është shumë më e madhe nëse nuk ndërmerret një iniciativë e tillë.

Po kërkojmë ndryshimin e ligjeve dhe rregulloreve, miratimin e ligjeve dhe rregulloreve të reja. Çështje më e rëndësishme, po kërkojmë ndryshimin e mentalitetit. Një mentalitet që e pranon transparencën si parim themelor të çdo procesi të çfarëdo procesi vendimmarrjeje dhe të hapur ndaj kritikave dhe mbikëqyrjes në hollësi nga tatimpaguesit – qytetarët.

Po kërkojmë që të mendohet hapur për mundësisë e të dhënave të hapura, në atë drejtim që puna të kryhet në mënyrë të hapur.

Pra, po kërkojmë transparencë edhe si tatimpagues që paguan për atë urë dhe për atë rrugë, për atë makinë dhe për atë drekë luksoze në atë restorantin mahnitës.

Si një tatimpagues, po kërkojmë që ju të na e sillni faturën!

FOL-i, është ka ndërmarrë këtë nësimë, por nuk është i veëtm. Ne e dijmë që të tjerët do të na ndjekin dhe do të na përkahin.

Kjo, sepse ne e dijmë çmimin e korrupsionit, e dijmë ngase e ndjejmë çdo ditë në lëkurën tonë.

Pasuria e pashpjegueshme e politikanëve tanë dhe e zyrtarëve të lartë duhet të bëhet transparente. Ne duam të fillojmë me prokurimin publik, i cili besojmë se ka qenë dhe mbetet burimi i pasurimit i të gjithë atyre që

keqpërdorin autoritetin si zyrtar publik për të u korruptuar dhe për të fituar për veten.

Ta bëjmë të qartë, ne nuk po kërkojmë që të bëjmë më të vështirë të bërit biznes në Kosovë, e kundërta. Një biznes i ndershëm nuk i frikohet transparencës, por lufton për të. Një biznes që nuk korrupton zyrtarë publikë nuk ka pse të frikësohet nga kjo iniciativë.

Ne duam t'i shpërfaqim në publik veprimet e qeverisë, kur ajo shpenzon taksat tona. Duam të dijmë ku shkojnë ato dhe kush përfiton nga to. Kjo nënkupton se me transparencë do të jetë e pamundur të fshihen emrat e personave të lidhur me politikanë e zyrtarë të lartë në ndonjë kompani matanë oqeanit, prapa ligjeve të privatësisë.

Ne jemi vend i varfër, por megjithatë kemi nënshkruar kontrata miliardëshe. Duhet të sigurohemi se askush nuk i përdor fondet publike që të pasurohet për veten dhe familjen e tij.

Po kërkojmë konkurrencë të drejtë nga kompani të mundshme të të gjitha madhësive në mënyrë që të nxirret vlera më e mirë për paratë e dhëna.

Po kërkojmë që të sigurohet konkurrencë e drejtë dhe të sanksionohen praktikat korruptive, që kompanitë me një histori të dëshmuar të shkeljeve të integritetit të përjashtohen nga qasja në prokurimin publik.

KRPP-ja, mund të jetë autoritet për të gjobitur të gjithë ata operatorë që shkelin rregullat, fshehin informatat, i shmangen tatimeve ose janë zbuluar ose kapur duke kryer çfarëdo veprimi të papërgjegjshëm, korruptues ose duke keqpërdorur paratë e tatimpaguesve.

Ne u bëjmë thirrje liderëve dhe përfaqësuesëve tanë të cilët premtojnë zero tolerancë ndaj korrupsionit që ta përkrahin këtë iniciativë.

Ne kemi nevojë për ndihmën tuaj që t'i jepni zë shqetësimeve tona në Parlament dhe ta shtyni Qeverinë që kërkesën për transparencë në prokurim publik ta bëni realitet.

Nëse ne duhet të paguajmë taksat, duhet të dijmë se çka po paguajmë!

23.0 Rekomandime

1. KRPP-ja duhet të i hapë kontratat për publik
 - a) Kontratat, anekset dhe shtojcat
 - b) Urdhërpagesat dhe faturat
 - c) Dokumentet e menaxhimit të kontratës
2. KRPP-ja duhet të bashkëpunoj me Auditorin e Përgjithshëm në identifikimin e mangësive në prokurimin. KRPP-ja mund t'i adresoj ato duke lëshuar ndëshkime për kompanitë dhe autoritetet kontraktuese. Edhe auditori edhe KRPP-ja duhet t'i dërgojnë rastet në prokurori kur ka prova për shkelje të rënda
3. Ndryshimi dhe amendamenti i kornizës së tashme ligjore lidhur me transparencën në shpenzimet publike
 - a) Rregulli “*nëse nuk pyet, nuk është i hapur*” duhet të ndryshojë sa i përket kontratave duke ofruar transparencë aktive, online
 - b) Ligji për shoqëritë tregtare duhet të ndryshoj për të ofruar më shumë transparencë lidhur me pronarët e bizneseve, përfituesit dhe menagjmentit
 - c) Ligji për prokurimin publik duhet të ndryshoj pjesën që kufizon qasjen në dokumente të prokurimit
4. AQP-ja duhet të ketë më shumë produkte në listat e saj të prokurimit
5. I tërë personeli i prokurimit duhet ta deklarojnë pasurinë, pasi që i nënshtrohet rrezikut të korrupsionit
6. Hartimi i një ligji të veçantë mbi regjistrin e partnerëve të sektorit publik – kjo mund të arrihet duke miratuar një ligj, ngjashëm si ligji i Sllovakisë
7. Planet një vjeçare të prokurimit duhet të publikohen online që të ndihmojnë operatorët ekonomik të bashkëpunojnë por edhe për të parandaluar pagesat në minutat e fundit
8. KRPP-ja duhet të bashkëpunoj me ARBK-në dhe institucione të tjera për të krijuar **Regjistrin e Partnerëve të Sektorit Publik**.

9. KRPP-ja duhet t'i publikoj automatikisht online në faqen e saj të gjitha kontratat, anekset dhe shtojcat që datojnë nga viti 2010 në format të lexueshëm nga kompjuterët
10. Të publikojë online faturat, urdhërpagesat nga kontratat publike në një format të lexueshëm nga kompjuterët
11. Të publikojë informacion të plotë për kontratat aktive, kriteret e përzgjedhjes (*thirrjet për kontratë*) me legjenda të thjeshta dhe të kuptueshme, të lexueshme nga kompjuterët
12. Të publikojë ofertat e tenderuesëve në fomrat të lexueshëm nga kompjuterët
13. Të pamundësojë aplikimin e ofertuesve me pronarë të fshehur nga pjesëmarrja në prokurimin publik
14. Të pamundësojë kompanitë (operatorët ekonomik, bizneset) të marrin pjesë në prokurimin publik me përfitues të panjohur
15. KRPP-ja duhet të lejojë dëshmitarët shoqërorë gjatë hapjes së tenderëve. Shoqëria civile mund të caktohet për pjesëmarrje në bazë të interesit në një formë rrotacioni mbi një nivel të caktuar.

Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve duhet të publikojë:

16. Të dhënat e plota, të përditësuara, të bizneseve, përfshirë adresat, shtetësinë e personave të autorizuar, dhe të pronarëve, menaxherëve dhe partneriteteve
17. Historinë e plotë të personave të autorizuar, pronarëve, menaxherëve dhe partneriteteve; Historinë e plotë të ndërhyrjeve ligjore, dhe akteve ligjore
18. Historinë e plotë të intervenimeve nga bizneset në dokumentet ligjore
19. Të gjitha të dhënat e pronarëve përfitues, në një ueb-faqe të veçantë. Pronarët e tillë duhet të listohen pasi të jenë verifikuar nga noterët, siç është e rregulluar me ligj

Ministria e Financave duhet të publikojë:

20. Onilne të gjitha raportet financiare të kompanive, të cilat bëjnë biznes me shtetin. Të gjitha kompanitë të cilat regjistrohen në

regjistrin e partnerëve të sektorit publik duhet t`i hapin dokumentat që taksapaguesit ta dijnë kush janë pronarët e tyre dhe kush operon me këto kompani

21. Qytetarët duhet të kenë mundësinë që t`i ndjekin paratë e tyre që të shohin se ku investohen. ATK-ja duhet që ta mundësojë këtë në bashkëpunim me institucione e tjera, duke ofruar qasje online.

Qeveria të rishikojë dhe plotësojë-ndryshojë ligjet për:

22. Qasje në dokumentet publike
23. Prokurimin publik, dhe
24. Shoqëritë tregtare

Të hartojë ligje të reja mbi:

25. Pronarët përfitues dhe ‘parajsat tatimore’, dhe
26. Regjistrin e partnerëve të sektorit publik

Avokati i Popullit duhet:

27. Të krijojë një zyrë të veçantë që të mbikqyrë prokurimin publik, të ofrojë këshilla në proces dhe të shërbejë si organi alternativ për zgjidhje të mosmarrëveshjeve kur palët pajtohen

Bibliografia

KOMISIONI EVROPIAN. (2015). *RAPORTI I VITIT 2015 PËR KOSOVËN**. KOMISIONI EVROPIAN, Zgjerimi. Bruksel: Komisioni Evropian.

Komisioni Evropian. (2016). *Raporti për Kosovën*. Bruksel: Komisioni i BE-së.

FOL. (2012). *Analizë e Ligjit të Prokurimit Publik në kontekstin e parimit të transparencës*. Lëvizja FOL.

FOL. (2013). *Shpërdorimet në Prokurimin Publik*. Prishtine: Lëvizja Fol.

Agjencia kundër Korrupsionit. (2016). *Raporti vjetor*. AKK.

Lëvizja FOL. (2011). *Raport mbi Prokurimin ne Ministrinë e Infrastrukturës*. Prishtinë: Lëvizja FOL.

OECD. (2015). *OECD Recommendation of the Council of Public Procurement*. OECD. Marrë nga <http://www.oecd.org/governance/ethics/OECD-Recommendation-on-Public-Procurement.pdf>

OECD. (2016). *Preventing Corruption in Public Procurement*. OECD.

Open Contracting Partnership (OCP). (2015). *2015 -2018 Strategy*. OCP.

RiINVEST. (2012). *PËRMIRËSIMI I TRANSPARENCËS DHE QEVERISJES SË FONDEVE PUBLIKE PROCESI I PROKURIMIT PUBLIK NË KOSOVË*. Prishtine: RiInvest.

TI Slovakia. (2015). *Not in force until published online*. Bratislava: Transparency International Slovakia.

Transparency International Slovakia. (2016). *Open Data To Fight Corruption*. Bratislava: TI Slovakia.

UNDP Kosovo. (2016). *Public Pulse on Corruption*. Prishtine: UNDP Kosovo.



Ky grant është financuar nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)

